



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
PERFORMANCE**

“Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe
administrimin e lagunave”



Tiranë, Dhjetor 2022

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT.....	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	6
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM.....	6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	8
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	9
2.4 Pesha në buxhet.....	9
2.5 Feedback-u i subjektit i subjektit përgjatë auditimit.....	12
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	12
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	12
3.2 Objektivat e auditimit.....	14
3.3 Pyetjet e auditimit.....	15
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	16
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT.....	16
4.1 A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe administrimin e lagunave?.....	16
4.2 A është përmbushur objektivi i mbrojtjes së biodiversitetit në laguna?....	33
4.3 A ka patur bashkëveprim dhe koordinim mes aktorëve të përfshirë?.....	53
4.4 A ka patur mirëmenaxhim të lagunave nga institucionet përgjegjëse?.....	62
5. PËRMBLEDHJA.....	70
6. SHTOJCAT.....	71
7. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE.....	78

LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MK	Ministria e Kulturës
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AdZM	Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
AKU	Agjencia Kombëtare e Ushqimit
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i>)
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
PK	Park Kombëtar
RNM	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror
ZM	Zonë e Mbrojtur
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
PKIE	Plani Kombëtar i Integritetit Evropian

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

Megjithëse një vend i vogël, Shqipëria është shumë e pasur në diversitetin biologjik. Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve krijon kushte të favorshme për mbajtjen dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh të florës dhe faunës, përfshirë një sërë llojesh endemike dhe sub-endemike. Konkretisht, në vendin tonë numërohen rreth 3,200 bimë enëzore, 2,350 bimë jo-enëzore dhe 15,600 lloje rruazorësh e jo-rruazorësh.¹

Zonat detare e bregdetare janë më të pasurat në biodiversitet. Aktualisht, ligatinat (tokat e lagura) janë ekosistemet më të përfaqësuara në bregdetin shqiptar. Ligatinat e shëndetshme janë jetike për përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit. Ruajtja dhe restaurimi i ligatinave është thelbësor për arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit², ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit si dhe arritjen e objektivave në kuadër të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Rëndësia që paraqesin këto zona edhe në arenën ndërkombëtare, qëndron në faktin se:

- Më shumë se 1 miliard njerëz në mbarë botën varen drejtpërdrejt nga zonat ligatinore për cilësinë e jetesës së tyre, ushqimin dhe ujin e freskët;
- Ligatinat mbrojnë komunitetet nga ndikimi i ndryshimeve klimatike;
- Në këto zona ndodhet 40% e biodiversitetit të Botës;
- Ndihmojnë për të zvogëluar nivelin dhe shkarkimet e gazeve serrë dhe janë rezervuarë të karbonit.³

Për sa më sipër, sipërfaqet e zonave ligatinore, pjesë të cilave janë edhe lagunat, sipas Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në MTM, janë zona të mbrojtura thuajse në masën 100% të tyre dhe përbëjnë rreth 5.6% të sipërfaqes totale të zonave të mbrojtura.

Tabela 1. Sipërfaqja totale e Zonave të Mbrojtura dhe % e Zonave Lagunore kundrejt totalit të këtyre zonave paraqitet:

Sipërfaqja Lagunore (ha)	Sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura (ha)	% kundrejt Totalit
+10,120	180936.9	+ 5.6%

Burimi: MTM përpunuar nga grupi i auditimit

Ekosistemet komplekse të lagunave bregdetare strehojnë mbi 70% të vertebrorëve në vend, veçanërisht shpendë shtegtarë dhe dimërues. Rreth 70 lloje shpendësh uji gjenden çdo vit në lagunat bregdetare duke numëruar mbi 180'000 individë gjatë dimrit.⁴ Shqipëria është edhe një rrugë e rëndësishme shtegtimi për faunën e egër.

Lagunat në Shqipëri shtrihen duke filluar nga laguna e Viliunit në Velipojë deri tek ajo e Butrintit në jug. Sipërfaqja e përgjithshme e tyre është rreth 100 Km², janë me ujë të kripur, shtrihen paralel me detin dhe kanë kanale komunikimi me të.⁵

Liqeni i Shkodrës-Velipojë (pjesë e të cilit është edhe laguna e Vilunit), Laguna e Karavastasë dhe Butrinti konsiderohen si zona ujore me rëndësi jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare sipas “Konventës së Zonave Ujore RAMSAR”⁶ dhe janë pjesë e Trashëgimisë Botërore nga UNESCO.

¹ <https://turizmi.gov.al/zonat-e-mbrojtura/>

² <https://www.mod.gov.al/images/struktura-vartese/AKMC/legjislacioni/Ligji-75-2016-konventa-okb-klima.pdf>

³ <https://www.wetlands.org/news/every-day-should-be-world-wetlands-day/>

⁴ <http://mcpa.iwlearn.org/docs/in-blue-marine-and-coastal-protected-areas>

⁵ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Laguna>

⁶ Lista RAMSAR, Shqipëria është pjesë e Konventës së RAMSAR që prej vitit 1996

Gjithashtu duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre për ruajtjen e biodiversitetit, laguna e Karavastasë dhe Nartës konsiderohen si zona me rëndësi ndërkombëtare për shpendët e ujit njohur si IBA⁷, me më shumë se 20,000 lloje shpendësh uji për një zonë.

Sa kaq, mjedisi nuk është vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e strategjikisht. Vlerat rekreative që sjell larmia biologjike dhe ajo e peizazhit janë një pasuri, të cilat mund të përdoren për të nxitur zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i konceptit të ekoturizmit është një drejtim i vlerësuar si i rëndësishëm dhe krijon mundësinë e përfitimeve ekonomike, veçanërisht për Zonat e Mbrojtura, duke siguruar dhe mbajtur në konsideratë gjithmonë përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të biodiversitetit.

Me modelin aktual të zhvillimit, bazuar në “turizmin masiv”, rritja e parashikuar e zhvillimit të turizmit në rajon kërcënon dëmtimin e peizazheve dhe biodiversitetit. Njëkohësisht, sforcimi apo përdorimi tej mase i burimeve ujore në dispozicion, rritja e sasisë së mbeturinave dhe shkarkimi i ndotjeve në det, veç të tjerave është dhe një përçarje kulturore. Ndërtimet afër lagunave, me qëllim zhvillimin e turizmit ka shkaktuar gjithashtu dëme të mëdha edhe në ekosistemet e brishta bregdetare dhe detare në vend.

Tabela 2. Zënie Peshku për vitet 2016-2020

Zënie peshku							
	EMËRTIMI	2016	2017	2018	2019	2020	në ton
	Kategoritë ujore						Description
							Fishing categories
I	Total Peshkimi (1+2+3+4)	7,884	8,289	8,629	8,707	7,808	Total Fishing (1+2+3+4) I
1	Detar	4,646	4,609	5,537	5,499	4,521	Marine 1
2	Bregdeti	952	1,074	315	342	365	Coastal line 2
3	Laguna	598	599	350	94	79	Coastal lagoons 3
4	Ujërat e brëndshme	1,688	2,007	2,427	2,772	2,844	Inland waters 4
II	Akuakultura	3,200	4,000	5,138	5,229	8,799	Aquaculture II
III	Molusqe	1,450	430	1,108	1,075	285	Mitulus galloprovincialis III
	Total Zënie (I + II + III)	12,534	12,719	14,875	15,011	16,892	Total Fish caught (I + II + III)
Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural							

Burimi: INSTAT

Nëse i referohemi të dhënave të bëra publike nga INSTAT, bazuar në raportimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dëshmojnë se, ndërsa sasia e peshkut të kapur në Shqipëri është rritur nga 12,534 ton në vitin 2016 në 16,892 ton në vitin 2020, në laguna kjo sasi ka rënë me 6 herë. Kjo rënie ka vijuar për disa vite radhazi, duke u bërë më e evidente në vitin 2019, kur sasia e kapur ra në 94 ton nga 350 ton që kishte qenë një vit më parë.

Arsyeja për këtë rënie, sipas ekspertëve të mjedisit është ndotja e ujërave të ëmbla që derdhen në laguna. Ujërat e zeza që shkarkohen përmes lumenjve apo dhe kanaleve në laguna japin një impakt negativ, duke reduktuar gjallesat ujore në laguna përfshirë dhe peshkun. Kjo problematikë është situatë që përsëritet për të paktën 5 vite dhe është bërë shpesh herë prezente në media nga peshkatarët e zonave, megjithatë pavarësisht këtij fakti, nuk ka pasur reagime nga instancat shtetërore përgjegjëse për administrimin e lagunave dhe kjo problematikë vazhdon të jetë koherente edhe sot, duke penalizuar rëndë florën dhe faunën që gjendet në këto zona.⁸

⁷ <http://ata.gov.al/2021/05/22/dita-nderkombetare-e-biodiversitetit-shtohet-lista-e-shpendeve-te-rralle-ne-shqiperi/>

⁸ <https://www.reporter.al/2022/03/21/ujerat-e-ndotur-po-vrasin-peshqit-dhe-biodiversitetin-ne-lagunat-e-lezhes/>

Nga ana tjetër, një pelikan kaçurrel ka nevojë për afërsisht 1.5 kg peshk në ditë⁹, por mungesa e ushqimit si pasojë e peshkimit pa kriter riskon largim e tyre nga kjo lagunë, e cila është habitat i riprodhohet kjo specie. Për rrjedhojë, autoritetet kontrolluese duhet të ushtrojnë monitorime dhe inspektime efektive, me qëllim që peshkatarët të ndërgjegjësohen dhe të kryejnë peshkim sipas rregullave të përcaktuara në mënyrë që mos të dëmtohet asnjë specie e zinxhirit ushqimor.

Duke marrë parasysh faktin që ka disa institucione kompetente në ruajtjen dhe administrimin e lagunave, si pjesë e zonave të mbrojtura që janë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga ana tjetër ka edhe institucione përgjegjëse që përgjigjen për menaxhimin e ujit në zonat lagunore, që janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës. Këto institucione jo vetëm duhet të sigurojnë ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit në këto zona nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë së tyre institucionale por njëkohësisht duhet të koordinohen në mënyrë efektive me qëllim realizimin e këtij objekti të përbashkët.

Lidhur me këtë fakt, ky auditim ka bërë një vlerësim nëse këto institucione kanë mbrojtur dhe administruar në mënyrë efektive habitatet e këtyre zonave të mbrojtura dhe ekosistemet që ndodhen në to dhe njëkohësisht ka shqyrtuar nëse korniza ligjore aktuale në fuqi është e përshtatshme për të garantuar ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit në laguna, duke promovuar vlerat turistike/rekreative, kulturore, etj., në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin Strategjik 2018-2022, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues, duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar kështu në mirë qeverisje.

Në përfundim, në linjë edhe me rekomandimet e Progres Raportit 2021 dhe Strategjinë institucionale 2018-2022, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Institucionet përgjegjëse në hartimin dhe implementimin kuadrit rregullator të ruajtjes dhe administrimit të lagunave, janë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (në vijim MTM) dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në vijim MBZHR). Së bashku me institucionet e tyre të varësisë ministritë janë përgjegjëse filluar nga administrimi fizik i lagunave, administrimi dhe ruajtja e faunës/florës së tyre, ruajtja prej ndotjes ujore lagunore si prej qarkullimit të ujërave apo ndotjeve të

⁹ <https://agronews.al/2020/07/06/peshkimi-pa-kriter-rrezikon-pelikanin-kacurrel-ne-lagunen-e-karavastase/>


njeriut, sigurimi e një biodiversiteti të qëndrueshëm në respekt të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore të vendit etj.

-MTM së bashku me Agjencinë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (në vijim AKZM), u vlerësuan subjekte të këtij auditimi, bazuar kjo në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore dhe konkretisht: Ministria e cila është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit ndërkohë që AKZM me statusin e Drejtorisë së Përgjithshme, është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura ku përfshihen edhe lagunat si ekosisteme, për shkak të statusit në pjesën më të madhe të tyre zonë e mbrojtur. Në varësi të MTM gjendet dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM) e cila është përgjegjëse për monitorimin e elementëve mjedisorë dhe harton raporte monitorimi periodike mbi gjendjen në mjedis.

- MBZHR u vlerësua të ishte subjekt i këtij auditimi pasi kjo ministri ka në fushën e përgjegjësisë së saj shtetërore hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, veprimtari të cilat zhvillohen në laguna. Në strukturën e ministrisë gjendet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (në vijim DPPPA) e cila në objektin e punës së saj ka hartimin strategjive dhe objektivave, për peshkimin, politikat specifike menaxhuese për lagunat bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre duke kryer edhe monitorimin e realizimit të tyre. Kjo drejtori gjithashtu mban dhe përditëson statistikën zyrtare të peshkimit dhe respektimin e politikave të peshkimit, përfshirë speciet në zhdukje.

MBZHR ka si njësi varësie Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit (në vijim DUK) e cila merret me administrimin e rezervës ujore lagunore, përmes furnizimit me ujë të ëmbël nga hidrovoret, por edhe hapjen e grykave të daljes dhe hyrjes së ujit të detit, si dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (në vijim DSHA) e cila merret me administrimin e rezervës së peshkut, ngjalave, midhjeve dhe gjithë gamës së Akuakulturës, mbi kontratat e peshkimit dhe administrimit të përmbushjes së tyre.

Grafiku nr.1 Skema për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë



Burimi: MTM dhe MBZHR përpunuar nga grupi i auditimit

Në konceptin formal Laguna është pjesë e një ekosistemi ujor, në lidhje permanente me detin por që furnizohet edhe prej burime ujore të ëmbla, është qendra substanciale e një zone kombëtare të mbrojtur e cila administrohet nga institucioni i varësisë së MTM, AKZM-ja, agjenci e cila

përfaqësohet në mënyrë kapilare në administrimin e zonave lagunore e më gjerë se atë ligatinore, në çdo qark përmes Administratës së Zonave të Mbrojtura (në vijim AdZM). Për përmbushjen e misionit ligjor të ruajtjes dhe administrimit më efikas të lagunave kërkohet një bashkërendim, dhe bashkëpunim ndërinstitucional mes ministrive dhe organeve të varësisë.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 10 datë 26.02.2015, (V-10/15).
- Konventa Ramsar, aderuar nga Republikën e Shqipërisë në 29.02.1996, për zonat ligatinore të mbrojtura, ku përfshihen Lagunat;
- Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”;
 - Ratifikuar me Ligjin nr. 9424, datë 06.10.2005, “Për ratifikimin e “protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor”;
- Konventa e Bernës, “Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitatet Natyrore Evropiane”, mbi speciet e rrezikuara përfshirë lagunat;
- Konventë lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, ratifikuar nga Republikën e Shqipërisë datë 10.07.1989, përfshirë lagunat që kanë elemente të trashëgimisë kulturore;
- Ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”;
- Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”;
- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8743, datë 22.02.2011, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar;
 - Efektiv deri në vitin 2020, ndryshuar me ligjin nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”;
- Ligji nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 701, datë 12.10.2016, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Peshkimit 2016–2021”;
- VKM nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”;
- VKM Nr. 598, datë 01.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”;
- VKM nr. 102 datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, i ndryshuar.
- Dokumenti i politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Dhjetor 2015;
- VKM Nr. 59, datë 26.01.2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (kategoria II) të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”;
- VKM Nr. 60, datë 26.01.2022, “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (kategoria IV), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”.
- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

- Praktika të mira.
 - Raporti Special i ECA¹⁰, **PE 573.305 - Prill 2016**, mbi **auditimin e lagunës së Venecias**.
 - Raporti i OKB-së 2018, ECE/CEP/183¹¹, seria nr. 47, deri në 16 Nëntor 2017 “Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (ECE) Rishikimi i Performancës Mjedisore (EPR) për Shqipërinë.”
 - Raporti i SHBA **për lagunat detare** MEPC 61/INF.9¹², datë 25 Qershor 2010, “Interpretimet dhe ndryshimet e Marpol dhe instrumentet lidhur. Përcaktimi i një zone të kontrollit të shkarkimeve për oksidet e azotit, oksidet e squfurit dhe grimcat. Dorëzuar nga Shtetet e Bashkuara.”

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Lagunat e vendit janë zona të mbrojtura mjedisore për vetë rëndësinë që këto ekosisteme ujore mbartin. Në këtë kontekst, institucionet përgjegjëse kanë për detyrë ruajtjen e burimeve natyrore dhe biologjike të këtyre ekosistemeve si dhe administrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre.

Në zbatim të Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar është Ministria përgjegjëse për mjedisin MTM e cila harton planet mjedisore në mënyrë periodike për secilin nga përbërësit e mjedisit, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave ndërsa AKZM është institucioni qendror përgjegjës për kontrollin dhe administrimin e zonave të mbrojtura referuar Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Duke qenë se këto ekosisteme ujore shfrytëzohen edhe për peshkim është Ministria përgjegjëse për bujqësinë MBZHR e cila harton politikat strukturore në peshkim pjesë e politikave të përgjithshme të cilat rishikohen të paktën një herë në katër vjet. Nëpërmjet strukturave përgjegjëse kjo ministri duhet të orientohet drejt shfrytëzimit racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe ruajtjes së biodiversitetit. Në varësi të MTM dhe MBZHR janë edhe institucione të tjera varësie të cilat në kuadër të veprimtarisë së tyre ndikojnë gjithashtu në ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit të tilla si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, etj.

2.4 Pesha në buxhet

Ministria e Turizimit dhe Mjedisit

Buxhetet vjetore për sistemin e menaxhimit të zonave të mbrojtura për vitin 2019-2020-2021 janë përcaktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nga pjesa e akredituar e fondeve të buxhetit të shtetit për të në bazë të ligjit për buxhetin sipas kuotave të caktuara, por e pa ndarë për lagunat, ato i adresohen direkt AKZM e cila merret me menaxhimin e tyre po me të njëjtën mënyrë. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në qendër ka 8 punonjës me funksion specialistë monitorimi dhe 33 roje mjedisore, që monitorojnë zonat e mbrojtura mjedisore, ku përshihen ligatina apo laguna. Fondet buxhetore të planifikuara për AKZM dhe realizimi i tyre paraqitet sipas tabelave të mëposhtme;

Projektet me financim të huaj për përmirësimin e lagunave për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit janë:

-Programi Ndërkombëtar i Bashkëpunimit Interreg , Ballkan -Mesdhe 2014-2020. Marrëveshja midis palëve, ku Shqipëria është përfituesi i pestë, Projekti “Përmirësimi i efektivitetit të ruajtjes së lagunave” ku kontributi i Bashkimit Europian për Shqipërinë është 85% ose 104,187 Euro dhe Kontributi Kombëtar është 15 % ose 18,386 Euro, Buxheti në total 122,573 Euro.


¹⁰ [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/573305/EPRS_STU\(2016\)573305_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/573305/EPRS_STU(2016)573305_EN.pdf)

¹¹ https://unece.org/sites/default/files/2021-08/ECE.CEP_183_Eng.pdf

¹² <https://www.epa.gov/sites/default/files/2016-09/documents/mepec61-inf-9.pdf>

-Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara (UNEP) periudha e implementimit 2013-2022 “Ndërtimi i elasticitetit të lagunës “Kune-Vain” përmes përshtatjes së bazuar në ekosistemin (EbA)”, projekt me financim të huaj me kosto totale 13,431,872 USD.

Grafiku nr. 2 Fondet e akorduara nga MTM për AKZM për lagunat/ligatinat



Punoi: Grupi i auditimi



Në mënyrë analitike të dhënat buxhetore të realizuara sipas periudhave paraqiten:

Tabela 3. Shpenzimet buxhetore Viti 2021

Në lekë

Nr.	Emertimi	Vlerat e shpenzuara për lagunat dhe ligatinat	Buxheti Total	(%) e shpenzimeve që zënë ndaj totalit
1	Fondi per paga	633,568	186,343,402	0.34%
2	Fondi per sigurime shoqerore	106,536	31,334,126	0.34%
3	Shpenzimet operative(mallra e sherbime) ne total	184,642	54,306,532	0.34%
4	Investime	78,781,466	154,386,647	51.03%
Totali		79,706,212	217,677,528	36.62%

Burimi: MTM

Për periudhën viti 2021 të ardhurat nga e arkëtuara nga tarifa për vizitorët në Lagunën e Vainit janë në shumën 454,000 lekë.

Tabela 4. Shpenzimet buxhetore Viti 2020

Në lekë

Nr.	Emertimi	Vlerat e shpenzuara për lagunat dhe ligatinat	Buxheti Total	(%) e shpenzimeve që zënë ndaj totalit
1	Fondi per paga	603,855	177,604,353	0.34%
2	Fondi per sigurime shoqerore	98,215	28,886,831	0.34%
3	Shpenzimet operative(mallra e sherbime) ne total	134,297	39,499,203	0.34%
4	Investime	6,504,000	71,543,492	9.09%
Totali		7,340,367	317,533,879	2.31%

Burimi: MTM

Për periudhën viti 2020 të ardhurat nga e arkëtuara nga tarifa për vizitorët në Lagunën e Vainit janë në shumën 103,000 lekë.

Tabela 5. Shpenzimet buxhetore Viti 2019

Në lekë

Nr.	Emertimi	Vlerat e shpenzuara për lagunat dhe ligatinat	Buxheti Total	(%) e shpenzimeve që zënë ndaj totalit
1	Fondi per paga	655,155	192,692,548	0.34%
2	Fondi per sigurime shoqerore	109,180	32,111,762	0.34%
3	Shpenzimet operative(mallra e sherbime) ne total	157,854	46,427,591	0.34%
4	Investime	6,928,532	39,402,309	17.58%
Totali		7,850,720	310,634,210	2.53%

Burimi: MTM

Për periudhën viti 2019 të ardhurat e arkëtuara nga tarifa për vizitorët në Lagunën e Vainit janë në shumën 98,000 lekë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural


Investimi i parashikuar në vlerën 70,000,000 lekë (shtatëdhjetë milion) për tu realizuar gjatë vitit 2022 për thellimin e grykëderdhjes së kanalit Butrint me detin, Loti I, vjen si nevojë e mbushjes ndër vite të kanalit nga prurjet, duke mos lejuar qarkullimin e mirë të ujërave dhe ruajtjen e parametrave hidrologjike dhe fiziko-kimik. Ky investim konsiston në thellimin e grykëderdhjes së kanalit kryesor, duke përmirësuar ujë këmbimin e kësaj lagune me detin, me një impakt pozitiv në gjithë parametrat hidrologjike dhe fiziko-kimike (oksigjeni tretur, temperatura, kripshmëria, fitoplanktoni dhe ndotësit) të këtij ekosistemi dhe në kapacitetin prodhues të lagunës të Butrintit.

Tabela 6. Treguesit buxhetorë për peshkimin dhe akuakulturën në MBZHR /000 Lekë

Periudha	2019	2020	2021
	Realizim	Realizim	Realizim
Nga 2019-ta Produkti buxhetor 90503AB Kontrolllet e Inspektoratit të Peshkimit në subjektet e peshkimit	12,260	12,700	12,263
Nga 2019-ta Produkti buxhetor 90503AAD Raporte të kryerapër një monitorim të aktivitetëve të peshkimit, akukultures dhe molusqeve	14,511	7,400	13,294
Vlera e buxhetuar dhe realizuar	26,771	20,100	25,557
Fondet Buxhetore gjithsej	7,262,077	10,040,608	12,849,087
Në %	0.37%	0.20%	0.20%

Burimi: MTM përpunuar nga grupi i auditimit:

Grafiku nr. 3 Fondet e akorduara nga MBZHR



Punoi: Grupi i auditimit

■ Buxheti vjetor i shpenzuar për ligatinat ■ Buxheti vjetor i MBZHR

2.5 Feedback-u i subjektit përgjatë auditimit

-Gjatë fazës studimore Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura u përgjigjën përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, si edhe plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet.

-Gjatë fazës së auditimit në terren ndryshe nga MBZHR e cila ka vijuar me të njëjtin disponibilitet në dhënien e informacionit, nga ana e MTMT ka patur vonesa të theksuara në përgjigje dhe në paraqitjen e të dhënave të kërkuara. Përfaqësuesit e kësaj ministrie, nuk arritën të garantonin disponibilitetin e dakordësuar në fillim të auditimit për t'iu përgjigjur në mënyrë të rrjedhshme kërkesave të grupit të auditimit.

Ndërkohë, AKZM e ndodhur në proces ndryshimesh të njëpasnjëshme të titullarëve, tre të tillë gjatë procesit të auditimit, shfaqti të njëjtat problematika si MTM. Me komandimin së fundi të znj. P., titullar institucioni, pati një reflektim pozitiv mbi situatën por megjithatë, grupi auditues paraqet në tërësi rezerva, mbi mungesën e komunikimit nga MTM dhe AKZM në qendër, çka kërkon vëmendjen e nevojshme nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit lidhur mbi ushtrimin detyrave të ngarkuara nga këta punonjës dhe etikën institucionale gjatë përmbushjes së tyre.

Vlen të theksojmë gjithashtu se, ndryshe nga institucionet qendrore grupi i auditimit, përgjatë gjithë procesit auditues, gjeti gatishmërinë e strukturave vendore të AKZM dhe drejtuesve të tyre për verifikimin në terren të situatës në laguna por dhe diskutimin e problematikave të cilat riskojnë këto ekosisteme.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën PESTLE duke marrë në konsideratë risqet e gjashtë fushave të ndryshme në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht në nivelin politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor e mjedisor. Analiza PESTLE është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar.¹³ Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë risku ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse ishte e nevojshme mund të kryhej një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuar. Kjo analizë krahas risqeve që lidhen me politikat është fokusuar edhe në risqet ekonomike, sociale e mjedisore duke qenë se politikat mjedisore kanë pasoja drejtpërsëdrejti në të tre këto fusha.

¹³ www.free-management-ebooks.com. 2013 ISBN 978-1-62620-998-5

Tabela. 7: Analiza e Riskut

P Political	E Economic	S Social	T Technological	L Legal	E Environment
*Konventa Natyra 2000 *Strategjia Europiane për Biodiveristetin 2030 *Mungesa e një strategjie për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.	*Mungesë buxhetesh të dedikuara. *Nevoja për mirmbajtje. *Mospërdorim i të ardhurave të gjeneruara.	*Mungesë informacioni mbi rëndësinë dhe impaktin e lagunave. *Mungesë e konsultimit me publikun. *Lëvizjet demografike dhe krijimi i qendrave urbane.	*Mungesë sistemesh të unifikuara informimi online. *Mungesë e internetit në territorin e vendit. *Vështirësitë në përdorimin e teknologjisë.	*Mbivendosje e akteve ligjore. *Ndryshime strukturore. *Dublime kompetencash midis strukturave . *Mungesa e akteve nënligjore.	*Ndotje mjedisore të cilat nuk kanë marrë akoma zgjidhje. *Ngrohje globale. *Ndotje akustike.


Burimi: Grupi i auditimit

3.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë “Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e lagunave” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të mbrojtjes dhe mirë administrimit, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë në këtë proces. Në këtë mënyrë është siguruar një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse institucionet përgjegjëse kanë prodhuar struktura dhe politika të përshtatshme në drejtim të ruajtjes së ekosistemeve dhe mirë administrimit brenda kompetencave dhe përgjegjësi të tyre.

Shqipëria dallohet për larminë e madhe të biodiversitetit dhe peizazheve. Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve krijojnë kushte të favorshme për mbajtjen dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh të florës dhe faunës, përfshirë një sërë llojesh endemike dhe sub-endemike. Zonat detare e bregdetare janë më të pasurat në biodiversitet. Ekosistemet komplekse të lagunave bregdetare strehojnë mbi 70% të vertebrorëve në vend, veçanërisht shpendë shtegtarë dhe dimërues. Rreth 70 lloje shpendësh uji gjenden çdo vit në lagunat bregdetare duke numëruar mbi 180'000 individë gjatë dimrit. Shqipëria është edhe një rrugë e rëndësishme shtegtimi për faunën e egër. Disa prej zonave bregdetare (Liqeni i Shkodrës-Velipoje, Laguna e Karavastasë, Butrinti) janë me rëndësi ndërkombëtare ndaj janë përfshirë në listën e ligatinave të rëndësishme veçanërisht për shpendët e ujit (Lista Ramsar). Gjithashtu duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për ruajtjen e biodiversitetit qeveria Shqiptare ka propozuar përfshirjen e tyre në listën e zonave të rëndësishme për shpendët (IBA). Në përbërjet të trashëgimisë natyrore ka edhe objekte, peizazhe, ekosisteme, habitate më të veçanta, të rralla apo unikale, relikte, endemike apo të rrezikuara për t'u zhdukur. Si të tilla, ato kanë rëndësi të madhe shkencore, kulturore, didaktike, por edhe turistike. Prandaj ruhen e mbrohen edhe me forma e mënyra shumë më të rrepta, të përcaktuara saktë dhe prerë në ligje të veçanta. Të gjitha këto objekte, peizazhe, habitate e ekosisteme cilësohen trashëgimi natyrore e veçantë, që kushtëzohet vetëm nga ligjësitë natyrore, ndërsa veprimtaria njerëzore ushtrohet vetëm për t'i mbrojtur dhe për t'i evidentuar vlerat e tyre, që shprehen në bio diversitetin, shumë të pasur dhe në peizazhin e veçantë. Me anë të këtij objektivi arritëm të konkludojmë mbi politikat e ndërmarra dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre.

3.3 Pyetjet e auditimit



Burimi: Grupi i auditimit

Pyetja kryesore: A kanë qenë efektive politikat në ruajtjen dhe administrimin e lagunave për periudhën Janar 2019 – Janar 2022 ?

Nënpyetjet e nivelit të parë: A kanë siguruar politikat dhe aktet rregullative mbrojtjen e biodiversitetit në laguna?
A kanë përmbushur institucionet përgjegjëse detyrimet e tyre në ruajtjen dhe administrimin e lagunave?

Nënpyetjet e nivelit të dytë: A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe administrimin e lagunave?
A është përmbushur objektivi i mbrojtjes së biodiversitetit në laguna?
A ka patur bashkëveprim dhe koordinim mes aktorëve të përfshirë?
A ka patur mirëmenaxhim të lagunave nga institucionet përgjegjëse?

3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim kishte si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një vlerësimi objektiv dhe të pavarur mbi efektivitetin e politikave të ndërmarra në ruajtjen dhe administrimin e lagunave të Republikës së Shqipërisë. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij kishte një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e funksionalitetit që institucionet e ngarkuara për ruajtje dhe administrim të lagunave kanë në lidhje me zbërthimin e politikave dhe implementimin e tyre. Në këtë auditim nuk jemi fokusuar specifikisht në procedurat dhe procese të veçanta duke qenë se fokusi ynë ka qenë kryesisht drejt politikave të hartuara dhe implementimit të tyre. Periudha e auditimit ishte Janar 2019 - Janar 2022. Auditimi u fokusua në tre institucione, konkretisht Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, çka ka shërbyer për të patur një panoramë më të plotë lidhur me politikat e ndërmarra, implementimin e tyre, koordinimin ndërmjet strukturave dhe krahasimin e qasjes që ato kanë në varësi të specifikave mbi territorin që mbulojnë.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

1. Pyetja kryesore: A kanë qenë efektive politikat në ruajtjen dhe administrimin e lagunave për periudhën Janar 2019 – Janar 2022 ?

Zonat detare e bregdetare janë më të pasurat në biodiversitet. Aktualisht, lagunat janë ekosistemet më të përfaqësuara në bregdetin shqiptar, të cilat kanë rol mjaft të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit. Ruajtja e tyre është thelbësore për mbrojtjen e biodiversitetit si dhe arritjen e objektivave kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pavarësisht faktit që lagunat gjenden totalisht brenda zonave të mbrojtura nuk kanë patur vëmendjen e nevojshme dhe nuk i kanë shpëtuar problematikave të ndërtimeve të padisplinuara, ndotjes, tjetërsimit, apo shfrytëzimit pa kriter. Sa i përket ruajtjes dhe administrimit të tyre, nga ana e institucioneve përgjegjëse kanë munguar politika të qarta dhe të mbështetura në studime si dhe masat e nevojshme për një monitorim permanent dhe efektiv. Mangësitë në bazën ligjore ekzistuese, mbivendosja e strukturave dhe kompetencave, mungesa e kontroleve konsistente, bashkëveprimi i pamjaftueshëm ndër-institucional si dhe buxhetet e pamjaftueshme të akorduara kanë ndikuar negativisht në ruajtjen dhe mirëadministrimin e këtyre ekosistemeve. Për rrjedhojë, problematikat e evidentuara kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe të qëndrueshme nga ana e institucioneve përgjegjëse në mbrojtje të këtyre pasurive të rëndësishme kombëtare.

1.1 Pyetje e auditimit: A kanë siguruar politikat dhe aktet rregullative mbrojtjen e biodiversitetit në laguna?

1.1.1 A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe administrimin e lagunave?

Ligatinat e shëndetshme janë jetike për përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit. Ato ofrojnë shërbime të ekosistemit të dobishme, të tilla si, ruajtja e ujit, pastrimi i ujit, zonat rekreative, habitatet e shpendëve, etj.. Ruajtja dhe restaurimi i ligatinave është thelbësor për arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit¹⁴, ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit si dhe arritjen e objektivave në kuadër të Zhvillimit të Qëndrueshëm¹⁵.

¹⁴ <https://www.mod.gov.al/images/struktura-vartese/AKMC/legjislacioni/Ligji-75-2016-konventa-okb-klime.pdf>;

¹⁵ Objektivi 14 dhe 15, <http://www.instat.gov.al/al/sdgs/>;

Lagunat bregdetare dhe grykëderdhjet e lumenjve në vendin tonë janë qendra të rëndësishme për dimërimin e shpendëve migratorë të ujit, në të cilat janë regjistruar rreth 70 lloje të shpendëve të ujit. Çdo lagunë ka statusin e mbrojtjes sipas zonës që e përfshin atë, në referencë të nenit 14 të ligjit nr. 81/2017, i cili përcakton kategoritë e zonave të mbrojtura. Kryesisht, lagunat që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë kanë status, si më poshtë:

- Park kombëtar (kategoria II);
- Park natyror (kategoria IV); dhe
- Peizazh i mbrojtur (kategoria V).

Ndërkohë, disa nga këto zona lagunore janë edhe me interes ndërkombëtar dhe bëjnë pjesë në të paktën një nga kategoritë, si:

- Zona “Ramsar”;
- Zona me interes për Komunitetin European (SACs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs);
- Zona me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald);
- Zona “Rezervë të biosferës”; dhe
- Zona e trashëgimisë natyrore¹⁶.

Për shkak të rëndësisë që këto zona paraqesin, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në MTM, sipërfaqet e zonave ligatinore, pjesë integrale e të cilave janë edhe lagunat, janë zona të mbrojtura në masën 100% të tyre dhe përbëjnë 5.40%¹⁷ të sipërfaqes totale të zonave të mbrojtura.

Për rrjedhojë, detyrimet që diktohen mbi këto zona nuk janë vetëm të karakterit kombëtar por edhe ndërkombëtar. Disa nga Instrumentat ndërkombëtarë, të ratifikuar nga RSH dhe që përcaktojnë detyrime për ruajtjen dhe konservimin e këtyre zonave janë: Konventa mbi Biodiversitetin Biologjik, e ratifikuar më datë 5 janar të vitit 1994, Konventa e Ramsarit për mbrojtjen e ligatinave, hartuar në vitin 1971, e cila ofron kuadrin ligjor ndërkombëtar për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të lagunave, Plani Kombëtar i Integritit European (PKIE)¹⁸, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, etj..

Kuadri rregullator kombëtar, i nevojshëm për mirëadministrimin e lagunave përbëhet nga: dokumente strategjike, akte ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat kanë si qëllim shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë.

Nga sa më sipër, problematikat e konstatuara lidhur me kuadrin rregullator, do të trajtohen sipas pikave në vijim:

- Nevoja e hartimit të një Strategjie aktuale Kombëtare të Biodiversitetit dhe e akteve të tjera rregullatore, **nga MTM**, me qëllim mirëadministrimin dhe ruajtjen e sitemit lagunor;
- Problematikat e konstatuara në përcaktimet e Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe implementimin e tij në praktikë;
 - Vështrim krahasimor i Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” me Ligjin nr. 64/2012 “Për Peshkimin”;
 - Vështrim krahasimor i Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” me Ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”;

¹⁶ Neni 6 i Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura- Llojet e zonave të mbrojtura;

¹⁷ Tabela 1, fq.4 e Projekt-Raportit;

- Vështrim krahasimor i Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” me Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.
- Rishikimin i Statusit dhe Sipërfaqes të Zonave të Mbrojtura;
- Mungesa e hartimit të akteve rregullatore, **nga AKZM**, me qëllim mirëadministrimin dhe ruajtjen e sitemit lagunor;
- Mungesa e hartimit të një Strategjie aktuale Kombëtare të Peshkimit dhe mungesa e hartimit të akteve të tjera rregullatore, **nga MBZHR**, me qëllim sigurimin e një aktiviteti të kontrolluar dhe të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore të peshkimit në laguna.
- **Nevoja e hartimit të një Strategjie aktuale Kombëtare të Biodiversitetit dhe e akteve të tjera rregullatore, nga MTM, me qëllim mirëadministrimin dhe ruajtjen e sitemit lagunor**

Konventa mbi Biodiversitetin Biologjik parashikon dy instrumenta kryesor kombëtarë me qëllim implementimin e saj, të cilat janë: Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Planet e Veprimit për zbatimin e saj. Lidhur me këtë fakt, Konventa kërkon që vendet të hartojnë një Strategji Kombëtare të Biodiversitetit (ose instrument ekuivalent) dhe të sigurohen që kjo strategji të jetë e kanalizuar në planifikimin dhe aktivitetet e të gjithë sektorëve, të cilët mund të kenë një ndikim (pozitiv apo negativ) mbi biodiversitetin.¹⁹

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Zhvillimit të Mjedisit, është përgjegjëse për formulimin e politikave për mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e dokumenteve strategjike në këtë fushë. Sa kaq, nëpërmjet VKM nr. 31, datë 20.01.2016 është hartuar “Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, akt ky i cili ka pasur fuqi juridike deri më vitin 2021. Pavarësisht rëndësisë dhe ndjeshmërisë që paraqet ruajtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit, pas përfundimit të efektit juridik të strategjisë së mëparshme, 2021 e në vijim, MTM nuk ka marrë masa për hartimin e një Dokumenti të ri të Politikave Strategjike. Për rrjedhojë, aktualisht në MTM nuk ka një Strategji e cila përcakton objektivat kryesorë për ruajtjen e biodiversitetit dhe as plane veprimi, pavarësisht se ky detyrim diktohet nga Konventa mbi Biodiversitetin Biologjik, me qëllim implementimin e objektivave të saj dhe përcaktimin e objektivave kombëtarë në kuadër të ruajtjes së biodiversitetit.

Njëkohësisht, MTM si institucioni përgjegjës qendror politikbërës për administrimin e zonave të mbrojtura, nuk ka marrë masa mbrojtëse për “Zonat e veçanta të ruajtjes”, ku përfshihen Planet e Menaxhimit të hartuara për zonat ose të integruara në plane të tjera zhvillimi, si dhe masa juridike, administrative, teknike, në përputhje me kërkesat ekologjike të tipave të habitateve natyrore dhe të llojeve, me interes për komunitetin europian.²⁰

MTM nuk ka hartuar një Plan për Administrimin e Rrjetit Ekologjik, detyrim ky që buron nga neni 10 pika 1 i ligjit për zonat e mbrojtura dhe as nuk ka identifikuar masat që lidhen me administrimin e zonave të mbrojtura ekzistuese, klasifikimin e tyre, të rrjetit ekologjik, të zonave “Ramsar”, identifikimin e zonave të reja dhe procedurat për shpalljen e tyre. Në intervistën për konfirmimin e të dhënave zyrtare, MTM është shprehur se ky është një detyrim i AKZM dhe AdZM-ve, ndërkohë që, nëse i referohemi nenit 37 pika 3.a të ligjit për zonat e mbrojtura, konstatohet lehtësisht se ky detyrim bie në mënyrë të qartë dhe eksplicite mbi MTM. Më konkretisht, neni 37 pika 3.a përcakton se:

“3. Detyrat kryesore të ministrisë janë: a) identifikimi i masave që lidhen me administrimin e zonave të mbrojtura ekzistuese, klasifikimin e tyre, të rrjetit ekologjik, të zonave “Ramsar”, identifikimin e zonave të reja dhe procedurat për shpalljen e tyre;”.

¹⁹<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf>, fq. 9;

²⁰ Neni 32 pika 2 e ligjit për ZM;

Nga sa më sipër, MTM nuk e ka përmbushur këtë detyrë funksionale.

Me qëllim mirëfunksionimin dhe bazuar në parimin e shtetit ligjor, Institucionet që kryejnë veprimtari administrative nxjerrin akte nënligjore, pjesë e Burimeve të tyre Formale, ku bazojnë funksionimin dhe veprimtarinë e tyre institucionale. MTM, në përmbushje të kompetencave të saj, ka hartuar “Rregulloren për Organizimin e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, të miratuar me Urdhrin Ministri nr. 420, datë 07.11.2018. Në këtë rregullore nuk përcaktohen përshkrimet e vëndit të punës dhe objektivat për secilin pozicion pune, në përputhje me strukturën organizative_institucionale. Qëllimi i rregullores së brendshme është përshkrimi analitik i pozicioneve të punës, me qëllim që çdo punonjës të ketë të qartë tagrat institucional të tij dhe të jetë eficient në realizimin e detyrave të veta, në përmbushjen e objektivave institucionale. Mungesa e përshkrimit të vëndeve të punës për secilin pozicion krijon konfuzion në detyrat që duhen të përmbushen dhe realizohen nga punonjësit dhe ndikon në mospërmbushjen e misionit institucional, duke cenuar kështu efektivitetin institucional dhe eficiencën e secilës strukturë.

- **Problematikat e konstatuara në përcaktimet e Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe implementimin e tij në praktikë**

Kuadri legjislativ kryesor në ruajtjen dhe administrimin e lagunave përbëhet nga Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i cili përcakton kriteret për shpalljen e zonave të mbrojtura, si dhe njeh zona të veçanta të mbrojtura me interes për Komunitetin Evropian. Institucionet përgjegjëse për implementimin e këtij ligji janë MTM dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM). AKZM u krijua në Shkurt 2015 si një institucion në varësi të Ministrisë së Mjedisit, që krijoi për herë të parë në vend administrata të pavarura të Zonave të Mbrojtura në nivel qendror dhe rajonal dhe ka kompetenca ekskluzive në administrimin e lagunave.

Nga një interpretim literal i dispozitave ligjore të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, konstatohet se ky ligj nuk është hartuar konform parimeve të teknikës legjislative.

Ligji për ZM dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij duhet të kenë terminologji të unifikuar dhe uninforme, me qëllim qartësinë e tyre dhe implementimin me efektivitet. I njëjti term duhet të përdoret për të njëjtin rast dhe një term i ndryshëm për një rast të ndryshëm. MTM dhe AKZM gjatë përpilimit të akteve rregullatore nuk e kanë marrë në konsideratë gjithmonë këtë parim të teknikës legjislative, duke krijuar paqartësi në përmbajtjen e akteve. Më konkretisht, nga shqyrtimi i akteve ligjore dhe dokumentacionit të administruar, grupi i auditimi konstatoi se lagunave ju referohen me termin: “laguna”, “liqen”, “godullë”, “kërnice”, “merxhan”, “kënetë”, etj.. Kjo problematikë e unifikimit dhe njëtrajtësisë të terminologjisë së përdorur vjen për faktin se në ligjin për zonat e mbrojtura mungon një përkufizim i qartë i termit lagunë.

Në pikën 1 të nenit 3 Përkufizime, përcaktohet se: “*Administrata e zonës së mbrojtur (AZM)*” është organi vendor përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e një zone të mbrojtur”, ndërkohë që referuar organigramës dhe strukturës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, kjo agjenci është e përbërë nga institucioni i saj qendror (AKZM) dhe nga administratat rajonale të saj (AdZM). Sa kaq, AZM nuk ekziston si strukturë dhe për rredhje ky përkufizim nuk gjen zbatim praktik.

Në nenin 3 “përkufizime” përcaktohen gjithashtu edhe:

“35. “*Shkallë e parë mbrojtjeje (strikte)*” është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore të shqetësuar.

36. “*Shkallë e dytë mbrojtjeje*” është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike.

37. “*Shkallë e tretë mbrojtjeje*” është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike, të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit.”

Përkufizimet e përcaktuara më sipër janë të paqarta. Në bazë të parimeve të teknikës legislative, përcaktimet ligjore duhet të hartohen në një gjuhë po aq të thjeshtë sa edhe të saktë e konçize. Njëkohësisht, për shkak të rëndësisë që paraqesin shkallët e mbrojtjes në kuadër të ruajtjes, administrimit, menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, duhet të trajtoheshin në një dispozitë të posaçme dhe jo tek përkufizimet ligjore. Në përmbajtje të dispozitave vijuese të ligjit, nuk ka asnjë përcaktim lidhur me shkallët e mbrojtjes. Gjithashtu, nga një interpretim literal i ligjit për zonat e mbrojtura, konstatojmë së terminologjia e përdorur për shkallët e mbrojtjes nuk është e unifikuar. Konkretisht, në përmbajtje të dispozitave, diku hasim termin “*zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes*”, diku “*Shkalla e parë/dytë/tretë e mbrojtjes*”, diku “*zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore...*”, diku “*zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”*”, etj.. Mungesa e unifikimit të terminologjisë së përcaktime ligjore jo vetëm që zbeh efektivitetin e ligjit, por njëkohësisht e bën atë më pak të lexueshëm për qytetarët si dhe më të debatueshëm për institucionet përgjegjëse për implementim.

Njëkohësisht, neni 7 pika 1 i ligjit për zonat e mbrojtura shprehet se zonat e mbrojtura mjedisore në RSH janë pasuri kombëtare. Referuar Akteve ligjore në fuqi dhe doktrinës juridike e cila trajton konceptin e termit “pasuri”, tre janë format e pasurisë: **shtetërore**, **publike** dhe **private**, të cilat më pas ndahen në të luajtshme apo të paluajtshme në bazë të karakteristikave dhe përkufizimeve ligjore. Nga ana tjetër, ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, në nenin 3 pika 9 dhe 10 të tij përcakton se:

“9. Pasuri e paluajtshme shtetërore” është sendi i paluajtshëm në pronësi të pushtetit qendror ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore”.

10. “Pasuri e paluajtshme publike” është sendi i paluajtshëm në pronësi të shtetit, që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell përfitime në favor të publikut të gjerë”. Bazuar në Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, i azhornuar, neni 3 pika 1.a përcaktohet se lagunat i përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike. Për rrjedhojë, konceptet e përdorura për pronësinë në ligjin për zonat e mbrojtura duhet të jenë në përputhje me tërësinë e sistemit të normave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pronësia në zonat e mbrojtura, përveçse në nenin 7 përcaktohet gjithashtu edhe në nenin 52 të ligjit duke krijuar artificialisht rritje të numrit të dispozitave dhe përsëritje të normave ligjore, të cilat sjellin për pasojë mbivendosje të përcaktimeve legislative.

Në vijimësi, neni 8 i ligjit për zonat e mbrojtura përcakton se: *“1. Forma e administrimit/menaxhimit mbi zonat e mbrojtura mjedisore është: a) shtetërore; b) private; c) bashkiake; ç) të kombinuara”.* Ndërkohë që, referuar Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2002 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, i azhornuar, administrimi i pasurisë publike administrohet në mënyrë ekskluzive nga organet shtetërore dhe publike. Për rrjedhojë, përcaktimi i nenit 8 krijon paqartësi në implementimin e tij, duke kërkuar një interpretim se çfarë nënkupton në këtë rast lidhëza “mbi”. Nga një interpretim i zgjeruar i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, grupi i auditimit konstatoi se me lidhëzën “mbi” do të kuptojmë administrimin e veprimtarive dhe të pasurive (private apo shtetërore)²¹ që ndodhen mbi këto zona të mbrojtura. Megjithatë, kjo dispozitë duhet të jetë e formuluar qartë dhe të mos lind nevoja e interpretimit as gjatë leximit të saj dhe as në implementim, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të zonave të mbrojtura, që është edhe objektiv kryesor i këtij ligji.

Nisur nga sa më sipër, pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në zonat e mbrojtura (neni 7 pika 2) dhe administrimi i këtyre pasurive (neni 8), mund të trajtohen në një dispozitë të vetme me qëllim që konceptet të jenë të trajtuara në mënyrë logjike, të qartë dhe shtruesë. Për këtë qëllim shërbejnë paragrafët në tekstet zyrtare, me qëllim mos “copëzimin” e çështjeve të trajtuara dhe rritjen artificiale

²¹ Neni 7 pika 2: “Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në zonat e mbrojtura mjedisore është: a) shtetërore; b) private”;

të dispozitave që përmban ligji.²² Nenet janë ndarja bazë e strukturës së ligjit dhe formati i tyre duhet të jetë i strukturuar në mënyrë të tillë që ta bëjë ligjin të lexueshëm si një të tërë.

Referuar Seksionit IV të ligjit për zonat e mbrojtura, i cili përcakton kategoritë e zonave të mbrojtura, konstatojmë që krahas përcaktimit të zonës, në kllapa, secili nga këto kategorizime përkon me një kategori tjetër nga I-VI. Lidhur me këtë fakt, në asnjë moment në këtë ligj nuk është përcaktuar se çfarë metodologjie është përdorur për këtë kategorizim. Gjithsesi, nga një analizë e zgjeruar e dispozitave ligjore, grupi i auditimit konstatoi se metodologjia e përdorur për kategorizim (I-VI) është bazuar në kufizimet që janë përcaktuar për secilën kategori të zonave të mbrojtura mjedisore, duke i renditur kështu këto zona në një rend numerik nga I-VI për nga rëndësia që paraqesin. Në vijimësi, kur i referohemi përcaktimeve të Kategorisë së II “Park Kombëtar” dhe përcaktimeve të Kategorisë së III “Monument Natyror”, konstatojmë se veprimtaritë që mund të zhvillohen në Kategorinë e III-të²³ janë më të kufizuara se ato të Kategorisë së II-të. Neni 17 i ligjit për zonat e mbrojtura në pikën 2 të tij, përcakton se: “Në një *“Monument natyror”* zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me *“Rezervën strikte”*²⁴”. Për rrjedhojë, duke u bazuar në këtë përcaktim ligjor, “Monumentet e Natyrore” duhet të qendronin të dytat në kategorizim dhe pas tyre, në kategorinë e tretë të vijohen me “Park Kombëtar”.

Në seksionin e VI, neni 33 të ligjit për zonat e mbrojtura përcaktohen veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në këto zona, jo të ndara sipas kategorive specifike (nga I-VI). Nga një interpretim i kësaj dispozite, grupi i auditimit konstatoi se ky është një përcaktim i përgjithshëm dhe evaziv. Kjo dispozitë krijon mbivendosje me dispozitat paraardhëse të ligjit, përkatësisht Seksioni IV “Kategoritë e Zonave të Mbrojtura”. Gjithashtu, kufizimet për kategoritë e zonave të mbrojtura përcaktohen më vete, në dispozita të posaçme për secilën kategori përkatëse (nga I-VI), për rrjedhojë, edhe veprimtaritë që do të ushtrohen në secilën prej këtyre zonave duhet të trajtohen respektivisht në nenet përkatëse të Seksionit IV “Kategoritë e Zonave të Mbrojtura”. Më pas, duke marrë në konsideratë kufizimet e paraktuara dhe veprimtaritë e lejuara, duhet të hartohen “Planet e Menaxhimit” për secilën zonë.

Me qëllim ruajtjen dhe konservimin e zonave të mbrojtura, referuar nenit 51 të ligjit për zonat e mbrojtura, gjuetia është e ndaluar në të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore. Pavarësisht këtij përcaktimi ligjor dhe rëndësisë që paraqet konservimi i këtyre zonave, efekti juridik i Ligjit nr. 61/2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” ka përfunduar, duke lënë kështu të parregulluar vendosjen e sanksioneve kundrejt individëve që shkelin përcaktimin e nenit 51 të ligjit për zonat e mbrojtura, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie. Afati i zbatimit të Ligjit nr. 61/2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” ka qenë pesë vjet, nga data e hyrjes së tij në fuqi. Edhe pse ka kaluar një vit nga përfundimi i efektit juridik të këtij moratoriumi, MTM dhe AKZM nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë për të përcaktuar një plan apo procedurë të qartë sesi do të vijohet. Për rrjedhojë, ky boshllëk ligjor, kërcënon ruajtjen efektive të zonave të mbrojtura lagunore dhe ndikon në pamundësinë e vendosjes së sanksioneve kundrejt individëve që shkelin ligjin.

Në analizë të ligjit për zonat e mbrojtura nga grupi i auditimit, rezultoi gjithashtu se, në nenin 66 të ligjit parashikohet procedura e inspektimit në zonat e mbrojtura. Në pikën 1.a të dispozitës së cituar përcaktohet se: “*Inspektimi i zonës së mbrojtur realizohet nga: a) Inspektorati i Policisë Pyjore, brenda detyrave dhe përgjegjësi të caktuara në dispozitat ligjore në fuqi, i cili kryen funksionet*

²² <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/MANUAL-PER-HARTIMIN-E-LEGJISLACIONIT.pdf>, fq 88;

²³ Në një “Monument natyror” zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”- Neni 17, pika 2 i LZM;

²⁴ “Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)”- Në rezervën strikte natyrore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, pasi në të janë të ndaluara të gjitha aktivitetet njerëzore që mund ta dëmtojnë (neni 15 LZM);

kontrolluese në zonat e mbrojtura, pavarësisht nga forma e pronësisë së administrimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;”

Sa më sipër, pas ristrukturimit të ISHMP-së dhe kalimit të kompetencave të saj pranë IKMT-së, është Sektori i Policisë Pyjore në IKMT, që kryen funksionet inspektuese të zonave të mbrojtura. Ky ndryshim i ndodhur nuk është reflektuar në ligjin për zonat e mbrojtura dhe aktualisht IKMT nuk përmendet në asnjë dispozitë të ligjit si organ kompetent për kryerjen e inspektimeve. Ky boshllëk ligjor rrezikon implementimin efektiv të këtij përcaktimi.

Njëkohësisht, në referencë të Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dispozita 66 e ligjit për zonat e mbrojtura, e cila parashikon inspektimin në këto zona, nuk përcakton procesin e nisjes dhe vijimit të procedurave të inspektimit nga AdZM-të rajonale²⁵. Ky përcaktim nuk rezulton të jetë i parashikuar as në aktet nënligjore në fuqi, duke riskuar në këtë forëm të ruajtjen efektive të këtyre zonave.

Neni 68 i Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” përcakton vlerësimin e dëmit të shkaktuar në zonë të mbrojtur mjedisore. Vlera e dëmit të shkaktuar në ZM përcaktohet në VKM nr. 128, datë 13.02.2020 “Për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyrën e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe legjislacionit përkatës, intervistat e kryera me subjektet nën auditim, grupi i auditimit konstatoi se, VKM nr. 128, datë 13.02.2020 nuk parashikon asnjë përcaktim për dëmet e shkaktuara në laguna. Gjithashtu, ende nuk ka një procedurë të saktë për mënyrën se si AdZM duhet të vlerësojë dhe ndjek procesin e vlerësimit të dëmit dhe kostot për riparimin e dëmit.

○ **Vështrim krahasimor i Ligjit nr. 81/ 2017 “Për Zonat e Mbrojtura” me Ligjin nr. 64/2012 “Për Peshkimin”**

Gjithashtu, pavarësisht faktit se gjatë fazës së miratimit, ligji për zonat e mbrojtura është dërguar për mendim edhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ky ligj dhe Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, kanë mospërputhje në përcaktimet që vendosin.

Nëse i referohemi nenit 34 të ligjit për zonat e mbrojtura, konstatojmë që:

*“1. Peshkimi në zonat e mbrojtura detare e bregdetare I. Në zonat e mbrojtura detare e bregdetare është i ndaluar peshkimi për qëllime tregtimi, referuar dispozitave të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën. Peshkimi tregtar lejohet vetëm në zonat e mbrojtura detare e bregdetare, pjesë e kategorive IV, V dhe VI, **pas miratimit me urdhër të Drejtorit të Përqijthshëm të AKZM-së të kushteve që duhet të zbatohet peshkimi në këtë zonë.***

*2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, peshkimi në zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare dhe peshkimi në ujërat e brendshme, i cili rregullohet me dispozitat e legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën, përpara se të miratohet si aktivitet, merr miratimin me urdhër të ministrit. Në rastet kur aktiviteti është duke u kryer sepse është miratuar apo është kontraktuar më parë, **rregullat do të përcaktohen në marrëveshjen midis subjektit që ushtron veprimtarinë e peshkimit dhe AdZM-së që mbulon zonën e mbrojtur detare a bregdetare,** në bazë të objektivave të mbrojtjes së zonës, kërkesave të planit të menaxhimit të saj dhe lejes së dhënë për peshkim.”*

Ky përcaktim ligjor nuk është i zbatueshëm në praktikë. Lejet e peshkimit jepen vetëm nga Ministria e Bujqësisë dhe AKZM nuk përfshihet në këtë proces. Ky fakt u konstatua nga grupi i auditimit pas konsultimit të Ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin” dhe VKM-së nr. 712, datë 31.07.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore e ujore”. *De facto*, as AKZM nuk ka dhënë miratim për veprimtarinë e

²⁵ Neni 66 pika 1 (b) i ligjit për zonat e mbrojtura;

peshkimit dhe kushteve që duhet të zbatohet peshkimi në ekosistemet lagunore në përputhje me statusin dhe shkallën e mbrojtjes sipas nënzonave për kontratat e nënshkruara rishtazi dhe as nuk ka marrëveshje ndërmjet AdZM-ve dhe subjekteve private në rastet kur aktiviteti është kontraktuar më herët. Mungesa e zbatueshmërisë së këtij përcaktimi ligjor në praktikë cënon mirëadministrimin e ekosistemeve lagunore.

Neni 66 pika 4 i ligjit për zonat e mbrojtura, përcakton gjithashtu se: *“Administrata e zonës së mbrojtur: a) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në zonën e mbrojtur nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe **i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së heqjen e certifikatës/zgjidhjen e kontratës në rastet kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozita;**”*

Ky përcaktim ligjor nuk gjen zbatim në praktikë. Drejtori i Përgjithshëm i AKZM nuk e ka tagrin juridik për zgjidhjen e kontratave të peshkimit. Gjatë hartimit të akteve ligjore duhet bërë një vlerësim i kapaciteteve praktike për implementimin e ligjit dhe të mundësive praktike për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në të. Për rrjedhojë, hartuesit e akteve ligjore e nënligjore duhet që gjithmonë të kenë në konsideratë pyetjen: Si do të sigurohet zbatimi i këtij akti ligjor²⁶, me qëllim që të garantojnë efektivitetin e ligjeve. Një rregull mund të jetë efektiv vetëm në qoftë se zbatohet në praktikë. Një akt ligjor që nuk zbatohet ashtu siç duhet ose që nuk është zbatuar fare, ka efekte negative mbi autoritetin e legjislatorit dhe mbi realizimin e objektivave për të cilin është hartuar.

Sa më lartë, ekzistenca e një mase të madhe rregullash, të cilat ngatërrohen dhe mbivendosen është një pengesë objektive për thjeshtëzimin dhe qartësinë e këtyre akteve. Bazuar në teknikat legjislative, mbivendosja e përcaktimeve ligjore dhe sistemit legjislativ shkakton pasoja negative në sigurinë e së drejtës dhe mundësinë për të parashikuar pasojat juridike, në zhvillimin ekonomik dhe përdorimin e frytshëm të burimeve, në kostot e drejtësisë, si edhe në besimin dhe shtetin ligjor, pasi ligjet e shumta, të pakuptueshme, dispozitat e të cilëve bien ndesh me njëri tjetrin, ngjallin mungesë besimi ndaj ligjit dhe nuk realizojnë misionin për të cilin janë hartuar.²⁷

○ **Vështrim krahasimor i Ligjit nr. 81/ 2017 “Për Zonat e Mbrojtura” me Ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”**

Për shkak të veçantisë që paraqesin ekosistemet lagunore dhe ndikimit pozitiv që ato kanë në mjedis, në vitin 1971 u hartua Konventa Ndërkombëtare e Ramsarit për mbrojtjen e ligatinave. Megjithatë, me rritjen e popullsisë dhe urbanizimin, është rritur kërcënimi i qëndrueshmërisë së këtyre zonave. Për shkak të aktiviteteve njerëzore dhe mungesës së vëmendjes adekuate nga institucionet përgjegjëse, ekosistemet ligatinore, pjesë e të cilave janë edhe lagunat rrezikojnë të shkatërrohen. Shqipëria është nën kërcënim për shkak të praktikës së papërshtatshme dhe të zhvillimit që lidhen me turizmin masiv. Me modelin aktual të zhvillimit të bazuar në sasi, rritja e parashikuar e zhvillimit të turizmit në rajon do të vazhdojë të dëmtojë peisazhin, do të ndikojë në erozionin e tokës, duke ushtruar presion mbi specitë të rrezikuara.²⁸ Njëkohësisht, sforcimi apo përdorimi tej mase i burimeve ujore në dispozicion, rritja e sasisë së mbeturinave dhe shkarkimi i ndotjeve në det veç të tjerave është dhe një përçarje kulturore.

Ndërtimi i lidhur me zhvillimin e turizmit ka shkaktuar dëme të mëdha edhe në ekosistemet e brishta bregdetare dhe detare në vend. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe Strategjia Biodiversitetit

²⁶<https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/MANUAL-PER-HARTIMIN-ELEGJISLACIONIT.pdf>, fq. 23;

²⁷ S. Berberi “Parime dhe Rregulla për Hartimin e Akteve Normative, Teknika Legjislative. Botimet Morava fq. 11;

²⁸<https://www.turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf>, fq. 46;

të BE-së 2030 na orjentojnë drejt një ekonomie të gjerlbërt.²⁹ Përvoja ka treguar se ajo që është e mirë për natyrën është e mirë edhe për ekonominë. Nuk është më një zgjedhje midis natyrës nga njëra anë dhe ekonomisë nga ana tjetër, por një imperativ për t'i bërë të dyja të punojnë në partneritet për të mirën e shoqërisë në tërësi. Për rrjedhojë, legjislacioni për investimet strategjike ngre shqetësime për mbrojtjen e biodiversitetit, pasi mund të lejojë investime të mëdha turistike dhe industriale në zonat e mbrojtura. Në prill të vitit 2021, Shqipëria nënshkroi kontratën për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës brenda Zonës së Mbrojtur Vjosë-Nartë, në kundërshtim me ligjet kombëtare dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit që Shqipëria ka ratifikuar.³⁰ Kjo zonë e mbrojtur është kandidatë për rrjetin e zonës Emerald, e cila ofron strehim për më shumë se 62 lloje zogjsh të listuar në direktivën e BE-së për Zogjtë. Ky konstatim shqetësues pasqyrohet edhe në Progres Raporin e fundit të Komisionit European për Shqipërinë.

○ **Vështrim krahasimor i Ligjit nr. 81/ 2017 “Për Zonat e Mbrojtura” me Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”**

Një zonë mund të jetë pjesë e juridiksionit të Ligjit nr. 27/2018 Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe njëkohësisht edhe e ligjit për zonat e mbrojtura (psh. PK i Butrintit, pjesë e të cilit është edhe laguna e Butrintit, përfshihet edhe Siti arkeologjik i Trashëgimisë Botërore të Butrintit). Kjo lagunë përfshin një sërë habitatesh me rëndësi për shpendët e ujit dhe është e klasifikuar si zonë Ramsar (BirdLife, Zonat e Rëndësishme të Zogjve dhe vendet e mundshme Ramsar në Evropë, 2001). Është zonë kyçe për biodiversitetin (Key Biodiversity Area-KBA) dhe zonë e rëndësishme për shpendët (Important Birds Area -IBA) si një habitat me rëndësi për shpendët migratorë, aprovuar sipas Urdhrit të Ministrisë së Mjedisit nr. 283, date 10.04.2013, “Mbi aprovimin e ligatinave bregdetare, të cilat shërbejnë si habitate për shpendët migrator”, të amenduar dhe njëkohësisht zonë e rrjetit Emerald.

Në këto kushte është e domosdoshme që ligji për zonat e mbrojtura dhe ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë të jenë në përputhje me njëri tjetrin dhe institucionet përgjegjëse politikbërëse, përkatësisht MTM dhe MK të bashkëpunojnë në mënyrë që në planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe planin e menaxhimit të pasurisë kulturore komponentët mjedisor dhe kulturor të trajtohen me po të njëjtin prioritet.

Këto pasuri janë të çënueshme dhe nëse keqmenaxhohen, vihet në rrezik integriteti i tyre në terma afatgjatë³¹. Mënyra e menaxhimit të këtyre zonave duhet të jetë e unifikuar për shkak të rëndësisë që paraqesin. Për rrjedhojë, bashkëpunimi ndërmjet MTM dhe Ministrisë së Kulturës për mënyrën e menaxhimit dhe planifikimin e aktiviteteve që do të zbatohen, në këto raste është i nevojshëm për mirëadministrimin e këtyre zonave dhe konservimin efektiv të tyre.

Në përfundim, kuadri legjislativ dhe implementimi me efektivitet i dispozitave ligjore në kuadër të ruajtjes dhe administrimit të lagunave specifikisht por edhe të zonave të mbrojtura në tërësi mbetet i dobët dhe nuk është efektiv. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Komisioni European, të cilin e ka reflektuar në Progres Raporin e vitit 2021 për Shqipërinë në kapitullin 27 të tij “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.³²

²⁹ https://ec.europa.eu/environment/strategy/biodiversity-strategy-2030_en;

³⁰ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en, 114;

³¹ <https://www.shqiperia.com/blog/skandali-butrinti-me-koncesion-me-marreveshje-sekrete-dokumenti-i-depozituar-ne-kuvend-ka-vetem-1-nen/>; <http://www.panorama.com.al/skandali-butrinti-me-koncesion-me-marreveshje-sekrete-cfare-fshihet-pas-dokumentit-te-depozituar-ne-kuvend/>; <https://telegraf.al/politike/skandali-i-ligjit-me-porosi-edhe-butrinti-si-inceneratoret/>; etj.;

³² “Take immediate measures to fight environmental crime and increase policy and law enforcement for nature and biodiversity protection, especially in the protected areas”, fq. 113

• Rishikimin i Statusit dhe Sipërfaqes të Zonave të Mbrojtura

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59 dhe nr. 60, datë 26.01.2022 është miratuar rishikimi i statusit dhe sipërfaqes së Parqeve Kombëtare dhe Parqeve Natyrore/Rezervateve Natyrore të Menaxhuara ekzistues dhe njëkohësisht janë shpallur zona të reja, si pjesë e rrjetit kombëtar të Zonave të Mbrojtura. Bazuar në ligjin për zonat e mbrojtura, ky proces kryhet në bazë dhe për zbatim të nenit 35 dhe 36 të tij.

Sa më sipër, ndryshimet e propozuara kanë prekur edhe zona të mbrojtura, pjesë e të cilave janë edhe ekosistemet lagunore, si më poshtë:

- PK Butrint (i ndryshuar me VKM Nr. 59, datë 26.1.2022);
- PK Divjakë-Karavasta (i ndryshuar me VKM Nr. 59, datë 26.1.2022); si dhe
- RNM Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm (i ndryshuar me VKM Nr. 60, datë 26.1.2022).

Tabela me të dhënat mbi ndryshimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, paraqitet si më poshtë:

Zona e Mbrojtur	Ishte	U bë	Zgjerim	Zvogëlim
PK Butrint	9424.4 ha	8622.2 ha		802.2 ha
PK Divjakë- Karavasta	22230 ha	22389 ha	158.88 ha	
RNM Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm	90393.91 ha	8092.3 ha		1301.61 ha

Burim: Aktet Ligjore për Shpalljen e Zonave të Mbrojtura, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Miratimi i ndryshimit të sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore, zgjerimi ose pakësimi i saj bëhet duke argumentuar nevojën e ndryshimit konkret që do të përmirësojë rrjetin dhe mbrojtjen e zonës. Për rrjedhojë, rishikimi i sipërfaqes së një zone të caktuar duhet të kalojë përmes një procesi të standardizuar kërkimi shkencor, konsultimi të gjerë me palët e interesit dhe aprovimi ndërinstytucional. Procesi jo vetëm që duhet të jetë transparent por njëkohësisht duhet të evidentojë qartë metodologjinë e ndjekur.

Në Relacionet e përcjella grupit të auditimit, konstatohet se nuk janë elaboruar në mënyrë të qartë dhe shteruese se cilat janë arsyet që diktuan nevojën e ndërmarrjes së këtyre VKM-ve, specifikisht për secilën zonë dhe as metodologjia e përdorur për rishikimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura. Qëllimi i relacionit është të shpjegojë dispozitat e ligjore në gjuhë të thjeshtë, jo teknike, duke parashtruar ndryshimet e propozuara. Sa më e plotë dhe sa më e saktë të jetë përmbajta e relacionit aq më i kuptueshëm është ndryshimi legjislativ i propozuar. Për rrjedhojë, relacioni ka rëndësi specifike dhe duhet të shkruhet me kujdes për efekt të cilësisë dhe efektivitetit të legjislacionit, duke ndikuar kështu pozitivisht në zbatimin e aktit normativ në praktikë.

Relacioni i përcjellë nga MTM nuk trajton në mënyrë shteruese argumentet lidhur me nevojën për ndryshimin e statusit, vlerësimin e ndikimit në mjedis, përshkrimin e masave zbutëse si dhe nuk reflekton qartazi rezultatet e proceseve të bashkërendimit dhe këshillimit me grupet e interesit të shoqërisë civile. Ndryshimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura duhet të vijë i studjuar dhe mbi nevoja reale, me qëllim primar ruajtjen e ekosistemeve. Hapat e mësipër jo vetëm që janë detyrim ligjor, por njëkohësisht çdo ndryshim jo i mirë studiuar krijon risk në fragmentizimin e zonave, duke rrezikuar kështu funksionalitetin ekologjik të tyre.³³

“Policy and law enforcement remain generally weak despite numerous capacity building activities and technical assistance.” https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en, fq. 114;

³³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en, 114;

- **Mungesa e hartimit të akteve rregullatore, nga AKZM, me qëllim mirëadministrimin dhe ruajtjen e sitemit lagunor**

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) si institucioni qendror shtetëror përgjegjës për administrimin dhe kontrollin e zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ka disa kompetenca dhe përgjegjësi, të cilat lidhen me hartimin e akteve rregullatore, me qëllim mirëadministrimin dhe ruajtjen e sistemeve lagunore dhe përcaktohen në nenin 38 të ligjit për ZM. Referuar kësaj dispozite ligjore, disa nga detyrat e AKZM janë:

“e) krijimi dhe zbatimi i metodologjisë për hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura; g) miratimi i veprimtarive në zonat e mbrojtura, si pjesë e procesit të pajisjes me leje mjedisi për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis në zonat e mbrojtura”.

Sa më sipër, vetë AKZM në intervistën për konfirmimin e të dhënave zyrtare pohon se nuk ka hartuar dhe përcaktuar një metodologji lidhur me hartimin e planeve të menaxhimit. AKZM nuk ka përcaktuar veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis në zonat e mbrojtura dhe nuk ka identifikuar veprimtaritë e ndaluara që sjellin dëmtime apo shqetësime për llojet e kafshëve e të shpendëve të egra dhe të peshqve me banim të përhershëm, të përkohshëm dhe në rrugëkalimet e shpendëve shtegtarë e të emigrimit të peshqve.

Gjatë shqyrtimit të Raporteve Vjetore të AKZM-së, për vitet 2019-2021, grupi i auditimit ka konstatuar gjithashtu se trajtimi i menaxhimit të lagunave dhe ruajtjes së biodiversitetit në to paraqitet mjaft sipërfaqësor. Raporti Vjetor Institucional përmban një analizë të veprimtarisë së vetë institucionit përgjatë vitit, duke evidentuar punën dhe arritjet e tij në përmbushje të misionit institucional.

AKZM nuk ka kryer analiza lidhur me evidentimin e problematikave kryesore të hasura, në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit, pavarësisht faktit se, referuar natura 2000 lagunat bregdetare janë habiate prioritare për monitorim. Raportet Vjetore 2019-2021 shpesh herë përmbajnë fjali *copy-paste* dhe të dhëna të përgjithshme e evazive, dhe konkretisht: *“Gjendja në përgjithësi e biodiversitetit në ZM, monumenteve të natyrës, dhe specieve të florës dhe faunës është e mirë ku ndryshimi është nga viti në vit dhe po ecet drejt një menaxhimi të qëndrueshëm bashkohor me standarte eropiane të të gjitha zonave të mbrojtura”.*

Në Raportin e vitit 2021 disa të dhëna i referohen vitit 2018³⁴, duke vërtetuar kështu qartë se AKZM ka hartuar raporte “formale” nga viti në vit dhe nuk i ka kushtuar rëndësi identifikimit të problematikave me qëllim zgjidhjen e tyre në vitet pasardhëse. Konkluzionet e lëna në fund të çdo Raporti nuk janë efektive dhe përsëriten *copy-paste* nga viti në vit. Në raportet e vitit pasardhës, AKZM jo vetëm që nuk trajton realizimin dhe ecurinë e veprimtarisë institucionale në kuadër të përmbushjes së këtyre objektivave (konkluzioneve), por nëse do të krahasojmë konkluzionet e AKZM në raportet vjetore për tre vitet e fundit konstatojmë se këto janë identike dhe përsëriten nga viti në vit. Çdo vit, për periudhën objekt auditimi (2019-2021), në Raportet Vjetore të saj AKZM vendos objektiva me qëllim realizimin e tyre në vitin pasardhës, që lidhen me:

- identifikimin e të gjitha veprimtarive private brenda zonave të mbrojtura dhe bllokimin e veprimtarive që bie ndesh me ligjin e zonave të mbrojtura.
- inventarizimin dhe identifikimin e aktiviteteve të ligjshme dhe të paligjshme në territoret e zonave të mbrojtura, problemeve madhore që lidhen me mirëfunksionimin e çdo zone dhe raportet me aktorët e tjera në zone (peshkatore, restorante, shërbime, organe vendore, etj.).

³⁴ “Gjatë vitit 2018 mori jetë projekti “Smile Albania”. 1000 të rinj u përfshinë në promovimin e turizmit duke ndihmuar në organizimin e mikpritjes, dhënë informacionet e nevojshme tek turistët, zbuluar trashëgiminë”, fq. 3;

Megjithatë, pavarësisht këtij fakti AKZM nuk ka luajtur një rol proaktiv në përmbushje të këtyre objektivave, duke treguar mungesë efektiviteti në përmbushjen e detyrave funksionale të saj, në kuadër të ruajtjes dhe administrimit të sistemeve lagunore.

- **Mungesa e hartimit të një Strategjie aktuale Kombëtare të Peshkimit dhe mungesa e hartimit të akteve të tjera rregullatore, nga MBZHR, me qëllim sigurimin e një aktiviteti të kontrolluar dhe të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore të peshkimit në laguna**

Nga ana tjetër, peshkimi është një sektor i rëndësishëm për ekonominë dhe në të njëjtën kohë për biodiversitetin. Peshkimi i paligjshëm dhe mbishfrytëzimi i burimeve të peshkimit janë çështje prioritare në ruajtjen dhe menaxhimin e lagunave. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, në përputhje me Kushtetutën dhe legjilacionin në fuqi, ka për qëllim implementimin e politikave shtetërore për çështje të peshkimit dhe akuakulturës.

Gjatë fazës së auditimit në terren, MBZHR nuk kishte ende një Strategji Kombëtare të Peshkimit. Strategjia e fundit e ishte ajo për vitet 2016-2021, e cila aktualisht nuk kishte më efekt juridik prej një viti. Tashmë prej muajit Qershor 2022 MBZHR ka miratuar strategjinë e re për vitet 2021-2027 e cila, e plotëson këtë boshllëk e megjithatë vendosja e objektivave në të për një periudhë të kaluar është jokohërente.

Në referencë të objektivave të Strategjisë 2016-2021, MBZHR nuk ka hartuar një program kërkimor periodik, i cili identifikon dhe adreson boshllëqet për një menaxhim të qëndrueshëm të lagunave në aspektin e peshkimit.³⁵

Nëse i referohemi të dhënave të bëra publike nga INSTAT, bazuar në raportimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dëshmojnë se, ndërsa sasia e peshkut të kapur në Shqipëri është rritur nga 12.534 ton në vitin 2016 në 16,892 ton në vitin 2020, në laguna kjo sasi ka rënë me 6 herë. Kjo rënie ka vijuar për disa vite radhazi, duke u bërë më e evidente në vitin 2019, kur sasia e kapur ra në 94 ton nga 350 ton që kishte qenë një vit më parë. Pavarësisht këtij fakti, MBZHR ka nënshkruar 32 kontrata për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit me subjektet private (1 në Vilun; 2 në Vain; 5 në Kune; 6 në Karavasta; 2 në Patok; 3 në Nart; 1 në Orikum; 12 në Butrint) dhe 2 kontrata të nënshkruara përkatësisht, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Divjakë dhe OMP Nartë.

Pavarësisht rëndësisë që paraqesin lagunat si ekosisteme të brishta dhe nevojës për garantimin e një peshkimi të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore, me qëllim minimizimin e ndikimit negativ të aktivitetit të peshkimit në ekosistem, MBZHR nuk ka kryer asnjë studim nëse vijimi i kontraktimit të këtyre zonave mund të sjellë degradim të mjedisit lagunor.

Procesi i licensimit dhe kontraktimi i aktivitetit të peshkimit nga MBZHR bazohet në nenin 30 pika 7 të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar dhe VKM nr. 712, datë 31.7.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në pikën 18, të VKM-së nr. 712, datë 31.7.2013, afati i kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në ujërat e brendshme është jo më shumë se 10(dhjetë) vjet. Nga një interpretim literal i këtij përcaktimi, konstatohet se ky afat 10 vjeçar i përcaktuar është një afat tavan, i cili rast pas rasti mund të ndryshojë por nuk mundet asnjëherë të tejkalohet.

MBZHR, nuk ka hartuar asnjë metodologji për përcaktimin e afatit kontraktor në veprimtarinë e peshkimit. Nga shqyrtimi i kontratave të nënshkruara konstatohet se ky afat në çdo rast është 10 vjet,

³⁵ https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/STRATEGJIA_KOMBETARE_E_PESHKIMIT.pdf, fq. 20;

pavarësisht faktit se lagunat janë ekosisteme të brishta e të kërcënuara, ku prioritetet në administrimin e tyre duhet të jetë ruajtja e biodiversitetit në raport me ushtrimin e aktiviteteve tregtare.

Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të lagunave përmes zbatimit të udhëzimeve brenda kontekstit të qasjeve të ekosistemit, proceset e planifikimit për promovimin e ofrimit të përfitimeve dhe shërbimeve të ekosistemit lagunor duhet të formulohen dhe zbatohen në kontekstin e mirëmbajtjes ose rritjes, sipas rastit, të karakterit lagunor ekologjik në shkallë të përshtatshme hapësinore dhe kohore.

Në përfundim, aktivitetet e peshkimit në laguna jo vetëm që duhet të kryhen në përputhje me ligjin për zonat e mbrojtura, por njëkohësisht duhet të mbahen në konsideratë edhe udhëzime të ndryshme ndërkombëtare të detajuara mbi çështje të ndryshme të përdorimit të lagunave³⁶.

Gjetje:

1. MTM nuk ka një Strategji e cila përcakton objektivat kryesore për ruajtjen e biodiversitetit dhe as plane veprimi. Strategjia e fundit, e hartuar nga MTM ishte ajo për vitet 2016-2021, e cila aktualisht nuk ka më efekt juridik prej një viti.
2. Identifikimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura bëhet në përputhje me planin specifik të zonave të mbrojtura dhe planin e administrimit të rrjetit ekologjik të vendit. MTM nuk ka hartuar një Plan për Administrimin e Rrjetit Ekologjik.
3. Në Rregulloren e Brendshme të MTM-së nuk përcaktohen përshkrimet e vendit të punës dhe objektivat për secilin pozicion pune, në përputhje me strukturën organizative institucionale.
4. Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” nuk është hartuar konform parimeve të teknikës legislative.

4.1 Terminologjia e përdorur në ligj dhe aktet nënligjore nuk është e unifikuar. Nga shqyrtimi i akteve ligjore, grupi i auditimi konstaton se lagunave iu referohen me termin: “laguna”, “liqen”, “godullë”, “kërnice”, “merxhan”, “kënetë”, etj.. Në ligjin për zonat e mbrojtura mungon një përkufizim i qartë i termit lagunë.

4.2 Në pikën 1 të nenit 3 Përkufizime, përcaktohet se: “*Administrata e zonës së mbrojtur (AZM)*” është organi vendor përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e një zone të mbrojtur”, ndërkohë që referuar organigramës dhe strukturës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të mbrojtura, kjo agjenci është e përbërë nga institucioni i saj qëndror (AKZM) dhe nga administratat rajonale të saj (AdZM). Për rredhje ky organ (AZM) nuk ekziston dhe ky përcaktim ligjor nuk gjen zbatim praktik.

4.3 Përkufizimet lidhur me shkallët e mbrojtjes, të përcaktuara respektivisht në nenin 3 pika 35, 36 dhe 37 janë të paqarta. Përveçse në përkufizim, në përmbajtje të dispozitave vijuese të ligjit, nuk ka asnjë përcaktim lidhur me shkallët e mbrojtjes. Mungesa e trajtimit të shkallëve të mbrojtjes në një dispozitë të posaçme dhe inkorporimi i tyre tek përkufizimet, zbeh rëndësinë e shkallëve të mbrojtjes.

4.4 Përcaktimi i nenit 8 pika 1 “*Forma e administrimit/menaxhimit mbi zonat e mbrojtura mjedisore...*” krijon paqartësi në implementimin e tij, duke kërkuar një interpretim se çfarë nënkupton në këtë rast lidhëza “mbi”. Nga një interpretim i zgjeruar i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, grupi i auditimit konstatoi se me lidhëzën “mbi” do të kuptojmë administrimin e veprimtarive dhe të pasurive (private apo shtetërore) që ndodhen mbi këto zona të mbrojtura. Megjithatë, kjo dispozitë duhet të jetë e formuluar qartë dhe të mos lindë nevoja e interpretimit as gjatë leximit të saj dhe as në implementim, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të zonave të mbrojtura, që është edhe objektivi kryesor i këtij ligji.

³⁶<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf>, fq 72;

4.5 Në kategorinë e III-të “Monument Natyror”, veprimtaritë që mund të zhvillohen janë më të kufizuara se ato të Kategorisë së II-të “Park Kombëtar”. Për rrjedhojë, “Monumentet Natyrore” duhet të qendrojnë të dytat në kategorizim, pasi kanë të njëjtën shkallë mbrojtje me “Rezervat strikte natyrore (kategoria I)”.

4.6 Neni 33 i ligjit për zonat e mbrojtura është i përgjithshëm dhe evaziv. Kjo dispozitë krijon mbivendosje me dispozitat paraardhëse të ligjit, përkatësisht Seksioni IV “Kategoritë e Zonave të Mbrojtura”. Gjithashtu, kufizimet për kategoritë e zonave të mbrojtura përcaktohen më vete, në dispozita të posaçme për secilën kategori përkatëse (nga I-VI), për rrjedhojë edhe veprimtaritë që do të ushtrohen në secilën prej këtyre zonave duhet të trajtohen respektivisht në nenet përkatëse të Seksionit IV “Kategoritë e Zonave të Mbrojtura”. Më pas, duke marrë në konsideratë kufizimet e paracaktuara dhe veprimtaritë e lejuara, duhet të hartohen “Planet e Menaxhimit” për secilën zonë.

4.7 Pas ristrukturimit të ISHMP-së dhe kalimit të kompetencave të saj pranë IKMT-së, është Sektori i Policisë Pyjore në IKMT, që kryen funksionet inspektuese të zonave të mbrojtura. Ky ndryshim i ndodhur nuk është reflektuar në ligjin për zonat e mbrojtura dhe aktualisht IKMT nuk përmendet në asnjë dispozitë të ligjit si organ kompetent për kryerjen e inspektimeve. Ky boshllëk ligjor rrezikon implementimin efektiv të këtij përcaktimi gjatë kryerjes së inspektimeve në terren.

4.8 Neni 66 i ligjit për zonat e mbrojtura, i cili parashikon inspektimin në këto zona, nuk përcakton procesin e nisjes dhe vijimit të procedurave të inspektimit nga AdZM-të rajonale.

5. Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” dhe Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, kanë mospërputhje në përcaktimet që vendosin. Lejet e peshkimit jepen vetëm nga Ministria e Bujqësisë dhe AKZM nuk përfshihet në këtë proces.
6. Ligji nr. 61/2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” ka përfunduar efektet e tij dhe MTM dhe AKZM nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë për të përcaktuar një plan apo procedurë të qartë sesi do të vijohet.
7. AKZM nuk ka hartuar dhe përcaktuar një metodologji lidhur me hartimin e planeve të menaxhimit, si dokumenti bazë për ruajtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura.
8. AKZM nuk ka përcaktuar veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis në zonat e mbrojtura dhe nuk ka identifikuar veprimtaritë e ndaluara që sjellin dëmtime apo shqetësime për llojet e kafshëve e të shpendëve të egra dhe të peshqve me banim të përhershëm, të përkohshëm dhe në rrugëkalimet e shpendëve shtegtarë e të emigrimit të peshqve.
9. VKM nr. 128, datë 13.02.2020 nuk parashikon asnjë përcaktim për dëmet e shkaktuara në laguna, si dhe nuk ka një procedurë të saktë për mënyrën se si AdZM duhet të vlerësojë dhe ndjekë procesin e vlerësimit të dëmit dhe kostot për riparimin e tij.
10. Legjislacioni për investimet strategjike nuk garanton mbrojtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e ekosistemeve lagunore në vend, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
11. Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” dhe Ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” nuk përcaktojnë mënyrën e menaxhimit të zonave në administrim të përbashkët.
12. Peshkimi i paligjshëm dhe mbishfrytëzimi i burimeve të peshkimit janë çështje prioritare në ruajtjen dhe menaxhimin e lagunave. Së fundi, në Qershor 2022 është miratuar Strategjia Kombëtare e Peshkimit për vitet 2021-2027 e cila trajton objektiva edhe për vitin 2021 i cili tashmë është mbyllur.
13. MBZHR nuk ka hartuar një program kërkimor periodik, i cili identifikon dhe adreson boshllëqet për një menaxhim të qëndrueshëm të lagunave në aspektin e peshkimit.³⁷
14. MBZHR, nuk ka hartuar asnjë metodologji për përcaktimin e afatit kontraktor në veprimtarinë e peshkimit në ekosistemet lagunore.

³⁷ https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/STRATEGJIA_KOMBETARE_E_PESHKIMIT.pdf, fq. 20;

Konkluzione:

1. Mungesa e një Strategjie e cila përcakton objektivat për ruajtjen e biodiversitetit, dhe mungesa e hartimit të planeve të veprimit, tregon *de facto* mungesë fokusi nga ana e MTM-së në përcaktimin e objektivave strategjike, me qëllim ruajtjen dhe menaxhimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit në zonat e mbrojtura.
2. Mungesa e hartimit të një Plani për Administrimin e Rrjetit Ekologjik nga ana e MTM-së, tregon mungesë efektiviteti në realizimin e detyrave funksionale të saj në kuadër të administrimit të sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura.
3. Mungesa e përshkrimit të punës për secilin pozicion krijon konfuzion në detyrat që duhen të përmbushen dhe realizohen nga punonjësit dhe ndikon në mospërmbushjen e misionit institucional.
4. Hartimi i ligjit në mospërputhje me parimet e teknikës legislative, cënon zbatimin dhe efikasitetin e efektivitetin e implementimit të këtyre normave dhe i bën ato jo të lexueshme edhe për qytetarët si dhe të debatueshme për institucionet përgjegjëse për implementimin e tyre.
5. Disakordanca mes ligjit për zonat e mbrojtura dhe ligji për peshkimin, sjell mos implementimin e dispozitave ligjore në fuqi.
6. Mbarimi i efektit juridik të Ligjit nr. 61/2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjjetisë në Republikën e Shqipërisë” dhe mungesa e marrjes së masave nga ana e MTM-së për të përcaktuar një plan apo procedurë të qartë sesi do të vijohet, kërcënon ruajtjen efektive të zonave të mbrojtura dhe ndikon në pamundësinë e vendosjes së sanksioneve kundrejt individëve që shkelin ligjin.
7. Mungesa e hartimit dhe përcaktimit të një metodologjie lidhur me hartimin e planeve të menaxhimit, ndikon në mos unifikimin e praktikës në hartimin e këtyre planeve dhe uljen e efektivitetit në mirëadministrimin e zonave të mbrojtura.
8. Mungesa e përcaktimit të veprimtarive që kanë ndikim në mjedis në zonat e mbrojtura dhe identifikimit të veprimtarive të ndaluara që sjellin dëmtime apo shqetësime për llojet e kafshëve e të shpendëve të egra dhe të peshqve me banim të përhershëm, të përkohshëm dhe në rrugëkalimet e shpendëve shtegtarë e të emigrimit të peshqve, tregon mungesë efektiviteti dhe eficiencë të AKZM-së në ushtrimin e kompetencave institucionale, me qëllim ruajtjen e sistemeve lagunore.
9. Mungesa e një procedure të saktë për mënyrën se si AdZM-të duhet të vlerësojnë dhe ndjekin procesin e vlerësimit të dëmit dhe kostot për riparimin e dëmit, si dhe mos përcaktimi në VKM nr. 128, datë 13.02.2020 të dëmeve të shkaktuara në laguna, ndikon në efikasitetin institucionale të AdZM-ve për monitorimin efektiv të ekosistemeve lagunore.
10. Legjislati për investimet strategjike ngre shqetësim në mbrojtjen e biodiversitetit dhe konservimin e zonave të mbrojtura dhe rrezikon ruajtjen e qëndrueshme të ekosistemeve dhe degradimin e tyre. Ndërtimi i lidhur me zhvillimin e turizmit ka shkaktuar dëme të mëdha në ekosistemet e brishta bregdetare dhe detare në vend.
11. Mungesa e përcaktimit të mënyrës së hartimit të koordinuar të planeve të menaxhimit në ligjin për zonat e mbrojtura dhe ligjin për trashëgiminë kulturore si dhe mungesa e përcaktimit të mënyrës së menaxhimit të zonave nën juridiksionin e përbashkët të MTM dhe MK, vë në rrezik integritetin e këtyre pasurive në terma afatgjatë.
12. Mungesa e një Strategjie Kombëtare Peshkimi, tregon *de facto* mungesë eficiencë nga ana e MBZHR-së në realizimin e misionit institucional për menaxhim të qëndrueshëm të aktivitetit të peshkimit.
13. Mungesa e hartimit të një programi kërkimor periodik, i cili identifikon dhe adreson boshllëqet për një menaxhim të qëndrueshëm të lagunave në aspektin e peshkimit, tregon mungesë fokusi të MBZHR-së në menaxhimin e aktivitetit të peshkimit në këto zona.
14. Mungesa e përcaktimit të një metodologjie për përcaktimin e afatit kontraktor në veprimtarinë e peshkimit, tregon mungesë fokusi të MBZHR në menaxhimin e aktivitetit të peshkimit në ekosistemet lagunore.

Rekomandime:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim hartimin e një Strategjie të re, e cila përcakton objektiva konkretë për ruajtjen e biodiversitetit, në përputhje edhe me kërkesat e Strategjisë të Biodiversitetit të BE-së 2030.

Menjëherë

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë Planin e Administrimit të Rrjetit Ekologjik të vendit, referuar nenit 10 pika 1 të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, me qëllim identifikimin dhe administrimin sa më të plotë dhe të ekuilibruar të tyre.

Brenda muajit Mars 2023

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të ngrejë një grup pune, me qëllim përcaktimin e përshkrimit të vendeve të punës për secilin pozicion në përputhje me strukturën organizative të saj në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin.

Menjëherë

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të ngrenë një grup pune me qëllim rishikimin e ligjit për zonat e mbrojtura në përputhje me parimet e teknikës legislative, për një implementim efektiv të përcaktimeve ligjore duke bërë dhe propozimet përkatëse në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

4.1 Të unifikohet terminologjia e përdorur në ligjin për zonat e mbrojtura dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

4.2 Në ligjin për zonat e mbrojtura, nenin 3, të përcaktohet një përkufizim i qartë dhe i saktë i termit “lagunë” dhe “ligatinë”, si ekosisteme të cilat janë pjesë e zonave të mbrojtura.

4.3 Të rishikohen dhe riformulohen përkufizimet lidhur me shkallët e mbrojtjes, të trajtuara në nenin 3 pika 35, 36 dhe 37. Shkallët e mbrojtjes të përshkruhen në mënyrë më të qartë e koncize dhe të mos trajtohen tek përkufizimet ligjore por në një dispozitë të posaçme. Të unifikohet terminologjia e përdorur për shkallën e mbrojtjes për secilën kategori të zonave të mbrojtura.

4.4 Të shfuqizohet pika 1 e nenit 3, e cila përcakton se: “*Administrata e zonës së mbrojtur (AZM)*” është organi vendor përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e një zone të mbrojtur”, pasi referuar organigramës dhe strukturës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të mbrojtura, kjo agjenci është e përbërë nga institucioni i saj qëndror (AKZM) dhe nga administratat rajonale të saj (AdZM). Për rredhojë ky organ nuk ekziston dhe ky përcaktim ligjor nuk gjen zbatim praktik.

4.5 Në nenin 8 të ligjit për zonat e mbrojtura të përcaktohet saktësisht se çfarë do të kuptohet me lidhëzën “mbi”. Kjo dispozitë ligjore duhet të jetë e formuluar qartë dhe të mos lind nevoja e interpretimit as gjatë leximit të saj dhe as në implementim, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të zonave të mbrojtura, që është edhe objektivi kryesor i këtij ligji.

Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në zonat e mbrojtura dhe administrimi i këtyre pasurive, mund të trajtohen në një dispozitë të vetme me qëllim që konceptet të jenë të trajtuara në mënyrë logjike, të qartë dhe shterruese. Për këtë qëllim shërbejnë paragrafët në tekstet zyrtare, me qëllim mos “copëzimin” e çështjeve të trajtuara dhe rritjen artificiale të dispozitave që përmban ligji.

4.6 Të rishikohet neni 33 i ligjit për zonat e mbrojtura. Veprimtaritë e lejuara për secilën kategori të përcaktohen në kategorinë përkatëse për secilën zonë të mbrojtur, përkatësisht në Seksionin IV “Kategoritë e Zonave të Mbrojtura”, duke marrë në konsideratë edhe kufizimet respektive për secilën kategori.

4.7 Të amendohet neni 66 i ligjit për zonat e mbrojtura “Inspektimi”. Pika 1 e kësaj dispozite përcakton se: Inspektimi i zonës së mbrojtur realizohet nga: “a) Inspektorati i Policisë Pyjore, ky institucion”. Pas ristrukturimit të ISHMP-së dhe kalimit të kompetencave të saj pranë

IKMT-së është Sektori i Policisë Pyjore në IKMT që kryen funksionet e inspektimit. Për rrjedhojë, ky ndryshim organizativ të reflektohet edhe në dispozitën ligjore të sipërcituar.

4.8 Në nenin 66 të ligjit për zonat e mbrojtura, të përcaktohet procesi i nisjes dhe vijimit të procedurave të inspektimit nga AdZM-të rajonale.

Brenda muajit Mars 2023

5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masa për amendimin e ligjeve respektive, përkatësisht Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” dhe Ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, për aktivitetin e peshkimit të ushtruar në zonat e mbrojtura, duke amenduar në mënyrë adekuate dispozitat ligjore që bien ndesh me njëra tjetrën, me qëllim që çdo përcaktim ligjor i parashikuar të jetë i implementueshëm në praktikë.

Brenda muajit Mars 2023

6. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, pas përfundimit të efektit juridik të ligjit nr. 61/2016, kjo duke marrë në konsideratë faktin se gjuetia është e ndaluar në të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore,

Menjëherë

7. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të hartojë dhe miratojë një metodologji e cila përcakton mënyrën e hartimit të planeve të menaxhimit.

Menjëherë

8. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të hartojë dhe miratojë një rregullore e cila të pasqyrojë qartë, procedurat që duhet të ndiqen nga të interesuarit për aktivitetet që lejohen të zhvillohen në laguna të cilat kërkojnë autorizim nga administrata (psh. Rasti i peshkimit artizanale në zonë rekreative dhe në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (lundrimi, kundrimin të shpendëve, kërkimi shkencor etj), si dhe të veprimtaritë që kanë ndikim në mjediset e zonave të mbrojtura.

Brenda muajit Mars 2023

9. Në lidhje me procesin e vlerësimit të dëmit:

9.1 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura të propozojnë ndryshimet e nevojshme për amendimin e VKM nr. 128, datë 13.02.2020 “Për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyrën e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj”, duke përfshirë në Lidhjen nr.1 të saj me emërtim të qartë edhe vlerat që dëmtuesit duhet të paguajnë për dëmet e shkaktuara në laguna.

9.2 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si institucioni qendror shtetëror përgjegjës për administrimin dhe kontrollin e zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë të hartojë një procedurë të saktë për mënyrën se si AdZM-të duhet të vlerësojnë dhe ndjekin procesin e vlerësimit të dëmit dhe kostot për riparimin e tij, në përputhje me ligjin për zonat e mbrojtura dhe VKM nr. 128, datë 13.2.2020 “Për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyrën e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj”.

Brenda muajit Mars 2023

10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të propozoj amendim në Ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ku të përcaktohet një dispozitë e veçantë e cila të parashikojë që, ndërtimet pjesë e zhvillimit të zonave të mbrojtura të bëhen nëpërmjet një studimi paraprak të efekteve negative që implementimi i projektit sjell në biodiversitet dhe ekosistem,

duke prioritarizuar nevojën për konservimin e zonave të mbrojtura në raport me të ardhurat e përfituara. Ky rekomandim është në përputhje të plotë edhe me Konkluzionet e KE në Progres Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe Strategjinë e Biodiversitetit të BE-së 2030.

Brenda muajit Mars 2023

11. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa për të bashkëpunuar me Ministrinë e Kulturës për përcaktimin e mënyrës së menaxhimit në zonat në administrim të përbashkët, pjesë e juridiksionit të Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe Ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Të përcaktohet një dispozitë e përbashkët në ligjet respektive, në mënyrë që në planet e menaxhimit të pasurisë kulturore dhe në planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura komponentët mjedisorë dhe kulturorë të trajtohen me po të njëjtin prioritet.

Brenda muajit Mars 2023

12. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim monitorimin e Strategjisë së re, përsa i përket aktivitetit të peshkimit në zonat e mbrojtura lagunore.

Menjëherë

13. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të identifikojnë dhe adresojnë boshllëqet për një menaxhim të qëndrueshëm të lagunave në aspektin e peshkimit.

Në vijimësi

14. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim hartimin e një metodologjie për përcaktimin e afatit kontraktor në veprimtarinë e peshkimit dhe vlerësimin e ndikimit të pritshëm të këtyre kontratave në ekosistemin lagunor.

Brenda muajit Janar 2023

1.1.2 A është përmbushur objektivi i mbrojtjes së biodiversitetit në laguna ?

Lagunat janë pjesa më unike e ekosistemit ujor të Republikës së Shqipërisë. Ato shtrihen menjëherë pranë bregut të detit, dhe karakterizohen nga sipërfaqe të mbuluara me ujë të ëmbël, të mjelmë (pjesërisht të ëmbël me pak kripësi) dhe të kripur ku kripsmëria e ujit i përfarohet ujit të detit. Këto laguna shtrihen nga derdhja e lumit Buna, në veri, deri në Gadishullin e Karaburunit, përgjithësisht pranë dredhjeve të lumenjve, duke vijuar më tej por veçmas në jug me Lagunën e Butrintit, e cila në vetvete ka disa pjesë lagunore të veçuara, që formojnë kompleksin lagunor. Nuk kemi një sipërfaqe të saktë të evidentuar mbi këto laguna, por nëse i referohemi të dhënave të MBZHR kemi jo më pak se 100 Km² sipërfaqe lagunore.

Terminologjia e Lagunave nga institucionet nën auditim shpesh herë nënkuptohet me termin Ligatinë, që është një term i huazuar nga anglishtja, Wet-Land, toka të lagura, pra ligatinë që është një term përgjithësues i lagunave.

Lagunat janë një amortizues i mirë i stuhive detare, duke përthithur brenda territorit të brendshëm nga vija detare, forcën e baticave dhe zbaticave pa përmbytje në zonat pranë tyre, njëkohësisht ato janë edhe një rezervuar i mirë gjatë përmbytjeve të lumenjve, duke zbutur efektin e përmbytjes në shkallë të gjerë të tokave bujqësore apo/dhe qendrave të banuara.

Gjatë viteve të socializmit, nën moton që të përfitohej sa më shumë sipërfaqe bujqësore të pambuluar nga uji, u krijuan argjinatura mbrojtëse mes lagunave dhe tokave bujqësore. Ekuilibrat në krijimin e këtyre argjinaturave, shpesh herë janë prishur në favor të rivendosjes së ekuilibrit natyror, ku sot kemi rikthim të ekosistemeve natyrore me mini-zona lagunore deri moçalore jashtë argjinaturave mbrojtëse, drejt tokës së punueshme bujqësore. Ky rast u evidentua pranë fshatit Nartë, Vlorë ku një

sipërfaqe afro 20 Ha, ndodhej jashtë hartografisë së lagunës së Nartës, por me karakteristika të njëjta ujore si laguna Limpuo që është monument natyre por me ujë të ëmbël. Ky fenomen po ashtu është evident pranë lagunës së Orikumit, ku tej barrierës mbrojtëse një sipërfaqe toke bujqësore mbi 40 Ha sot gjendet nën ujë dhe jo pjesë e hartografisë së lagunës.

Grupi i auditimit kishte interes të njihje nga afër në terren një kontur të plotë gjeografik të lagunave, ku ato shtriheshin dhe si ishin pozicionuar ato në korrelacion me zonat e mbrojtura, rrugët lidhëse me to, aksesit i publikut në laguna, dhe komunikimi me detin i tyre.

U evidentua se pjesa më e madhe e këtyre lagunave **kanë status mbrojtje mjedisor**, sipas ligjit nr. 81/2017, “*Për zonat e mbrojtura*”, përjashtuar një sipërfaqe lagunore në jug të lumit Seman, që nuk ka status mbrojtje, por administrohet nga njësia e pushtetit vendor Bashkia Fier, specifikisht laguna e Petritit, dhe një pjesë më e copëzuar mini-lagunash bashkëshoqëruese të saj por së bashku formojnë një kompleks perfekt të habitatit të shpendëve migrator.

Në fokus të punës audituese mbi lagunat grupi i auditimit mori në konsideratë të njihje me **këndvështrimet të ndryshme** që kishin mbi këto laguna subjektet nën auditim, të cilat më së shumti lidhen nga emërtesat, sipërfaqet e tyre, të drejtat dhe detyrimet mbi territorin lagunor, pozicionin e tyre brenda zonave të mbrojtura mjedisore.

Subjektet i referohen termit Liqen, Kërnice, Godulla, Laguna, Gjol, Hauz, Moçal, Kënetë, Lum i kripur, Lum i vjetër, Merxhan që gjenden në terminologjinë lokale, apo në term përmbledhës më të gjerë ligatina³⁸ që referuar enciklopedisë janë të gjitha ato toka të mbuluara nga uji për kohë të gjatë, apo të shkurtër deri në 6 metra, nga disa jave në disa muaj, kur rritet një bimësi anoksike (pa oksigjen) ku dominojnë si bimësia akuatike, por edhe pemë dhe shkurre që gjenden në toka të thata, duke u konsideruar si ekosistemi më i mirë dhe kompleks në planet.

Për këtë gjë këto lloj ekosistemesh, janë të mbrojtura ndërkombëtarisht ku RSH aderon në disa konventa, ku më përfaqësuese mbi tokat e lagura është marrëveshja RAMSAR, që ka emrin e qytetit në Iran, ku është dakordësuar mbrojtja globale mbi Ligatinat/Lagunat. Ajo është një marrëveshje ndërkombëtare për të mbrojtur në radhë të parë tokat e lagëta (ligatinat), e cila i detyron shtetet nënshkruese që të zgjedhin të paktën një zonë të lagët, si **të vlefshme për t’u mbrojtur e për t’u përfshirë në listën ndërkombëtare**. Mbrojtje të tjera të biodiversitetit ka edhe mbi speciet migratore konkretisht Konventa e Bernës, që njihet si “*Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitatet Natyrore Evropiane*” ku janë të evidentuara në të lista e kuqe e specieve në zhdukje të Florës dhe Faunës, rrjedhimisht edhe atyre që kanë si habitat lagunat.

Marrëveshja RAMSAR e zgjeron termin sipërfaqësor të lagunave në variabël si rezultat i kushteve klimaterike stinore dhe vjetore, duke mos i përcaktuar me konture fikse, por zonë e gjerë mbrojtje.

Në tërësinë e vet këto subjekte kishin edhe **qëndrime më të konsoliduara** që lidhen me ekosistemin e këtyre lagunave, speciet që e popullojnë atë, si ujore apo edhe shpendët, ku nuk veçohen as kafshët që rriten në/pranë/breg të lagunave, apo edhe zonat bashkëshoqëruese pyjore të lagunave. Bimësia lagunore ndahet në bimësi ujore dhe bimësi që i reziston të dy ambienteve ujor dhe tokësor. Në brigjet e lagunave rriten bimësi të ndryshme nga bimët barishtore, shkurre dhe pemët e larta.

Subjektet janë angazhuar në politikat e tyre në mbrojtjen e biodiversitetit, por më së shumti kjo e kushtëzuar nga angazhimet e marra ndërkombëtarisht, si në kuadër të proceseve integruese në BE, por edhe proceseve globale të biodiversitetit dhe marrëveshjeve si ajo e Bernës, Barcelonës apo RAMSAR, mbi natyrën, lagunat dhe kontrollin e ndotjeve në to.

Lagunat duke u furnizuar me ujë nga Lumenjtë, hidrovorët e kullimit të ujërave të tokave bujqësore, si edhe përrenjtë kodrinor që kanë prurje të ndryshueshme vjetore, rrjedhimisht në laguna rritet ndjeshëm baza ushqimore organike dhe granulat gjysmë të përpunuara derivate të dekompozimeve në natyrë që shërbejnë si rezervë e mirë për peshqit, ngjallat, dhe shpendët ujore për shkak të aluvioneve që këta furnizues me ujë të ëmbël sjellin në lagunë.

Mjedisi i lagunave është i ndryshëm në bazë të stadiit të nivelit të ujërave në të ku kemi batica detare apo zbatica, si edhe lidhur me nivelin e prurjeve të lumenjve, përrenjve dhe hidrovorëve dhe për këtë

³⁸ <https://en.wikipedia.org/wiki/Wetland>

qëllim nuk mund të flitet për një sipërfaqe konstante të ujit në lagunë, sepse ajo është variabël nga faktorët më sipër.

Për këtë qëllim së pari grupi i auditimit kërkoi që të njëjët me objektin fizik “Lagunë”, numrin e tyre, sipërfaqet e tyre, statusin e tyre të mbrojtjes, pozicionin ku ato janë të vendosura brenda zonës së mbrojtur si qendrore apo buferike etj. Nga tërësia e dokumentacionit provues, grupi i auditimit nuk arriti të gjej dot një përgjigje shteruese mbi këto kërkesa në të tre institucionet subjekt auditimi.

Ministria e linjës që është përgjegjëse për zonat e mbrojtura, MTM përmes agjencisë së zonave të mbrojtura AKZM referuar burimeve zyrtare të Agjencisë Telegrafike Shqiptare³⁹, është angazhuar në vitin 2019 për të krijuar të dhëna hartografike mbi zonat e mbrojtura lagunore/ligatinore përmes një pasaportë që do të ketë çdo zonë e mbrojtur, në të cilën do të evidentohen treguesit mjedisor, hartografik dhe specieve të zonës së mbrojtur.

Ky term pasaportë, është term përmbledhës i gjendjes identifikuese të territorit, sipërfaqes, llojit të mbrojtjes, specieve që jetojnë aty, në kuadrin e një “Skede informuese të Zonave të Mbrojtura”, që për marketing publik është pagëzuar si “**Pasaportë**” apo “**Kartë Identiteti**”.

Ky kriter i termit “Pasaportë” është respektuar në vijueshmëri nga Këshilli Kombëtar i Territorit, ku në dispozitat për zhvillimin e turizmit të një zone në studim kërkohet një “**Pasaportë përmbledhëse e zonës**”⁴⁰, siç tregohet në rastin e Studimit të Tale (*Plazhi pranë lagunës së Talës në Lezhë*), pranë sistemit lagunor Kune-Vain-Tale.

Në pyetësorin e drejtuar AKZM dhe MTM, rezulton se këto dy institucione nuk disponojnë një pasaportë të zonave të mbrojtura, por nga të dhënat e grupit të auditimit, të mbledhura më herët në fazën studimore, rezulton se gjatë periudhës audituese AKZM ka shpenzuar një vlera financiare mes projekteve për të krijuar pasaporta të zonës së mbrojtur mjedisore, ky konkretisht Laguna e Butrintit në cilësinë e zonës së mbrojtur mjedisore paraqitet me një pasaportë numër 1644331229200, datë 12.09.2019. Ky projekt sipas paraqitjes në prezantim sipas fotos më poshtë, quhet “*Vlerësimi i rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura*”.

Faqja zyrtare e AKZM referuar nëse ka apo jo një “Pasaportë të zonave të mbrojtura”, na tregon se ka një të tillë. Kjo i përket këtij model formulimi si në foto më poshtë:

Foto nr.1 Përmbajtja e Pasaportës së Zonës së Mbrojtur

RRJETI KOMBETAR I ZONAVE TË MBROJTURA KARTE IDENTITETI	 AKZM AGJENCIA KOMBETARE E ZONAVE TË MBROJTURA	NATIONAL NETWORK OF PROTECTED AREAS ID CARD								
AL032PNOBR										
Balloli Park Natyror										
1. Data plotësimit 12-Sep-19	2. Sipërfaqja (ha) 330	3. Administrata përgjegjëse ADZM Berat								
		4. Shpallur me Rreg.MB Nr.1. Date 27.07.1977 me sipërfaqe 330 ha.								
*Sipërfaqja është marrë nga harta zonave të mbrojtura dhe në disa raste nuk përputhet me sipërfaqen e shënuar në vendimin për shpalljen e zonës.										
VENDNDODHJA										
5. Qarku Berat	6. Koordinatat e qendrës 40° 33' 38.9" N 19° 59' 16.4" E	7. Sipërfaqja sipas bashkive <table><thead><tr><th>Qarku</th><th>Bashkia</th><th>Sipërfaqja</th><th>%</th></tr></thead><tbody><tr><td>Berat</td><td>POLIÇAN</td><td>330.00</td><td>100.0%</td></tr></tbody></table>	Qarku	Bashkia	Sipërfaqja	%	Berat	POLIÇAN	330.00	100.0%
Qarku	Bashkia	Sipërfaqja	%							
Berat	POLIÇAN	330.00	100.0%							
8. Rajoni Biogjeografik Mediterranean	100%									

Burimi AKZM, Faqe Web

³⁹ <https://ata.gov.al/2019/10/05/pasaporta-per-zonat-e-mbrojtura-klosi-zhvillim-i-qendrueshem-dhe-per-brezat-qe-vijne/>

⁴⁰

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6354&token=e011b688e4a4ffdc6bee719dd420e0fe0965d309>

Nga verifikimi i këtij botimi të AKZM rezulton se autor i këtij studimi është një shoqatë mjedisore e identifikuar si “Sh... K....e P..... të Shqipërisë⁴¹” e cila publikon një bazë të dhënash në **384 Zona** të mbrojtura, **11 parqe** kombëtare, **300 monumente** natyre, **26 zona të menaxhuara në gjithë vendin**. Kjo gjë vërtetohet nga Agjencia Telegrafike Shqiptare datë 08.11.2019⁴² ku njofton prezantimet e këtij projekti të hedhur në zbatim dhe të prezantuar para disa AdZM-ve. Ky është një fakt se botimi i shfaqur në AKZM me datë 12.09.2019, pasi është administruar po ju prezantohet AdZM-ve për njohje me këtë botim dhe databazën e të dhënave.

Konkretisht, ATSH relatonte se “Gjithashtu do të krijohet një databazë funksionale e aksesueshme nga të gjithë, e cila përfshin saktësimin e hartave të tyre.”

Këto të dhëna që duhej të ishin administruar nga AKZM, në mënyrë specifike duhej të pasqyronin të dhëna zyrtare mbi lagunat dhe brigjet e tyre si pjesë komplanare e sipërfaqes së lagunës, ku do të mundësonte më tej që grupi i auditimit të thellohej kjo pikë auditimi mbi ekosistemin lagunor politikat për administrimin e tyre, por në kushtet e mospasjes së një sipërfaqeje të qartë mbi të cilën adoptohen politikat mbi administrimin e lagunave.

Mungesa e paraqitjes së këtyre pasaportave apo kartave të identitetit të zonave të mbrojtura, apo dokumente përmbledhës mbi hartografinë dhe speciet që identifikohen në lagunë, u provua mes përgjigjes së pyetësorëve për konfirmimin e të dhënave zyrtare, ku prej AKZM pranohet se **ata nuk posedojnë këto pasaporta**. Veprime këto që bien ndesh me transparencën institucionale.

Pjesa më sensitive e çdo lagune bazuar në ligjin 81/2017, janë monumentet e natyrës, mbi të cilat aplikohet shkalla më e lartë e mbrojtjes mjedisore, si “Rezervë Strikte⁴³” **që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore të pa shqetësuar**.

Në fazën e terrenit në zonën e mbrojtur mjedisore Patok, sistemi lagunor Kune-Vain-Patok, u evidentua se në këtë zonë vihet re një intensitet i lartë ndërtimi. Në këtë lagunë gjendet edhe një monument natyre i quajtur **Kordoni Litoral**, një zonë ranore në kanalin hyrës të lagunës së Patokut, në të cilën nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi.

Foto nr.2 Pamje nga Laguna e Patokut dhe Kordoni Litoral



Burimi: Google Map


⁴¹ <https://shkpsh.org/projekte/105-studimi-i-zonave-te-mbrojtura-ne-shqiperi>

⁴² <https://ata.gov.al/2019/11/08/akzm-dhe-shoqata-kombetare-e-parqeve-studim-mbi-sistemin-e-zonave-te-mbrojtura-ne-shqiperi/>

⁴³ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 3, pika 35

Në fakt, u evidentua që aty ndodhej një objekt i ndërtuar një katesh, me një largësi afro 300-400 m nga rruga automobilistike, dhe i pajisur me ndriçim elektrik, të furnizuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Sipas pamjeve të marra nga www.ASIG.gov.al rezulton një pronë si vijon më poshtë:

Foto nr.3 Pamje nga ndërtimet në Lagunën e Patokut



Burimi: Asig.gov.al

Aktivitetet tregtare apo të peshkimit janë të ndaluar në zonat qendrore dhe monument natyre, që ruajnë statusin më të lartë të mbrojtjes nga auditimi u evidentuan në mjaft raste se disa laguna me status mbrojtje të lartë si monument natyre, janë të përfshira aktivitete peshkimi ku përmendet në Parkun Natyror të Karavastasë, Laguna e Kashtës një lagunë me afro 50cm thellësi uji, e cila është formuar në afro 20 vitet e fundit, laguna Limpuo në sistemin Lagunor të Nartës, kanali i Vivarit në Lagunën e Butrinti, laguna e Rrëzës (Bufit) po në sistemin lagunor të Butrintit.

Aktivitet më të zakonshme në laguna janë peshkimi, dhe akuakulture që sigurojnë ekonomitë e komuniteteve lokale me të ardhura, kryesisht mes aktiviteteve artizanale të peshkimit, me kosha, grepa, rrjeta dhe një lloj kurthi me trarë dhe rrjeta, apo edhe thupra apo kallama që shërbejnë si barriera që nuk lejojnë kalimin e produkteve ujorë peshqve dhe ngjalave të dalin në ambientin e hapur detar.

MBZHR është kujdesur që ky lloj aktiviteti të marrë një **formë licencimi** për të përfituar të ardhura nga ushtruesit e këtij aktiviteti, duke aplikuar dy lloje licencimi për aktivitetet e peshkimit, si licencim individuale apo kolektiv mes Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP), që në vetvete nuk paraqesin ndonjë ndryshim të madh, pasi qëllimi si i peshkatarëve të pavarur dhe OMP-ve priret nga përfitimi më i madh i punës së tyre kapjes së peshkut, jo nga studimi i ligjësisë dhe sjelljes së faunës në lagunë, për të cilën ata nuk disponojnë resurse humane që ti studiojnë dhe analizojnë.

Kanalet hyrëse nga deti janë furnizuesit kryesor të ushqimit të lagunave me karkaleca dhe alga që përmbajnë beta-karotinën, sipas **enciklopedisë⁴⁴ Botannica**, (*You are what you eat*) tregon më së miri përse kolonitë e sapo ardhura në lagunat tona pas ndalimit të gjuetisë së shpendëve nuk kanë ngjyrën karakteristike rozë por pjesërisht nën krahët e tyre shfaqet kjo ngjyrë, ose afro % e një flamingo tipike të mirë ushqyer me alga dhe karkaleca deti, apo fosilet e karkalecave që gjenden në ujin e kripur të lagunave.

Kufizimet në këto kanale me ujë deti janë të tilla që duhet të kalojnë mes një sistemi kurthesh që pengojnë lëvizjen e lirë të specieve detare e lagunore si drejt detit apo drejt lagunës.

Relacionet e AdZM dhe AKZM mbi disa specie si Foka e Mesdheut, e cila më herët është evidentuar si prezente në lagunën e Butrintit, sot nuk arrin dot të hyjë në lagunë për shkak të pengesave me

⁴⁴ <https://www.britannica.com/story/why-are-flamingos-pink>

Dajlan, që nuk lejojnë këtë madhësi specie të hyjë dhe dal lirshëm, dhe që është një specie e listës së kuqe të konventës së Bernës.

Fenomeni i hyrjes në lagunë të breshkave të ujit raportohet në Kune-Vain por edhe gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit evidentoi një breshkë të pajetë në Kordonin Litoral të Lagunës së Karavastasë, tek Godulla e jashtme, por edhe nga aktet reale të shfaqura në Parqet e Nartës dhe Divjakës pasqyrohet në tabela, vend folenizimi i breshkave.

Nuk ka një përcaktim të qartë prej MBZHR, e cila administron ujin e këtyre lagunave sipas ligjit për peshkimin, sesi janë bërë vlerësimet për vendosjen e këtyre kurtheve të quajtura Dajlan nëse ato kanë ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm apo jo. Në pyetësor të tre subjektet u pyetën nëse ka një vend të BE, që mund ti referohemi si praktikë e mirë mbi peshkimin me dajlan, por kjo nuk mori përgjigje.

Ligji për peshkimin, ka adoptuar direktivat të BE, mbi peshimin për arsye se ujërat e brendshme ku përfshihen lagunat, në konceptin ligjor kanë ndryshim, por në konceptin e species peshk/ngjalë/karkaleca etj, nuk paraqesin asnjë ndarje pasi janë zona ujore ku speciet zhvillojnë jetesën e tyre janë një zonë ujore mesdhetare, dhe në direktivat e BE, ku bazohet ligji për peshkimin nuk ka një term Dajlan.

Foto nr.4 Pamje nga dajlanët e ngritur në Lagunën e Nartës



Burimi Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Në logjikën e MBZHR, konsiderohet se në një periudhë të caktuar të vitit këto kurthe hapen për 1 ose 2 muaj me qëllim hyrjen e peshqve që lëshojnë vezët në lagunë dhe që vijnë nga deti apo anasjelltas, ose siç njihen në Konventën për të drejtën e detit⁴⁵, mbi speciet *Anodromus* dhe *Katodromus* që ndalon kufizimin e lëvizjes së lirë të këtyre dy lloj specieve.

⁴⁵ Ligji nr. 9055/2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e detit” të OKB-së”, neni 66 dhe 67

Në shekullin e 19-të ky lloj peshkimi është ndaluar⁴⁶ në Amerikën e Veriut, dhe kjo konsiderohet si një praktikë e mirë, por nga ana tjetër Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Banorëve Indigjen i njeh këtë të atribut peshkimi vetëm atyre, si rast përjashtimor⁴⁷.

Referuar www.Accademia.edu⁴⁸ peshqit lëvizin nga laguna drejt detit për dy arsye, së pari për qëllime të shtrimit të vezëve, por edhe gjatë periudhës së dimrit, pasi peshqit nuk janë specie që kanë kontroll mbi temperaturën trupore, por e rregullojnë atë duke u afruar në ujëra të pranueshme për të jetuar për ta. Rrjedhimisht, gjatë migrimit dimëror, këta peshq që jetojnë në laguna nuk kryejnë dot ciklin e tyre jetësor të mbijetesës sepse bien në kurthet të cilët qëndrojnë të mbyllur. Për shkak të dimensioneve trupore disa specie nuk arrijnë dot as të futen në këto kurthe nga deti në lagunë. Një rast më tipik i dëmit që këto kurthe kanë kryer, është pamundësia e hyrjes së breshkës së detit, e cila është e vetmja që ushqehet me gaforren blu, një specie evazive e shfaqur në lagunat tona, dhe për të cilat nuk ka një strategji për minimizimin e tyre nga subjektet në auditim.

Me ardhjen e stinës më të ngrohtë pranverore, aluvionet e lumenjve, përrenjve dhe kanaleve kullues të depozituar në laguna fillojnë ciklet biologjike të shpërbërjes, dhe jeta e planktoneve nis të gjallërohet, duke emetuar aroma, të cilat ndjellin peshqit dhe ngjallat të futen në lagunë, për tu ushqyer, por përdorimi i një sistemi kurthesh dhe rrjetash gjatësore lë pak shanse që peshqit dhe ngjallat të dalin prej aty, në drejtimin e kundërt drejt detit.

Lagunat kthehen nga një ekosistem në një akuarium apo rezervat për mbajtjen aty të peshkut, i cili në rast nevojë për të dalë në det, mbetet në kurthet tradicionale si dajlan apo rrjeta gjatësore fundore. Informacionet e përcjella nga Inspektorati i peshkimit janë marrë me rezervë, pasi sasi të deklaruarat të peshkut të kapur në lagunë, mujore dhe të raportuara, nuk përkojnë me teknikën e gjuetisë.

Dajlani apo Starnik, janë metoda kapje që me futjen e peshkut apo ngjallës aty, nëse nuk bëhet kontrolli ditor i këtyre kurtheve, rrezikon që peshku apo ngjala të ngordh nga mosusqyerja, ndaj rezerva e marrjes së informacionit nga Inspektorët e Peshkimit, që janë në total 4 inspektorë nga Lumi Buna në Lagunën e Butrintit, dhe fizikisht monitorimi 24 orë në ditë, në 7 ditë të javës, kur kryhen aktivitete të peshkimit në lagunë, nuk monitorohet dot.

Nuk ka asnjë monitorim nga MBZHR, MTM dhe AKZM mbi rezervat peshkore në lagunë, çka nuk jep siguri të mjaftueshme se peshkimi në lagunë është në kushtet e zhvillimi të qëndrueshëm, duke evidentuar me metoda shkencore se në këto laguna mund të zhvillohet ende aktivitet peshkimi, të ndalet përkohësisht apo për një kohë të gjatë.

OMP dhe individët e licencuar, nga raportet e paraqitura nga subjektet nën auditim më të interesuara janë në formalizimin e tregut të peshkimit në lagunë, mes aksioneve në mbështetje të peshkimi të licencuar, sesa të vlerësojnë në nivel shkencor nëse të ardhurat nga peshkimi janë justifikuese mbi dëmet apo përfitimet në ekosistem.

Në lagunën e Nartës, Karavastasë dhe pjesërisht të Kune-Vain efektet pozitive të ndalimit të gjuetisë ishin evidente, pasi në këto zona lagunore kishte nisur prej disa viteve popullimi i tyre me kolonitë e flamingove një specie në zhdukje në botë.

Në gjithë fazën e terrenit, grupi i auditimit evidentoi se këta individë, kishin gjetur një habitat të mirë për të mos migruar, por për tu stacionuar gjithë vitin në këto laguna, ku edhe follenizojnë.

Gjatë periudhës së follenizimit, flamingot hasnin risqet e vetë ekosistemit, që vezët e tyre ishin preh e çakallit, ndaj konsiderohej se shkurret ishullore brenda lagunave ishin mbrojtja perfekte e tyre. Për këtë qëllim AdZM konsideronin se ishujt shkurrorë ishin asete të biodiversitetit brenda lagunës, për follenizimit e shpendëve.

⁴⁶ <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/20964129.2017.1341284>

⁴⁷ https://www.un.org/development/desa/indigenouspeoples/wp-content/uploads/sites/19/2018/11/UNDRIP_E_web.pdf

⁴⁸

[https://www.academia.edu/63552238/Observation of fish migration between the sea and a mediterranean lagoon Etang de IOr France using multibeam sonar and split beam echo sounder](https://www.academia.edu/63552238/Observation_of_fish_migration_between_the_sea_and_a_mediterranean_lagoon_Etang_de_IOr_France_using_multibeam_sonar_and_split_beam_echo_sounder)

Foto nr.5 Flamingo, shpendët folezues në lagunat e vendit




Burimi: Grupi i auditimit

Lagunat në formimin e vet gjeologjik janë trupa ujqor me furnizime nga burimet ujore si nga lumenjtë/përrenjtë/kanalet dhe nga deti ndaj si të tillë kanë nevojë të qarta që këto kanale komunikimi të jenë të hapura, gjatë gjithë vitit por nga verifikimi në terren rezultoi se gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit, subjektet tregtare janë të interesuar në mbajtjen brenda lagunës të stokut të peshkut, duke krijuar prita, mbyllur kanalet e komunikimi të jashtme me detin apo mes pjesëve të brendshme të komunikimit mes pjesëve të lagunave.

Ky fenomen është evidentuar në Divjakë, në kanalin verior që lidh Godullën e jashtme me detin, për të cilën AdZM Fier po punon intesivisht në një fazë studimore me një shoqatë Japoneze mjedisore, për gjetjen e zgjidhjeve permanente.

Foto nr. 6 Barriera penguese për qarkullimin e ujit në laguna



Burimi: Grupi i auditimit

-AdZM Fier në qendrën e pritjes së vizitorëve kishte ekspozuar të dhëna mbi një ndikim në mos qarkullimin e ujit të këtyre lagunave, dhe një hartë interaktive tregonte rritjen e salitetit, thënë ndryshe kripshmërisë së ujit të lagunave, e cila shfaqej e lartë pikërisht në pozicionin ku duhej të ishte një kanal komunikimi me detin, por që rezultonte i mbyllur.

Duhet theksuar se peshqit kanë nevojë për një ekosistem ujor, normal dhe kripshëm normal të ujit, kurse me rritjen e salitetit ujor, kemi migrimin e peshqve në zonat më të përshtatshme brenda lagunave, si rrjedhim kolonia e pelikanëve ndodhet të kushte mbijetese, në ishullin e pelikanit. Siç dihet një pelikan ka nevojë mesatarisht për një sasi rreth 1.5 kg peshk në ditë, dhe në sezonin veror, ushqimi i tyre goditet nga saliteti i lartë, në sezonin dimëror nga dajlanët në dalje të lagunës, mes tre kanaleve komunikues mes Lagunës së Divjakës dhe Godulla e Jashtme që shërben si furnizues i vetëm me ujë për Lagunën.

Nga përgjigjet e ardhura nga AdZM Lezhë u evidentua se në rrjetat statike të peshkatarëve të Kune-Vain-Talë ishin identifikuar 4 individë të breshkës së Detit “*Carretta Carretta*”, që tregon se çfarë pengesash sjellin në ekosistem këto metoda peshkimi, me pritë apo rrjeta lineare gjatë gjithë konturit lagunor.

Kujtojmë se, nga mos kujdesja e duhur është zhdukur nga liqeni i Shkodrës një specie peshku i quajtur “*Blini i Shkodrës*” (*Acipenser sturio*), ndaj sot kjo duhet të konsiderohet si **praktikë e keqe**, ndaj nevojitet zgjidhja në kohë e problemeve.

Grupi i auditimit kërkoi një panoramë sqaruese mbi hartografinë e lagunave në përdhën 2019-2021, mbi të cilën do të identifikoheshin problemet themelore që kishin të bënin me gjithë problemet më sipër trajtuar, që përfshijnë objektet ndihmëse si hyrjet, daljet nga laguna dhe për në lagunë, edhe për sipërfaqet lagunore më të vogla, që për shkak të mos komunikimit ato shumë herë në terminologjinë lokale njohën si liqene, ku përfshihet Kënalla në Lezhë, Petriti në Fier, Këneta e Osmanit Lushnje etj.

Pyetësorët për vjeljen e të dhënave zyrtare mbi mënyrën e zonimit të Zonave të Mbrojtura dhe nënzonimin, kanë një shmangie të marrjes së miratimeve përkatëse, nga Këshilli Kombëtar i Territorit, në përcaktimin e nën-zonimit, hapat procedural të ndryshimit të këtyre zonave dhe interesi më të lartë mbrojtja e lagunave. Është evidentuar se nuk janë zbatuar hapat procedural të matjeve në sistemin e përcaktuar me VKM, nënzonimin e brendshëm si edhe miratimin e tij në KKT, para hyrjes në fuqi të VKM-ve përkatëse të këtyre zonave të mbrojtura.

Në asnjë rast grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion një hartë elektronike e zonave lagunore të mbrojtura, e cila të pasqyronte drejt metodologjinë e matjeve. Harta e vetme e pasqyruar afër pritshmërive të detyrimeve ligjore dhe nënligjore ndodhet në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit⁴⁹ e cila përcakton kufijtë e zonave të mbrojtura, dhe kufijtë e monumenteve të natyrës në të⁵⁰, por që nuk pasqyron ku nis zona qendrore, rekreative apo buferike. Këto të dhëna të AKPT, i referohen vendimit të KKT nr. 10, datë 28.12.2020, vendime të cilat nuk pasqyrojnë nënzonimin dhe nuk reflektojnë reduktimin e sipërfaqes së rritjes së midhjes në lagunën e Butrintit që rezulton sipas MBZHR nuk është në zonën e mbrojtur mjedisore.

Lagunat si epiqendra e zonës së mbrojtur ligatinore, nuk është konsideruar si Zonë Qendrore në shumicën e rasteve, duke e konsideruar si zonë rekreative. Nëse ligatinat në konceptin botëror janë vetë qendra e ekosistemit më kompleks në planet, ndaj nuk perceptohet mbi cilët argumente në RSH, nuk ka një qasje të tillë, mbi lagunën. Më hollësisht në pyetësorët për konfirmimin e të dhënave zyrtare, në lidhje me midhjen e Butrintit, MBZHR deklaroi se nuk bën më pjesë në zonat e mbrojtura pjesa e lagunës ku ushtrohet aktiviteti i rritjes së midhjeve. Lidhur me këtë problematikë referuar hartografisë që AKZM pasqyron, si link për tu aksesuar nga grupi i auditimit, u pa që kjo logjikë e ndarjes në mes të lagunave është aplikuar edhe në Vendimin e KKT, nr. 10, datë 28.12.2020, ku në

⁴⁹ <https://drive.google.com/drive/folders/1V4iPUJ14nsguzeni1kUMmsep9mZozPfn>

⁵⁰ <https://akpt.maps.arcgis.com/apps/webappviewer/index.html?id=ff270e99f5be45f19c7b7a1e3e618b27>

lagunën e quajtur “Liqeni i Rrëzës”, po në këtë sistem lagunor të Butrintit, pjesa e ujit të kripur që buron nga mali afro 7 kilometra nga bregu i detit, monument natyre, derdh në lagunën e Rrëzës, ujin e vet të kripur, i cili përzihet edhe me ujërat e përrrenjve malor për të ëmbël për të krijuar një sistem unik, me ujë të mjelmët, ku rritet një specie e veçantë peshku, që nuk gjendet në asnjë lagunë tjetër të Shqipëri. Pikërisht ky sistem unik Monument Natyre, ka jashtë vetes së tij hartografike afro 16 Ha lagunë sipas matjeve që rezultojnë nga instrumentet e AKPT-së në Web.

Relacionet mbi VKM-të e vitit 2022 mbi disa laguna mes MTM dhe MBZHR, të paraqitur para grupit të auditimit, prireshin nga vlerësime të gjendjes së bizneseve në këto laguna dhe jo nga nevoja ekologjike për të caktuar stadin e mbrojtjes në to.

Procesi i pronësisë së lagunave dhe vaskave të rritjes së peshkut pranë tyre, apo stabilimente të akuakulturës sipas Ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e integruar të burimeve ujore” trajtohet⁵¹ se këto janë prona shtetërore të patjetërsueshme dhe të parashkrueshme. Gjatë fazës studimore në lagunën e Nartës, u identifikua një tabelë “Në shitje” të vaskave të rritjes së peshkut, pra me posedues privat, ndërkohë që lagunat duhet të jenë pasuri shtetërore.

Lagunat shërbejnë si stacione të ndalimit dhe pushimit të shpendëve dhe sipas të dhënave të censusit të shpendëve është evidentuar se një numër i madh shpendësh pushojnë gjatë rrugëtimit të tyre në Rrugën e Adriatikut të shtegtimin nga Afrika në Europën Skandinave, si një prej tre rrugëve kryesore të shtegtimin IBA, që është një klasifikim për zonat e rëndësishme për shpendët si habitat i shpendëve ujorë.

Duke qenë se në territorin e vendit kemi tre zona që kanë status të lartë të mbrojtjes së shpendëve migrues, me rëndësi ndërkombëtare RAMSAR, zonat lagunore e Butrintit, zona lagunore e Divjakë-Karavastasë, zona e mbrojtur e lumit Buna, ku përfshihet edhe laguna e Vilunit në Shkodër, në të cilat është evidentuar një reduktim i sipërfaqes së Parkut Kombëtar Butrint nga 9424,4 Ha në 8622,2 Ha, ose një reduktim prej 802.2 Ha, kurse Parku Kombëtar i Divjakë-Karavastasë është ndryshuar nga 22230.2 Ha në 22389.08 Ha, me një rritje prej 158.88 Ha, por gjatë kësaj rritje ka pasur një spostim të zonës së mbrojtur drejt detit duke përfshirë në të gjirin detar të plazhit të Divjakës që sipas www.asig.gov.al rezulton se shtesa prej 8.99 km² ose 899 Ha, shtuar në inventarin e mbrojtjes së Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, dhe që rrjedhimisht tregon se nga kjo zonë është reduktuar sipërfaqe rekreative e zonës së mbrojtur. Në total ndryshimet mes dy zonave nuk kanë arritur të sigurojnë mbajtjen e sipërfaqes totale të njëjtë sipas marrëveshjes RAMSAR, duke reduktuar me 643.32 Ha zonat RAMSAR të RSH.

Referuar kuadrit rregullator⁵², ka një ndarje të qartë mes ujërave të lagunave dhe ujit të detit thënë ndryshe ujërave territorial, ndaj ndryshimi nga pjesa lagunore në atë detare, që nuk i përket konventës RAMSAR, ka ndikim ndryshues edhe më të madhe se 643.32 Ha.

Ky lloj ndryshimi në sipërfaqen e zonave RAMSAR, nuk është konsideruar nga AKZM dhe MTM të kompensohet me një sipërfaqe të re për t’ju propozuar si alternativë sekretariatit të konventës, dhe nuk janë pritur aprovimet përkatëse nga ky sekretariat, para se pala shqiptare të marr vendimin final, dy vjet pas Vendimit të KKT, në vitin 2020, deri në miratimin me VKM në vitin 2022, kur gjatë kësaj periudhe konventa RAMSAR ka pasur dy mbledhje plenare.

Në jug të lumit Seman apo të zonës Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta, është propozuar prej AdZM Fier ti shtohet këtij parku një sipërfaqe prej afro 14 km² apo 1400 Ha, (matjet realizuar mes www.Asig.gov.al) por kjo nuk është miratuar. Gjatë vizitës në fazën e terrenit u evidentua e në këtë zonë gjendeshin një numër i konsiderueshëm fishekë gjuetie të konsumuar, çka tregonte qartë se aty

⁵¹ Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5, pika 2

⁵² Ligji Nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar, neni 4, pika 99; Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën”, i ndryshuar, neni 3, pika 3, germa c, dhe neni 3, pika 11; Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, neni 3, pika 8; Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 3, pika 28. Ligji Nr. 9055, datë 24.04.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e detit” të OKB-së”,

kryhej **aktivitet i lartë gjuetie të shpendëve ujore**, fare pranë kufirit të Parkut Kombëtar e cila përbën zonën buferike⁵³ të parkut kombëtar, në të cilën duhej të shërbente për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjikisht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të zonës së mbrojtur. Nuk ka asnjë të dhënë përse është parë e udhës që kjo sipërfaqe lagunore të mos merret në mbrojtje dhe nuk janë evidentuar raportet e njësisë Vendore Bashkia Fier, në përfitimet apo nevojat që kjo zonë të administrohet nga kjo njësi vendore.

Laguna në kuadër kuptimit mbi ekosistemin, duhet të sigurojë një habitat të pastër për speciet që rriten në të, si në ujë dhe shpendët që ushqehen në këto laguna. Ky monitorim mjedisor ujon duhet të kryhet përmes një sistemi të monitorimit të vazhduar lidhur me analizat e ujit të lagunës lidhur me prurje e burimeve të ëmbla të ujit.

Nga raportimet e AdZM Lezhë, por edhe të AKM në raportet e publikuara vjetore mjedisore rezulton se lumenjtë si pranë lagunës së Talës, por lumi Erzen që derdh ujin në afërsi të lagunës së Rrushkullit janë ndotës potencial të lagunave. Në parim raportimet e AdZM Lezhë dhe analizat e AKM mbi lumin Erzen, ku normat e amoniakut janë trefishi i normave të lejuara në grykëderdhje, tregojnë se rreziku i lagunave nga ndotja është permanent.

AKZM përmes AdZM-ve bën disa analiza instrumentale mbi pak komponentë siç janë oksigjeni në ujë, etj., por këto rezultate nuk koordinohen me AKM për analiza më të thelluara.

Analizat vjetore mjedisore në vetvete nuk zgjidhin problemet në çdo kohë të vitit, kur situata kritike mund të shfaqet. Në këto fenomene, parë nga këndvështrimi i ekosistemit, ku në qendër të së cilit është njeriu, MBZHR, ka tagrin ligjor që të provojë se produktet e peshkimit në laguna, si peshk, ngjalë, midhje etj, duhet të rriten në një mjedis të shëndetshëm, pa ndotje, pasi në zinxhirin ushqimor mes ushqimit potencial të ndotur dhe gjallesës ujore, përfituesi final është njeriu.

Instrumentet që ka MBZHR, nisin nga kontrolli me inspektorë për sasinë e produktit ujon të peshkuar, numrit të vogël të tyre, që të identifikojnë gjithë sasinë e peshkut të kapur, raportet mjedisore të lagunës që janë vjetore, identifikimi me analizë për çdo produkt nga AKU, kur vetë AKU është në pamundësi dijenie për produktin peshk apo ngjalë të kapur në lagunë dhe të trajtuar si peshkim artizanal, jo tregtar, nuk jep indikacione të plota se respektohet i plotë ekosistemi ushqimor i njeriut. Konkretisht, nëse lumi Erzen derdh në det 3-fish të lejuar të NH₃ në det, ku laguna e Rrushkullit dhe ky rezervat shtrihet në të dy anët e derdhjes së lumit Erzen çdo produkt i kapur do të jetë i kontaminuar. E njëjta gjë vlen edhe në lagunën Kune-Vain-Tale për të cilën AdZM Lezhë e ngre si problem shqetësues ndotjen që derdhet në lagunë nga hidrovorët dhe lumi Drin, lum në të cilin mediat raportojnë ngordhje masive të peshkut për shkak të shkarkimeve të landfillit të Bushatit, në lumin Drin i cili shkarkon në lagunën e Kunes ujin e vet pjesërisht.

Një fenomen tjetër në monitorimin e gjallesave që frekuentojnë këto laguna si shpendët dhe gjallesat ujore, nuk ka asnjë laborator në AKZM që ti monitorojë.

Grupi i auditimit të KLSH, identifikoi në Shëngjin një individ “*Rosë Matadorë*” e ngordhur, dhe ju kërkua informacion mbi shkaqet e ngrohjes, kohë gjatë së cilës “*Gripi i Shpendëve*” në liqenin e Prespës kishte identifikuar ngordhjen masive të Pelikanit Kaçurrel. Ky individ u raportua se u dërgua në AKU Lezhë por nuk ka detaje të mëtejshme lidhur me ekzaminimet e kryera. Në konkluzion u pa se njësitë e vartësisë së AKZM nuk disponojnë mjete dhe pajisje për analiza mbi ujin, florën dhe faunën, që të prodhojnë rezultate në kohë reale të sakta.

Në fazën e terrenit në Lagunën e Karavastasë u identifikua një vendgrumbullim i mbetjeve të Bashkisë Divjakë, pranë rrugës automobilistike, brenda parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

⁵³ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 3, pika 30

Foto nr.7 Pamje nga zona e Vendgrumbullimit të mbeturinave pranë Lagunës së Karavastasë



Burimi: Grupi i Auditimit, Foto nga Google

Ky vend grumbullim i mbetjeve rezulton se gjatë shirave zbret në lagunë përmes kanaleve që derdhen në lagunën e Karavastasë duke sjellë produkte të lëngshme apo detergjente që kanë mbeturinat urbane, apo bio-dekompozimet e tyre.

Vetëm 20 metra nga ky vendgrumbullim ndodhen pusët e ujit të pijshëm të Bashkisë Divjakë. Lidhur me këtë problematikë nuk pati dokumentacion mbështetës se MTM apo AKZM ka njoftuar Këshillin e Basenit ujqor për impaktin në mjedis të këtij vend depozitimi dhe pasojat në shëndetin e njeriut nëse ka prej filtrimeve të derivateve të lëngëta të mbeturinave urbane.

Në lagunat tona jetojnë lloje specimesh të ndryshme ujore, por më interesantja është **brekosa shqiptare “Pelophylax shqipericus”** e cila jeton kryesisht në pellgje me ujë të ëmbël, laguna me ujë të ëmbël, lumenj, dhe kanale furnizues të ujit të ëmbël që shkojnë në laguna, lumenj, dhe përrenj. Një pjesë të aktivitetit të saj jetësor kjo brekosa e ka pranë zonave të mbrojtura. Kjo specie është specie në zhdukje, endemike, që rritet nga Liqeni i Shkodrës, deri në Lagunën e Orikumit. Specie të tjera që janë të rrezikuara për zhdukje janë Ngjala Evropiane “*Anguilla Anguilla*” e cila është specie e mbrojtur në listën e kuqe të konventës së Bernës. Krahas tyre në lagunat tona rriten edhe **specie të tjera endemike** të florës si Orkidea Shqiptare, “*Orchis albanica*” apo Lule Ylli Shqiptar “*Aster albanicus*” që janë lule që kryesisht rriten në parkun kombëtar të Divjakë Karavastasë.

Në Parqet tona apo zonat e mbrojtura jetojnë dhe follenizojnë Flamingo dhe Pelikani Kaçurrel, që janë specie në zhdukje. Ndërtimi i një ekosistemi të ruajtur nga ndotja e njeriut, dhe siguri i një habitat të pa shqetësuar i shërben qëllimit të edhe brezat që vijnë të kenë mundësi të shohin nga afër këto bimë, shpend e amfib që janë endemike apo drejt zhdukjes. Konsiderohen se janë endemike dhe kërkojnë vëmendje të posaçme për shkak të natyrës së veçantë të habitatit të tyre dhe/ose ndikimit të mundshëm të shfrytëzimit në habitatin përkatës dhe/ose ndikimit të mundshëm të shfrytëzimit të tyre mbi statusin e ruajtjes.

Një problem shqetësues mbeten edhe speciet evazive si gaforrja blu, e cila ka prezencë në të gjithë Mesdheun, dhe në lagunat tona, ku në nivelin më të lartë ajo paraqitet në lagunën e Vilunit, që pretendohet të ketë një stok disa dhjetra ton. Një sasi e madhe e tillë që bën të pamundur zhvillimin e peshqve, pasi kjo specie është një notuese e mirë, dhe ushqehet me mish, përfshirë vezët e peshkut apo edhe vetë peshqit e kapur prej saj. Prania e saj nuk është zvogëluar pasi për të mungon tregu për shkak të çmimit të ulët në treg, si edhe mungesa e incentivëve të MTM apo MBZHR

Duhet theksuar se predatori më i mirë i gaforres blu është breshka e detit, e cila ushqehet me to, por kufizimet e hyrjeve dhe daljeve të breshkës së detit në laguna, ka ndikuar sadopak në shtimin e kësaj specie në cekëtina dhe laguna. Breshka e detit është një specie që folenizon në zonën ranore, kryesisht është evidentuar në lagunën e Nartës dhe Divjakës me nga 60-80 individë, të cilët kur dalin në det, në metrat e fundit të tyre, sipas konfirmimit të AdZM Fier, në GPS e tyre, në metrat e fundit ato memorizojnë vendin ku kanë lindur për tu rikthyer për folenizim.

Peshkimi aksidental në Kune-Vain, sipas AdZM Lezhë, i katër individëve, tregon se ka afinitet të lartë për folenizim të breshkës së detit në këtë lagunë, por kurthet me dajlan dhe rrjeta e pamundësojnë hyrjen në lagunë, kurse shtimi i gaforres blu në Tale-Vain është produkt i aktivitetit jo mjedisor njerëzor.

Investimet dhe ruajtja e zonave lagunore

Laguna e Nartës, është pjesë e zonës së mbrojtur me status “Peisazhi i Mbrojtur i sistemit ligatinor Vjosë-Nartë” dhe ndodhet në rajonin Rajonin e Vlorës. Sipas të dhënave të siguruar gjatë auditimit por dhe nga të dhënat e AdZM është është një nga 16 sitet në Shqipëri të regjistruara në databasën botërore si Zonë e Rëndësisë për Shpendët dhe Biodiversitetin (IBA-AL005). Ajo është klasifikuar si IBA, pasi plotëson kriteret si më poshtë:

A1: Është habitat i specieve të kërcënuara në nivel global;

A4: strehon dhe mbështet jetesën e më shumë se 1% të popullatave të shpendëve ujorë/tokësor, dimërorë dhe shtegëtarë në rang botëror;

B1: mbështet më shumë se 1% të rrugëtimit për llojet ujorë shtegëtarë (BirdLife, 2019).

Laguna e Nartës plotëson gjithashtu kriteret nr. 2,4,5,6 për tu kualifikuar edhe si zonë Ramsar (BirdLife, Important Bird Areas and potential Ramsar sites in Europe, 2001) dhe specifiku:

Kriteri nr.2: Laguna e Nartës mbështet lloje me status vulnerabël, të rrezikuar ose të kërcënuar;

Kriteri nr.4: Laguna e Nartës mbështet specie bimore /gjallesa në faza kritike të ciklit të tyre jetësor dhe ofron strehim në kushte të caktuara;

Kriteri nr. 5: Mbështet jetesën e mbi 20,000 shpendëve ujorë;

Kriteri nr.6: Në mënyrë konstante mbështet jetesën e 1% të individëve që i përkasin popullatës së një specie apo subspecie të shpendëve ujorë.


Sipas Portalit të Këshillit European, në përputhje me Konventën e Bernës (1976), Laguna e Nartës është nominuar zyrtarisht si “Sit Emerald kandidat ” për të qënë pjesë e rrjetit Emerald të zonave të veçanta me interes për ruajtjen e habitateve me emërtimin: Protected landscape of the ëetland complex Vjosë – Nartë/Peisazhi i Mbrojtur i sistemit ligatinor Vjosë-Nartë (AL0000008). Theksojmë se ky rrjet është një mundësi e përafritit të direktivës së habitateve dhe shpendëve, për ato vende të cilat nuk janë pjesë e BE, si rasti i Shqipërisë. Laguna e Nartës është pjesë e Ëetland International (AL00002) ku për shtatin vite radhazi është zhvilluar censusi i shpendëve ujorë shtegëtarë i cili ka qënë një instrument shumë i rëndësishëm në identifikimin dhe përmirësimin e njohurive mbi llojet në lagunë. Nga ky census, për vitin 2016 ka rezultuar se laguna e Nartës është e dyta pas lagunës së Karavastasë për nga numri i specieve të shpendëve ujorë të vëzhguar.

Në pjesë veriore të Lagunës së Nartës ndodhet Kriporja Vlorë, e cila ka një sipërfaqe prej rreth 1,500 Ha. Sipërfaqe ujore është transformuar në kriporë rreth viteve 1950 dhe përbëhet nga në brendësi nga vaska uji të cekëta të cilat janë vende interesante për shpendët e ujit. Pas viteve 1990 kriporja ka operuar si nërmarrje shtetërore dhe më pas në vitin 2009 ajo është dhënë me koncesion⁵⁴ subjekteve private, kontraktuar nga ish Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës me një afat 35 vjeçar.

⁵⁴ http://atrako.gov.al/?page_id=659&contract=1223

Gjatë fazës së auditimit në terren nga vëzhgimet e kryera gjatë muajit Maj 2022 u evidentuan probleme në këtë ekosistem, ndikuar kryesisht nga tërheqja e ujit të lagunës e cila vijonte nëpërmjet kanalit komunikues mes lagunës dhe kripores. Në terren u identifikua se ekziston një linjë e furnizimit me ujë direkt nga deti, me një kanal jo funksional prej afro 1.5 Km dhe një sistem pompash gjithashtu jo funksional.

Foto nr.8 Pamje treguese mbi largësinë e Kripores së Nartës, Vlorë nga deti



Burimi: Grupi i Auditimit, AKPT

Duke qenë se temperaturat ishin ende në vlera mesatare dhe tërheqja e ujit vijonte intensivisht, vihej re lehtësisht në pjesët anësore të lagunës që niveli i ujit ishte ulur, ndërsa kishte filluar dhe tharja e pjesshme e saj. Grupi i auditimit vëzhgoi dhe portat lidhëse të saj me detin nga të cilat kanali lidhës në bregun ranor të Pishë Poros ishte i hapur por nuk kishte prurje uji, ndërsa pika e lidhjes në afërsi të ishullit të Manastirit në Zvërnec, lejonte qarkullimin vetëm të një nga katër portat mekanike të ndërtuara, duke mos lejuar qarkullim të vazhdueshëm dhe të bollshëm me ujë deti. Me rritjen e mëtejshme të temperaturave përgjatë periudhës së verës, laguna kishte tendencë të shkonte drejt pikës kritike të saj çka do të krijonte efekte negative të pallogaritshme në biodiversitetin e këtij ekosistemi.

Foto nr. 9 Laguna e Nartës ndërkohë që vijonte tërheqja e ujit (Maj 2022)



Burimi: Grupi i Auditimit gjatë vëzhgimit në terren

-Po kështu, ndërtimi i Aeroportit Vlorës në kompleksin ligatinor Vjosë-Nartë është një nga investimet e kontestuara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare⁵⁵, kryesisht nga sekretariati i konventës së Bernës, pasi ky aeroport është në rrugën e shtegtimin **Adriatic Flyway** e mbrojtur nga konventa e Bernës, mbi shpendët migratorë IBA. Kufizimet për zonat IBA, sipas ligjit “Për zonat e mbrojtura” kërkojnë që në “zonën veçanërisht të mbrojtur mjedisore si habitat i shpendëve ujorë”: “përcaktohen si **veprimtari të ndaluara ato që sjellin dëmtime apo shqetësime për llojet e kafshëve e të shpendëve të egra dhe të peshqve me banim të përhershëm, të përkohshëm dhe në rrugëkalimet e shpendëve shtegtarë e të emigrimit të peshqve**”. Gjithashtu ky investim strategjik ndodhet edhe pranë kripores së Nartës, e cila prodhon sasi të mëdha kripe e cila përdoret edhe për konsum duke qenë produkt ushqimor mjaft i përdorshëm. Vaskat e tharjes së kripës ndodhen jo më shumë se 100 metra larg nga investimi në fjalë çka mund të ndikojë negativisht në cilësinë e këtij produkti ushqimor të rëndësishëm vendas. Në këto kushte veç ndikimit në mjedisin kripor, ndikimin në konventën e Bernës edhe prania e shpendëve të shumtë në këtë lagunë, përbën një rrezik për fluturimet ajrore si në rastin e New York, në të cilën një avioni pasagjerësh është rrëzuar pikërisht nga ky fenomen. Një pjesë e problematikave janë trajtuar edhe në Studimin e Fizibilitetit⁵⁶ të publikuar për këtë aeroport nga institucionet e vendit.

-Aktualisht në vend për shkak të kërkesave në vijueshmëri për të pasur akses për qëllime turistike në bregdetin e ultësirës perëndimore, shumë subjekte me fokus turizmin kanë shprehur dëshirën që të përfshihen në investime strategjike.

Këto projekte, kanë pasur edhe oponencë publike, dhe disa prej tyre kanë marrë edhe vëmendje mediatike të lartë siç janë projekti i B...-Rr... i cili në projektin e miratuar me Vendim të KKT nr.3, datë 23.10.2019, është parashikuar një ndërtim ure mbi lagunën e Vilunit, Vendimi i KKT nr. 9, datë 08.02.2017 mbi planin zhvillimor të zonës me interes strategjik Divjakë deri në Lumin Seman, që parashikon ndërtime të komplekseve turistike në Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë.

-Duke shtuar veprimtaritë zhvillimore të diksutueshme në Butrint të cilat janë denoncuar nga UNESCO në vitin 2013 për ndërtimin e një rruge nga Butrinti në Ksamil si dhe projektet e reja mbi Parkun Arkeologjik të Butrintit që parashikojnë një shfrytëzim me PPP ku planifikohet edhe akses i mjeteve lundruese në kanalin e Vivarit. Në tërësi vendimet e marra mbi zonat e mbrojtura mjedisore, dhe kufizimet që zonat mjedisore kanë mbi aktivitetet intensive, pamundësojnë dhënien e një opinioni pozitiv që këto projekte kanë me kuadrin rregullator kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjetje:

15. MBZHR, MTM dhe AKZM, nuk dispononin të dhëna të plota dhe të unifikuara mbi sipërfaqet⁵⁷ e lagunave, arsyetimin mbi zonimin⁵⁸ dhe nënzonimin e tyre si edhe nevojat e arsyetuara mjedisore mbi këto përcaktime.
16. AKZM nuk paraqiti të dhënat⁵⁹ për zonat e mbrojtura lagunore me kartelat përkatëse, “*Pasaportë e zonave të mbrojtura*” një dokument prej 213 faqesh, me të dhëna të plota mbi florën, faunën dhe hartografinë e zonës së mbrojtur lagunore me arsyetimin se këto nuk janë dokumenta të miratuara ende, ndërkohë që ka një studim mbi këtë çështje dhe të dhënat janë bërë publike.

⁵⁵ https://en.wikipedia.org/wiki/Vlor%C3%AB_International_Airport

⁵⁶ <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/AL-STUDIM-FIZIBILITETI-VIA.pdf>

⁵⁷ Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, neni 3, pika 8.

⁵⁸ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 47

⁵⁹ <http://akzm.gov.al/uploads/pasaporta-1643900948963.pdf>

17. AKZM nuk ka marrë masa për mbrojtje në Lagunën e Patokut, në monumentin e natyrës, kordoni Litoral, ishulli, mbi ndërtimin e një veprimtarie tregtare në zonë ku nuk lejohet asnjë ndërtim⁶⁰.
18. Institucionet përgjegjëse MBZHR, MTM dhe AKZM nuk kanë marrë masat e nevojshme për ndalimin e aktivitetit të peshkimit për qëllime tregtare në zona të mbrojtura Monument Natyre⁶¹, pasi legjislacioni për zonat e mbrojtura për kategorinë I, II dhe III, e ndalon këtë lloj veprimtarie.
19. MBZHR, MTM dhe AKZM kanë lejuar metoda të peshkimit me kurthe Dajlan apo rrjeta Starnik në gjithë gjerësinë e lagunës që pengojnë lëvizjen e lirë të peshqve dhe ngjallave nga deti drejt lagunës dhe/apo anasjelltas, duke mos respektuar përcaktimet e konventës së detit, përkatësisht nenet 66 dhe 67 të saj.
20. MBZHR, MTM dhe AKZM nuk kanë marrë masa për hapjen e kanaleve të komunikimit⁶² të lagunave me detin dhe mes pjesëve të lagunave, duke krijuar një rrezik të lartë mbi ekosistemin e specieve ujore në lagunë.
21. AKZM dhe MTM nuk kanë marrë në konsideratë⁶³ veçoritë e ekosistemit të lagunave në nënzominet e tyre në relacion me shkallën më të lartë të mundshme të mbrojtjes, ku nuk është treguar qartë zona qendrore dhe veçoritë e saj.
22. AKZM dhe MTM nuk kanë asnjë të dhënë hartografike të vërtetueshme mbi procesin e miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit, deri në shpalljen me Vendim të Këshillit të Ministrave⁶⁴ të zonave të Mbrojtura Mjedisore, përfshirë zonimin qendror, rekreativ dhe buferik të zonës. Të dhënat e publikuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimi të Territorit, nuk reflektojnë hartat e miratuara me VKM në vitin 2022 si dhe koordinatat bashkëlidhur në shtojcat e VKM-ve nuk tregojnë çfarë përfaqësojnë në kuadër të nënzonimit.
23. AKZM dhe MTM nuk kanë respektuar marrëveshjen RAMSAR⁶⁵, përkatësisht nenin 8 pika 2.d e saj, në të cilën përcaktohet detyrimi për njoftim pranë sekretariatit në rast të ndryshimeve të ndodhura mbi lagunat e vendit, pasi sipërfaqet e zonave të mbrojtura janë reduktuar me 634.32 Ha.
24. MTM nuk ka bashkërenduar me njësitë e pushtetit vendor Bashkia Fier, mbi detyrimet që rrjedhin nga ruajtja në zonën buferike lagunore të lagunës së Petritit dhe pjesës ligatinore pranë⁶⁶ saj.
25. MBZHR edhe MTM nuk kanë identifikuar qartë nëse është respektuar hallka qendrore e ekosistemit⁶⁷ të lagunave, njeriu, mbi sigurinë e ushqimit të specieve ujore lagunore dhe efektet tek njeriu në rastet e evidentuara të ndotjeve mjedisore.
26. AKZM dhe MTM nuk kanë bërë analiza fiziko-kimike periodike në laguna mbi ujin, florën e faunën, sipas detyrimeve⁶⁸ që rrjedhin nga legjislacioni për zonat e mbrojtura, por për çdo problematikë i referohet raporteve vjetore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pa konsideruar sensitivitetin kohor.

⁶⁰ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 15, pika 2, germa (c)

⁶¹ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 34, pika 1

⁶² Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 9, germa a

⁶³ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 2, germa a.

⁶⁴ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 13, pika 6.

⁶⁵ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 26.

⁶⁶ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 12, pika 2.

⁶⁷ Ligji nr. 64/2012, neni 4, pikat 15; 39; 42; 51; 60/b; 73, neni 6

⁶⁸ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 38, pika 5, germa dh..

27. MTM nuk rezulton të ketë adresuar problemin e ndotjes së vendgrumbullimit të mbetjeve, në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, Bashkia Divjakë drejt Agjencisë së Baseneve Ujore⁶⁹.
28. AKZM, MTM së bashku me MBZHR nuk kanë ndërtuar politika për mbajtjen nën kontroll të gaforres blu në lagunat e vendit lidhur me rehabilitimin e habitateve, largimin dhe menaxhimin e specieve invazive⁷⁰ të huaja.
29. AKZM, MTM së bashku me MBZHR nuk kanë adresuar problemin e marrjes së ujit nga laguna e Nartës prej koncesionarit⁷¹ që vepron në këtë zonë të mbrojtur, dhe kërcënon ekuilibrat ekologjik të lagunës.
30. AKZM dhe MTM nuk kanë marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, në përputhje me marrëveshjet⁷² ndërkombëtare, dhe Vendimin nr. 10 datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pika 4, që detyron ndryshimin e çdo plani zhvillimor që bie ndesh me parimet e mbrojtjes së zonës së mbrojtur mjedisore në Republikën e Shqipërisë.

Konkluzione:

15. Subjektet audituese nuk kanë lënë gjurmë me dokumentacion zyrtar në hapat e tyre të evidentimit, zonimit dhe mbrojtjes së lagunave, kriteret e ndjekura për caktimin e shkallës së mbrojtjes, nevojën e arsyetuar përse laguna ndodhet në atë nivel mbrojtje të propozuar, efektin që sjell niveli i propozuar i mbrojtjes, duke mosvlerësuar sa duhet rëndësinë e mbrojtjes më të lartë mjedisore të vetë lagunës, si qendra gjeologjike e krijimit të sistemit ligatinor.
16. Mungesa e dokumentacionit të kartelave/pasaportave të zonave të mbrojtura lagunore/ligatinore ka penguar punën audituese për vlerësimin e informacionit të cilin ato mbartin. Në këto kushte, nuk provohet roli proaktiv i subjekteve në evidentimin e florës, faunës dhe hartografinë e zonave që të njihen dhe aksesohen online nga publiku.
17. Në ndërtimin tregtar (restorant) të ndodhur në lagunën e Patokut, kordoni Litoral, nuk është bërë kufizimi i kontaktit të publikut me zonën ku përjashtohet përdorimi i saj për pushim e çlodhje, rrjedhimisht dhe aktivitetet përfituese mbi pushimin e çlodhjen.
18. Aktivitetet e peshkimit për qëllime përfitimi tregtar në zonat Monument Natyre, krijojnë një efekt shqetësues për zhvillimin e qëndrueshëm, megjithëse në këto zona të mbrojtura me shkallën e parë të mbrojtjes, janë të ndaluara të gjitha aktivitetet njerëzore⁷³ që mund ta dëmtojnë ekosistemin, përveç kërkimit shkencor.
19. Pengimi i lëvizjes së lirë të peshqve dhe ngjalave, mes dajlanëve ka sjellë si rrjedhojë uljen e vijueshme të rezervave peshkore në laguna, referuar INSTAT, ku në det kemi rritje të sasive të kapura të peshkut, kurse në lagunë kjo sasi vjen në zbritje të vazhduar, që tregon mungesë të konceptimit dhe zbatimit të politikave mbi peshkimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
20. Pengimi i qëllimshëm apo i paqëllimshëm qarkullimit të ujit në laguna, si procese të depozitimit të rërës së detit apo depozitimeve humane, mes kanaleve të komunikimit, dëmton ekosistemin lagunor, degradon sistemin e bimësisë, duke rritur salitetin në ujë gjatë periudhës së verës.

⁶⁹ Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, neni 47, pika 1, germa a.

⁷⁰ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 58, pika 3, germa h.

⁷¹ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 1.

⁷² Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 26, pika 5, germa b; neni 27, pika 1; neni 4, germa b

⁷³ Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, neni 15, pika 2, germa b.

21. Mungesa e caktimit të zonës qendrore në një hartë të aksesueshme nga publiku, përfshirë atë të shfaqur në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, zonave buferike dhe rekreative, krijon mundësi për ndërhyrje të pastudiuara në planifikimin e zhvillimeve ndërtimore në këto zona.
22. Mungesa e hartave për zonat e mbrojtura, ndryshimeve në to si dhe paraqitja e nënzonimeve të brendshme referuar përcaktimeve të Ligjit “Për zonat e mbrojtura” neni 13 pika 6 dhe 36 i tij, mbi miratimin nga Këshilli Kombëtar të Territorit përpara miratimit në Këshillin e Ministrave, ka cenuar procesin dhe krijon problematika në evidentimi e qartë të kufijve të këtyre zonave, kjo jo vetëm për institucionet shtetërore por edhe për qytetarët e interesuar.
23. Reduktimi i sipërfaqeve me interes ndërkombëtar RAMSAR në parkun e Butrintit dhe Karavastasë, është shkelje e konventave ndërkombëtare, që mund të sjellë penalitete nga këto organizma. Gjithashtu këto veprime janë të pajustificuara nga pikëpamja e respektimit të zonave të mbrojtura mjedisore me rëndësi ndërkombëtare mbi shpendët migratorë.
24. Gjuetia në zonën buferike pranë Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, në zonën e kalimit të shpendëve IBA, në kushtet e ndalimit të gjuetisë, dëmton rëndë ekosistemin e vetë parkut, në të cilin rriten dhe folenizojnë mbi 5% e pelikanit kaçurrel të rezervës botërore të kësaj specie duke krijuar probleme të rënda mjedisore.
25. Mungesat e analizimeve ezauruese të lëvizjeve të ujit të ndotur nga lumenjtë, përrenjtë dhe kanalet kulluese mes hidrovorëve, impaktin mbi ekosistemin lagunor, depozitimet e ndotësve në trupat e specieve lagunore të destinuara për konsum ushqimor të njeriut, përbën një risk të lartë të ekosistemit me njeriun në qendër në kuptimin e biosferës të trajtuar në programin e UNESCO, Njeriu dhe biosfera.
26. Vonesat vjetore në marrjen e analizave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mes raporteve vjetore të kësaj agjencie, nuk i shërbejnë përmirësimit të politikave të zhvillimi të qëndrueshëm në zonat e mbrojtura lagunore. Mungesa e një laboratorit mbi florën dhe faunën dhe arsyet e sëmundjeve të shpendëve, apo peshqve, krijon probleme në adresimin e zgjidhjeve në kohë reale.
27. Mungesa e raportimit nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për agjencitë që sigurojnë cilësinë e ujit për konsum publik, dhe mungesa e marrjes së hapave për ndalimin e depozitimit të mbetjeve urbane brenda Parkut Kombëtar, Zonë e Mbrojtur IBA dhe RAMSAR, sjell dëme të parikuperueshme në ekosistem, në qendër të së cilit është njeriu, i cili ndihet i rrezikuar si nga produktet që konsumon nga laguna, peshk dhe ngjalë, por edhe nga ndotja potenciale e ujit të pijshëm.
28. Subjektet nën auditim nuk kanë hartuar politika për eliminimin e specieve evazive gaforra blu, e cila ka sjellë rënie në nivele kritike të sasisë së peshkut në laguna. Specifikisht në lagunën e Vilunit, sipas AdZM Shkodër vlerësohet të jetë një sasi prej rreth 3,000 ton gaforre blu.
29. Mosmarrja e masave nga institucionet përgjegjëse për ndalimin e tërheqjes së ujit nga kriporja e Vlorës, prej Lagunës së Nartës dhe jo direkt nga deti, përbën një risk të lartë mjedisor, pasi dëmton ekuilibrat ekologjik të vetë lagunës por ndikon negativisht dhe në uljen e stokut ushqimor për shpendët IBA që popullojnë lagunën.
30. Planet afatgjata të zhvillimit të turizmit, dhe aktiviteteve mbështetëse të turizmit, nuk janë në linearitet me politikat e UNESCO, RAMSAR dhe Konventën e Bernës, por të denoncuara prej tyre në kohë.

Rekomandime:

15. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për përditësimin e të dhënave të sakta mbi lagunat, me përcaktim të saktë në sipërfaqe, shkallë mbrojtje mjedisore dhe evidentimin e brigjeve të tyre me koordinata sipas detyrimeve nënligjore në sistemin Evropian të koordinatave UTM Zone34N, për akses të lirë edhe nga përdoruesit turistik por jo vetëm, të cilët shfrytëzojnë turizmin ekologjik.

Brenda muajit Mars 2023

16. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për administrimin e pasaportave të zonave të mbrojtura, sipas detyrimeve kontraktuale, dhe t'i publikojnë ato të ndara sipas detyrimeve institucionale.

Brenda muajit Janar 2023

17. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për të adresuar zgjidhjen e problemit mjedisor të krijuar me ndërtimet në zonë strikte Monument Natyre dhe të rikuperojnë dëmin mjedisor të krijuar në këto zona.

Brenda muajit Mars 2023

18. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për të studiuar kosto-përfitimin nga ushtrimi i aktiviteteve përfituese tregtare të peshkimit, apo lundrimin mbi ekosistemin dhe të kufizojnë veprimtaritë tregtare mbi këto monumente natyre, duke orientuar veprimtaritë në monumente të natyrës drejt kërkimit shkencor.

Menjëherë

19. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura të marrin masa për përditësimet në kontratat e peshkimit me kurthe, Dajlan, apo Starnik, për kufizimin apo ndalimin, sipas analizës së rezervave peshkore për çdo lagunë, pas analizimit të plotë të rezervës peshkore në çdo lagunë.

Brenda muajit Mars 2023

20. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për të caktuar/krijuar një strukturë monitoruese të përhershme për mbajtjen hapur të kanaleve të komunikimit me ujë të lagunave si dhe për t'i pastruar ato nga mbeturinat inerte detare gjatë gjithë vitit.

Brenda vitit 2022

21. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për të bërë një vlerësim të plotë mbi rëndësinë në ekosistem të lagunave dhe të japin statusin e mbrojtjes që përkon me peshën që lagunat kanë në ekosistem, duke caktuar dukshëm në hartë nënzonimin dhe të njoftojnë në faqen e AKZM kushtëzimet mbi nënzonimin.

Brenda muajit Mars 2023

22. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa për të hartuar dhe miratuar në Këshillin Kombëtar të Territorit, hartografinë e nënzonimit, ku të qartësohen drejt nën zonat dhe pozicioni i lagunës për efekt nënzonimit për të gjashtë kategoritë e mbrojtjes mjedisore.

Brenda muajit Mars 2023

23. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për të njoftuar sekretariatit e Marrëveshjes RAMSAR, lidhur me ndryshimet e bëra në sipërfaqet e zonave të mbrojtura.

Brenda muajit Janar 2023

24. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura pas kryerjes së vlerësimeve të nevojshme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të marrin masa për të përfshirë në mbrojtje zonën me sipërfaqe gati 14 km² në veri të plazhit të Semanit Fier dhe jug të grykëderdhjes së lumit Seman, me statusin e zonës buferike të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

Brenda muajit Mars 2023

25. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për analizimin e specieve që rriten në lagunë, mbi nivelet e asimiluara të ndotjeve nga këto gjallesa dhe propozimet mbi sigurinë e produktit ushqimor peshk, ngjalë apo midhje të gjuajtur në lagunë.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për të kryer në kohë analizat e ujit, ajrit, tokës, si edhe specieve që jetojnë në laguna e brigjet e tyre apo ngordhin, me periodicitet të lartë, që të modelojnë zgjidhje afatgjata për problemet e ekosistemit, mes analizimit së të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për raportimin e problematikës në organet administrative kompetente, me qëllim eliminimin e rrezikut që ndotja nga vend grumbullimi i mbetjeve në fshatin Gur, Bashkia Divjakë mund të ketë në ujin e pijshëm, në këtë akuifer nëntokësor, sipas të dhënave gjeologjike të zonës si dhe të vlerësohet dëmi mjedisor dhe të kryhet rikuperimi i tij.

Menjëherë

28. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrin masa për të ndërtuar dhe vënë në zbatim një program të detajuar, për kapjen dhe minimizimin e gaforres blu, me qëllim vendosjen e ekuilibrave ekologjikë të specieve në lagunë.

Menjëherë

29. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masat e nevojshme për t'i adresuar zyrtarisht poseduesit të koncesionit "Kriporja Vlorë" problematikat e shkaktuara në ekosistem nga tërheqja e ujit nga laguna për procesin e nxjerrjes së kripës dhe kryerjen e procesit të furnizimit me ujë të kripores direkt nga deti.

Brenda muajit Janar 2023

- 30 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa e nevojshme që investimet strategjike përpara miratimit të tyre të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në respekt të detyrimeve ndërkombëtare, pa cenuar ekuilibrat në ekosistemin mjedisor dhe sigurinë ushqimore, përfshirë sigurinë e jetës së qytetarëve.

Në vijimësi

1.2 Pyetje e auditimit: A kanë përmbushur institucionet përgjegjëse detyrimet e tyre në ruajtjen dhe administrimin e lagunave?

1.2.1 A ka patur bashkëveprim dhe koordinim mes aktorëve të përfshirë ?


-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)

AKZM ka për qëllim menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe funksionimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vendin tonë, që përbëjnë sot rreth 18% të territorit të vendit. Ajo menaxhon rrjetin e zonave të mbrojtura, monitoron dhe inventarizon florën dhe faunën në këto zona. AKZM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas rrjetit të zonave të mbrojtura të miratuara dhe atyre që parashikohen të miratohen në të ardhmen.

Në Shqipëri nuk ekziston një strukturë e posaçme për ruajtjen dhe administrimin e lagunave, por janë disa struktura që ruajnë dhe administrojnë elementë të ndryshëm të lagunave dhe ligatinave. Për lagunat/ligatinat që kanë statusin si Zonë e Mbrojtur mjedisore apo janë pjesë e sipërfaqes së një të tillë, institucioni përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e tyre është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

AKZM-ja ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme, në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas administratave rajonale të zonave të mbrojtura. Funksionet, përbërja, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e Agjencisë, si organ qendror i specializuar për zonat e mbrojtura dhe institucioneve të varësisë së saj parashikohen shprehimisht në ligjin nr.81/2017, datë 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura” si dhe miratohen me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Grafiku nr. 4 Struktura e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura



Burimi: AKZM përpunuar nga Grupi i Auditimit

Kuadri rregullator mbi të cilin funksionon AKZM është legjislati i ndërkombëtar dhe ai kombëtar. Në legjislatin ndërkombëtar përfshihen konventat apo marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës, të cilat janë ratifikuar nga shteti shqiptar, ku më kryesorja në fushën e ligatinave është Konventa Ramsar e cila përcakton një sërë detyrimesh nga palët nënshkruese. Legjislati vendas, që rregullon veprimtarinë e AKZM-së është: VKM-ja e krijimit të saj nr. 102, datë

04.02.2015, e ndryshuar me VKM-në nr. 382, datë 25.05.2016 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 102, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”; Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”; dhe “Rregullorja e Brendshme e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 145, datë 27.07.2016. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka një staf prej 304 personash, nga të cilët 24 në zyrën qendrore dhe 280 persona në Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Në detyrat kryesore të AKZM-së përfshihen: udhëheqja, drejtimi, organizimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i strukturave të zonave të mbrojtura që ka në varësi.⁷⁴

Nga përgjigjet për konfirmimin e të dhënave zyrtare, grupi i auditimit konstaton se AKZM ka sjellë përgjigje të përgjithshme që lidhen me monitorimet që kryejnë AdZM-të rajonale në zonat që ruajnë dhe administrojnë dhe jo raporte monitorimi apo kontrolli mujore/periodike që AKZM kryen tek këto struktura të zonave të mbrojtura që ka në varësi. Raportet e AKZM-së janë monitorime vjetore ku përfshihen problematika në fushën e lagunave të hasura dhe të raportuara nga AdZM-të rajonale. Grupi i auditimit konstaton se AKZM nuk i ka ndryshuar objektivat për periudhën 2019-2021 sepse këto objektiva janë përcaktuar njësoj për tre vite me radhë konkretisht:

- planifikimi i kontrolleve të vazhdueshme për parandalimin e gjuetisë së paligjshme;
- inventarizim dhe identifikim të aktiviteteve të ligjshme dhe të paligjshme në territoret e zonave të mbrojtura, problemeve madhore që lidhen me mirëfunksionimin e çdo zone dhe raportet me aktorët e tjera në zone (peshkatore, restorante, shërbime, organe vendore, etj.);
- hartimi i programeve të punës të përbashkëta me ISHMP-në, Policinë e Shtetit, Inpektoratin e Peshkimit, Pushtetin Vendor dhe me të gjithë Institucionet e tjera në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit, mjedisit, pyjeve, kullotave brenda zonave të mbrojtura;
- Kontrolle në AdZM-të e qarqeve për plotësimin më të saktë të dokumentacionit dhe zbatueshmërisë ligjore për zonat e mbrojtura;

Përsa më sipër nuk evidentohet me dokumente justifikues ndërmarrja e aktiviteteve të mësipërme në rang Drejtorie Qendrore.

Në planet vjetore të parashikimit të punës që do të realizonte AKZM për periudhën 2019-2021, konstatohet se detyrat e parashikuara për tu realizuar janë të pandryshuara dhe nuk paraqesin iniciativa bashkëpunimi ndër-institucional me institucionet e tjera të linjës përgjegjëse për administrimin fizik të lagunave me efektivitet, ruajtja e faunës/florës së tyre, ruajtja prej ndotjes ujore lagunore si prej qarkullimit të ujërave apo ndotjeve të njeriut, sigurimi i një biodiversiteti të qëndrueshëm në respekt të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore të vendit.⁷⁵

-Administrata Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM)

Administratat rajonale të zonave të mbrojtura (AdZM) janë institucione, në varësi të AKZM-së me seli në çdo qark dhe përbëjnë rrjetin institucional vendor të specializuar, që duhet të zbatojnë detyrat për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave të mbrojtura mjedisore që ndodhen në qark. AdZM-të kanë detyra dhe përgjegjësi të ngarkuara nga legjislacioni mjedisor në fuqi⁷⁶ dhe nga ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura.

Këshilli i Konventës së Ramsarit ka publikuar udhëzime të detajuara mbi çështje të ndryshme të përdorimit të lagunave. Këto udhëzime duhet të zbatohen me anë të autoriteteve publike përkatëse kompetente për përdorimin dhe menaxhimin e lagunave ose çështjet e lidhura me to. Sektori i monitorimit, pranë çdo AdZM-je duhet të kryejë monitorimin e zonave të mbrojtura për parandalimin

⁷⁴ Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 38 pika 5


⁷⁵ Rregullorja e Brendshme AKZM dhe AdZM, neni 29

⁷⁶ Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 39

dhe evidentimin e aktiviteteve të paligjshme. Gjithashtu ata duhet të monitorojnë gjendjen e habitateve, florës dhe faunës.

Referuar urdhrit nr.26, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin dhe të organikës së AKZM dhe AdZM-ve”, administratat rajonale, që ruajnë dhe administrojnë lagunat më kryesore në Shqipëri janë të organizuara sipas skemës së mëposhtme:

Grafiku nr. 5 Struktura e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura



Burimi: AKZM përpunuar nga Grupi i Auditimit

AdZM Fier administron dhe ruan Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta” pjesë e të cilit është Laguna e Karavastasë e shpallur Zonë e Mbrojtur mjedisore e kategorisë së II-të, me VKM-në nr. 687, datë 19.10.2007. Laguna ka një sipërfaqe rreth 4,100 Ha. *Kjo AdZM ka 23 punonjës gjithsej, ndër të cilët tek sektori i monitorimit 11 roje mjedisore.*

AdZM Vlorë administron dhe ruan Lagunat e Nartës, Limopuo, Kallëngës dhe Godullës. Brenda Lagunës së Nartës gjendet edhe kriporja e Skrofotinës. Laguna e Nartës ka një sipërfaqe prej rreth 2,670 Ha. Gjithashtu kjo zonë është zonë e rëndësishme për shpendët (Important Birds Area-IBA) si një habitat me rëndësi për shpendët migratorë, aprovuar sipas Urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 283, datë 10.04.2013, “Mbi aprovimin e ligatinave bregdetare, të cilat shërbejnë si habitate për shpendët migratorë”, i amenduar. Laguna Limopuo është pjesë e Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë”, si dhe pjesë e listës së Monumenteve të Natyrës shpallur me VKM-në nr. 178, datë 25.03.2021 (kategoria e III-të e zonave të mbrojtura) dhe zë një sipërfaqe prej 15.10 ha. Laguna e Godullës, pjesë e Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë, zë një sipërfaqe prej 61.8 Ha.

Laguna e Butrintit, është shpallur si Zonë e Mbrojtur e kategorisë së II-të me VKM-në nr. 134, datë 20.02.2013, me sipërfaqe të përgjithshme 9424.4 Ha. Laguna vetë zë një sipërfaqe prej 1,600 Ha dhe është pjesë e zonave RAMSAR, zonë kyçe për biodiversitetin (Key Biodiversity Area-KBA) dhe zonë e rëndësishme për shpendët (Important Birds Area-IBA) si një habitat me rëndësi për shpendët migratorë, aprovuar sipas Urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 283, datë 10.04.2013, “Mbi aprovimin e ligatinave bregdetare, të cilat shërbejnë si habitate për shpendët migratorë”, i amenduar. *Kjo AdZM ka 31 punonjës gjithsej, dhe nga këto 19 roje mjedisore tek sektori i monitorimit.*

AdZM Lezhë administron dhe ruan Lagunën e Patokut dhe Kune-Vain. Rezervatet Natyrore të Menaxhuara të “Kune-Vain-Tale” dhe “Patok-Fushë Kuqe-Ishëm”, brenda të cilave gjenden Lagunat e Kunes, Vainit dhe Patokut. “Kune-Vain-Tale” është shpallur si Zonë e Mbrojtur mjedisore e kategorisë IV-të me VKM-në nr. 432, datë 28.04.2010 me sipërfaqe të përgjithshme 4.393,21 ha (pjesë e së cilës janë dhe Lagunat e Kunes dhe Vainit). RNM “Patok-Fushë Kuqe-Ishëm” është shpallur si Zonë e Mbrojtur mjedisore e kategorisë IV-të me VKM-në nr. 995, datë 03.11.2020 (pjesë e së cilës është dhe Laguna e Patokut). *Kjo AdZM rajonale ka 18 punonjës gjithsej dhe nga këto, 6 roje mjedisore tek sektori i monitorimit.*

AdZM Shkodër administron dhe ruan Lagunën e Vilunit, Peizazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor “Lumi Buna-Velipojë”, brenda të cilit gjendet Laguna e Vilunit. PMT/U “Lumi Buna-Velipojë” është shpallur si Zonë e Mbrojtur mjedisore e kategorisë V-të me VKM-në nr. 682, datë 02.11.2005, me sipërfaqe të përgjithshme 23.027,0 ha ndërsa sipërfaqja e lagunës gjendet rreth 280 ha. *Kjo AdZM rajonale ka 28 punonjës gjithsej, dhe nga këto 16 roje mjedisore tek sektori i monitorimit.*

Referuar VKM nr.102, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKZM dhe AdZM-ve”, i ndryshuar me VKM nr.382, datë 25.05.2016 marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AKZM-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndërsa marrëdhëniet e punës së administratave të zonave të mbrojtura rregullohen sipas Kodit të Punës. Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga Ministri Përgjegjës për zonat e mbrojtura me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga auditimi konstatohet se nuk ka standarde dhe kriteret mbi përcaktimin e sipërfaqes parkut natyror në Ha (hektarë) që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit në vartësi të sipërfaqes së lagunës, llojit të parkut natyror kombëtar, faunës dhe florës në përbërje të saj, terrenit, shtrirjes së tij, etj, çka do të ndihmonte për një ndarje të drejtë të detyrave, logjistikës dhe përgjegjësisë individuale të punonjësve.

Për periudhën objekt auditimi marrëdhëniet e punës për punonjësit e AKZM-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” ndërsa marrëdhëniet e punës për punonjësit e AdZM-ve, rregullohen sipas Kodit të Punës, për rrjedhojë konstatohet se kemi dy qëndrime ligjore. Referuar urdhrit të Kryeministrit nr.26, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKZM dhe AdZM”, marrëdhëniet e punës për punonjësit e AKZM-së dhe punonjësit e AdZM-ve rregullohen me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, por nga auditimi konstatohet se ky ndryshim, nuk është implementuar në AdZM-të rajonale⁷⁷.

AdZM është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Menaxhimit dhe Sektori i Monitorimit. Veçori specifike e strukturës së AdZM-ve është se në përbërje të tyre nuk ka strukturë që mbulon shërbimet financiare dhe mbështetëse. Këto shërbime janë parashikuar të mbulohen nga AKZM, por për shak të pamundësisë për tu realizuar, stafi i menaxhimit përveç detyrave sipas rregullores angazhohet në një pjesë të kohës me funksione administrative si arkiva dhe protokoli, ndjekja e pagesave, detyrimeve të kontratave funksionet e komunikimit, monitorimeve shkencore etj.

Në përgjigjet zyrtare drejtuar grupit të auditimit, referuar kordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese për ruajtjen dhe administrimin e lagunave, ka një marrëveshje bashkëpunimi midis AdZM Vlorë dhe Drejtorisë së Peshkimit dhe Akuakulturës pranë Ministrisë së Bujqësisë e nënshkruar në vitin 2021. Megjithatë vihet re një mungesë komunikimi me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të rakorduar mbi lejet e mjedisit të dhëna në zonë të mbrojtur. Subjektet nuk përcjellin informacion të plotë pranë AdZM. Në këtë kuadër nuk përcaktohet detyrimi ligjor për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitetet në zonë të mbrojtur, për të dorëzuar pranë AdZM-ve, raportet e vetë monitorimit.

Në përgjigjet e të dhënave zyrtare drejtuar grupit të auditimit, rojet mjedisore kryejnë funksione monitorimi dhe në rastet e shkeljeve mbajnë procesverbale konstatimi dhe ja përcjellin Policisë së Shtetit apo Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, pra nuk marrin masa administrative por i përcjellin konstatimet e këtyre kundërvajtjeve në institucionet e mësipërme për veprime të mëtejshme. Thuajse në të gjitha rastet AdZM nuk kanë informacion të mëtejshëm mbi ecurinë e këtyre masave. Megjithatë referuar VKM nr.382, datë 25.06.2016 punonjësit e AKZM duhet të pajisjen me uniformë me shenja dalluese, me mjete të tjera teknike, të domosdoshme e të nevojshme

⁷⁷ Urdhri i Kryeministrit nr.26, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKZM dhe AdZM”

për kryerjen e detyrës, për administrimin e mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikqyrjen në zonat e mbrojtura, gjithashtu punonjësit e administratave rajonale e zonave të mbrojtura që veprojnë në terren (rojet mjedisore), pajisen me armë⁷⁸. Pavarësisht që aktet ligjore i kanë pajisur këta punonjës me elementët e nevojshëm, për shkeljet e konstatuara prej tyre, punonjësit e AKZM/AdZM nuk kanë të drejtën e aplikimit të masave administrative, megjithëse janë njësia përgjegjëse për Zonat e Mbrojtura, çka në vlerësimin tonë kërkon vëmendje të shtuar nga hallkat përgjegjëse në rishikimin e kompetencave të tyre.

-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

MBZHR është përgjegjëse për mbikqyrjen, menaxhimi dhe rregullimi i peshkimit dhe i aktiviteteve që kanë lidhje dhe e mundësojnë atë, bazuar në nenin 19 të ligjit Nr.64/2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar. Në kuadër të drejtave dhe përgjegjësi të saj në ruajtjen dhe administrimin e lagunave lidhur me kryerjen e aktivitetit të peshkimit në laguna, bazuar në gërmën h) të pikës 3 të Vendimit Nr. 608, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësi shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, MBZHR ka përgjegjësi hartimin dhe zbatimin e politikave për peshkimin dhe menaxhimin e burimeve peshkore.

Bazuar në pikën 99 të nenit 4 të Ligjit Nr.64/2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar, sipërfaqet ujore të lagunave bregdetare klasifikohen në “Ujëra të brendshme”.

Referuar Seksioni IV *Peshkimi në ujërat e brendshme* të Ligjit nr.64/2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar, MBZHR ka të drejtën e dhënies së lejes për kryerjen e aktivitetit të peshkimit tregtar artizanal në ujërat e brendshme (laguna), e drejta e peshkimit në ujërat e brendshme fitohet nëpërmjet konkurrimit publik, me qëllim menaxhimin e ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë MBZHR lidh kontrata me subjekte private të shpallura fituese nga konkurrimi publik dhe për zonat e shpallura bashkë menaxhuese të peshkimit bashkëpunon me organizatat e menaxhimit të peshkimit si dhe miraton planet e bashkë menaxhimit për një periudhë jo më shumë se dhjetë vjet. Bazuar në nenin 49 të Rregullores Nr. 1, datë 7.3.2014 “Për zbatimin e Ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 “Për Peshkimin”, e ndryshuar, Inspektorati i Peshkimit është struktura përgjegjëse për të garantuar respektimin e legjislacionit në fuqi, kontrollin e aktivitetit të peshkimit, në laguna .

Në përgjigjen zyrtare të MBZHR-së, lidhur me pyetjen nga grupi i auditimit nëse ka pasur koordinim⁷⁹ të strukturave të Inspektoratit të Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe AKZM-së në Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit për administrimin dhe ruajtjen e lagunave, në varësi të kompetencave që kanë, MBZHR është shprehur se Ministria e Mjedisit dhe Turizmit nëpërmjet një shkrese nr.7876 prot., dt.25.11.2021, drejtuar MBZHR ka kërkuar bashkëpunim institucional për ndalimin e peshkimit të paligjshëm në lagunën e Karavastase e cila i është deleguar për kompetencë Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Sipas kësaj përgjigje, Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit ka koordinuar me AdZM në nivel rajonal duke organizuar një kontroll të përbashkët për parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë së paligjshme, por nga grupi i auditimit konstatohet se ky bashkëpunim minimal mbetet në rang rajonal dhe ç’ka është më e rëndësishme, nuk ka një marrëveshje ndër institucionale në nivel qendror politikbërës, midis MBZHR dhe MTM për ruajtjen dhe administrimin me efektivitet të lagunave në Shqipëri.

Në përgjigjen zyrtare të MBZHR-së, lidhur me pyetjen nga grupi i auditimit se si kryhet koordinimi ndërmjet Inspektorateve të Peshkimit Rajonale dhe AdZM Rajonale sipas kompetencave respektive të secilit institucion për lejimin dhe kontraktimin e aktiviteteve të akuakulturës në laguna, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës është shprehur se këto struktura kanë vepruar nëpërmjet

⁷⁸ VKM nr.382, datë 25.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.102, datë 04.02.2015

⁷⁹ Ligj 64/2012 “Për Peshkimin”, neni 19, pika 2

kontrolleve të përbashkëta duke koordinuar me AdZM-të rajonale sipas zonave përkatëse.⁸⁰ Grupi i auditimit konstatoi se ka kontrolle të përbashkëta të cilat nuk përcaktohen në plane pune por ato nxiten vetëm nga problematika që mund të lindin në zonat e mbrojtura.

Në përgjigjen zyrtare të MBZHR-së, lidhur me pyetjen nga grupi i auditimit se si kryhet procesi i monitorimit dhe inspektimit të aktivitetit të akuakulturës në laguna dhe si koordinohen strukturat e Inspektorateve të Peshkimit Rajonale dhe AdZM-ve Rajonale në varësi të kompetencave që kanë, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, është shprehur se procesi i monitorimit të aktivitetit të Akuakulturës kryhet vetëm në liqenin e Butrintit pranë impianteve të midhjes ndërsa në zonat e tjera të cilat nuk kanë aktivitet akuakulture por peshkim artizanal inspektimi bazohen në ligjin 10433/2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Sa i përket procesit të inspektimit ndërmjet inspektorëve të Inspektorateve Rajonale të Peshkimit dhe inspektorëve të AdZM-ve në laguna, nëse ka bashkëpunim midis këtyre dy strukturave në konstatimin e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës është shprehur se, ka pasur bashkëpunim në parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë së paligjshme në brendësi të zonave të mbrojtura dhe monitorimin e aktivitetit të peshkimit në përputhje me legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe zonat e mbrojtura në rang rajonal, ndërkohë që mungojnë marrëveshjet në rang institucionesh qendrore AKZM-DSHPA.

-Përfshirja e Publikut në Politikbërje dhe Vendimmarrje

Në përgjigjen zyrtare të MTM për pyetjen, si hartohen planet e menaxhimit midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas nën zonave të administrimit dhe a konsultohen me ministrinë e linjës, me bashkitë, me publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe me pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të zonës së mbrojtur (lagunave) dhe a caktohen qartë dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara, ato që mund të ushtrohen pasi të pajisen me leje mjedisi apo që duan miratim të administratës së zonës, MTM i është përgjigjur: Në planet e menaxhimit përcaktohen qartë se cilat janë veprimtaritë që lejohen dhe që nuk lejohen në zonat e mbrojtura. Institucionet objekt auditimi nuk paraqitën evidenca shpresore të përfshirjes së publikut dhe shoqërisë civile në vendimmarrje dhe politikë bërje sa i përket menaxhimit brenda territorit të zonës së mbrojtur (lagunave).

Gjetje:

31. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me institucionet e tyre të varësisë, për ruajtjen dhe administrimin e lagunave, nuk kanë një marrëveshje dhe koordinim zyrtar ndër-institucional midis tyre për implementimin e kuadrit rregullator të ruajtjes dhe administrimit të lagunave me efektivitet. Lagunat si pjesë kryesore të ekosistemeve ujore, me lidhje permanente me detin por që furnizohet edhe prej burimeve ujore të ëmbla, të shfrytëzueshme edhe për qëllim peshkimi dhe turizmi ekologjik, janë qendra substanciale të zonave të mbrojtura⁸¹ dhe paraqesin nevojën për mbikëqyrje të vazhdueshme ndër institucionale.
32. Në detyrat kryesore të AKZM-së përfshihen: udhëheqja, drejtimi, organizimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i strukturave të zonave të mbrojtura që ka në varësi.⁸² Nga auditimi evidentohet se, AKZM nuk dispononte raporte monitorimi apo kontrolli mujore/periodike për AdZM-të rajonale, që ka në varësi. Në raportet vjetore të monitorimit përfshihen vetëm problematika në fushën e lagunave të hasura dhe të raportuara nga AdZM-të rajonale. Gjithashtu evidentohet se, AKZM

⁸⁰ Ligj 64/2012 “Per Peshkimin”, neni 19, pika 2

⁸¹ Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”; Ligj 64/2012 “Per Peshkimin”, neni 19, pika 2

⁸² Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 38 pika 5

nuk i ka ndryshuar objektivat për periudhën 2019-2021, të cilat janë njëloj për tre vite me radhë dhe konkretisht:

- a)- planifikimi i kontrolleve të vazhdueshme për parandalimin e gjuetisë së paligjshme;
- b)- inventarizim dhe identifikim të aktiviteteve të ligjshme dhe të paligjshme në territoret e zonave të mbrojtura, problemeve madhore që lidhen me mirëfunksionimin e çdo zone dhe raportet me aktorët e tjera në zone (peshkatarë, restorante, shërbime, organe vendore, etj.);
- c)- hartimi i programeve të punës të përbashkëta me ISHMP-në, Policinë e Shtetit, Inpektoriatin e Peshkimit, Pushtetin Vendor dhe me të gjithë Institucionet e tjera në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit, mjedisit, pyjeve, kullotave brenda zonave të mbrojtura;
- d)- Kontrolle në AdZM-të e qarqeve për plotësimin më të saktë të dokumentacionit dhe zbatueshmërisë ligjore për zonat e mbrojtura;

33. Në planet vjetore të parashikimit të punës që do të realizonte AKZM për periudhën 2019-2021 rezultoi se, detyrat e parashikuara për tu realizuar janë të pandryshuara dhe nuk paraqesin iniciativa bashkëpunimi ndërinstitucional me insitucionet e tjera të linjës përgjegjëse në lidhje me administrimin fizik të lagunave me efektivitet, ruajtjen e faunës/florës së tyre, ruajtja prej ndotjes ujore lagunore si prej qarkullimit të ujërave apo ndotjeve të njeriut, sigurimin e një biodiversiteti të qëndrueshëm në respekt të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore të vendit⁸³.
34. Nga auditimi rezultoi se, nuk ka standarde dhe kriteret mbi përcaktimin e sipërfaqes së parkut natyror në Ha (hektarë) që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit në vartësi të sipërfaqes së lagunës, llojit të parkut natyror kombëtar, faunës dhe florës në përbërje të saj, terrenit, shtrirjes së tij, etj.
35. Për periudhën objekt auditimi marrëdhëniet e punës për punonjësit e AKZM-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndërsa marrëdhëniet e punës për punonjësit e AdZM-ve rajonale, rregullohen sipas Kodit të Punës, për rrjedhojë konstatohet se në këtë rast kemi të bëjmë me dy qëndrime të ndryshme ligjore. Ndërkohë që sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.26, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKZM dhe AdZM”, marrëdhëniet e punës për punonjësit e AKZM-së dhe punonjësit e AdZM-ve rregullohen me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, por ky përcaktim, nuk është implementuar në AdZM-të rajonale⁸⁴.
36. AdZM është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Menaxhimit dhe Sektori i Monitorimit. Veçori specifike e strukturës së AdZM-ve është se në përbërje të tyre nuk ka strukturë që mbulon shërbimet financiare dhe mbështetëse. Këto shërbime janë parashikuar të mbulohen nga AKZM, por për shak të pamundësisë për tu realizuar, stafi i menaxhimit veç detyrave sipas rregullores angazhohet në një pjesë të kohës me funksione administrative si arkiva dhe protokolli, ndjekja e pagesave, detyrimeve të kontratave funksionet e komunikimit, monitorimeve shkencore etj.
37. Nga auditimi rezultoi se, rojet mjedisore kryejnë funksione monitorimi dhe në rastet e shkeljeve mbajnë procesverbale konstatimi të cilat ia përcjellin Policisë së Shtetit apo Inspektoratit Kombëtar të Ruajtjes së Territorit, pra nuk marrin masa administrative por i përcjellin konstatimet e këtyre kundërvajtjeve në institucionet e mësipërme për veprime të mëtejshme. AKZM nuk kishte një *feedback* mbi veprimet e kryera në vijimësi nga këto institucione, megjithëse është organi kryesor i cili e mbikëqyr në vazhdimësi zonën e mbrojtur⁸⁵.

⁸³ Rregullorja e Brendshme AKZM dhe AdZM , neni 29

⁸⁴ Urdhri i Kryeministrit nr.26, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKZM dhe AdZM”

⁸⁵ VKM nr. 382 datë 25.06.2016

38. Nga auditimi rezultoi se, për kordinimin dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera ligjzbatuese për ruajtjen dhe administrimin e lagunave, ka një marrëveshje bashkëpunimi midis AdZM Vlorë dhe Drejtorisë së Peshkimit dhe Akuakulturës pranë Ministrisë së Bujqësisë e nënshkruar në vitin 2021. Megjithatë ka një mungesë komunikimi me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të rakorduar mbi lejet e mjedisit të dhëna në zonë të mbrojtur. Subjektet nuk përcjellin informacion të plotë pranë AdZM-ve. Në këtë kuadër nuk përcaktohet detyrimi ligjor për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitetet në zonë të mbrojtur, për të dorëzuar pranë AdZM-ve, raportet e vetë monitorimit.
39. Nga auditimi rezultoi se, koordinimi⁸⁶ i strukturave në nivel qendror politikbërës, për lejimin dhe kontraktimin e aktiviteteve të akuakulturës në laguna, administrimin dhe ruajtjen e tyre, gjendej thuajse inekzistent. Rastet e pakta të bashkëpunimit në nivel rajonal i përkasin bashkëveprimeve midis Inspektoratit të Peshkimit në MBZHR dhe AKZM-së institucion varësie i MTM për një kontroll të përbashkët për parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë së paligjshme në laguna. Megjithatë nuk evidentohen iniciativa të tjera nga asnjë nga ministritë e linjës për një marrëveshje ndër-institucionale në nivel qendror politikbërës, për ruajtjen dhe administrimin me efektivitet të lagunave në vend.
40. Nga auditimi rezultoi se, procesi i monitorimit dhe inspektimit të aktivitetit të akuakulturës në laguna dhe koordinimi midis strukturave dhe Inspektorateve Rajonale të Peshkimit dhe AdZM-të Rajonale kryhet vetëm në liqenin e Butrintit pranë impianteve të midhjes ndërsa në zonat e tjera ku ska aktivitet akuakulture, por peshkim artizanal inspektimi bazohet në ligjin 10433/2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Sa i përket procesit të inspektimit në laguna ndërmjet Inspektorateve Rajonale të Peshkimit dhe inspektorëve të AdZM-ve Rajonale, në konstatimin e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës trajton se, ka patur bashkëpunim në parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë së paligjshme në brendësi të zonave të mbrojtura dhe monitorimin e aktivitetit të peshkimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe zonat e mbrojtura në rang rajonal. Megjithatë ky bashkëpunim ka mbetur në nivel lokal dhe pa u finalizuar në rang Drejtorie Qendrore AKZM-DSHPA (Inspektorati i Peshkimit) çka do të garantonte përmbushjen e detyrimeve të ndërsjellta midis këtyre strukturave.
41. Mungonin evidencat shkresore të cilat të dokumentonin përfshirjen e publikut dhe shoqërisë civile në vendimmarrje dhe politikbërje, sa i përket vendimmarrjes dhe menaxhimit brenda territorit të zonave të mbrojtur të cilat përfshijnë laguna. Referuar përgjigjes zyrtare të konfirmimit të dhënave drejtuar grupit të auditimit për pyetjen, si i harton MTM planet e menaxhimit sipas nënzonave të administrimit dhe a konsultohen me ministritë e linjës, bashkitë, publikun e interesuar⁸⁷, shoqërinë civile dhe pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të zonës së mbrojtur (lagunave) dhe a caktohen qartë dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara dhe ato që mund të ushtrohen pasi të pajisen me leje mjedisi apo që duan miratim të administratës së zonës, MTM i është përgjigjur se, në planet e menaxhimit përcaktohen qartë cilat janë veprimtaritë që lejohen dhe ato të cilat nuk lejohen në zonën e mbrojtur duke mosdokumentuar dhe arsyetuar procesin.

Konkluzione:

31. Mungesa e marrëveshjes ndër institucionale nga strukturat përgjegjëse MTM dhe MBZHR, për koordinimin e veprimtarisë funksionale ndikon negativisht në drejtim të ruajtjes dhe administrimit efektiv të lagunave.

⁸⁶ Ligj 64/2012 “Per Peshkimin”, neni 19, pika 2

⁸⁷ VKM nr.102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe funksionimin e AKZM dhe AdZM, Kreu IV, pika b

32. Mospërditësimi i objektivave institucional nga ana e AKZM për tre vite radhazi konkretisht për vitet 2019-2021 ka sjellë mungesën e koordinimit institucional në kuadër të mbrojtjes së biodiversitetit në ekosistemet lagunore.
33. Mungesa e marrëveshjeve në nivel rajonal në funksion të ruajtjes dhe administrimit të lagunave nga Inspektoratet e Peshkimit dhe AdZM-të ka sjellë veprime të pakoordinuara midis strukturave përgjegjëse.
34. Mospërcaktimi i standardeve dhe kriterëve mbi sipërfaqet e zonave të mbrojtura në Ha (hektarë), që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit ka sjellë mungesë efektiviteti në mbrojtjen e lagunave si rrjedhojë e mungesës së detyrave të qarta dhe hapësirave të mirëpërcaktuara në raport me burimet njerëzore të disponueshme.
35. Mungesa e aplikimit të penaliteteve nga rojet mjedisore si dhe mosfunksionimi i kthimit të informacionit mbi shkeljet e konstatuara prej tyre krijon një situatë të paqartë dhe jo ndihmuese në veprimtarinë e tyre monitoruese, çka kufizon kompetencat e tyre në zonën e mbrojtur.
36. Mbajtja e dy qëndrimeve të ndryshme ligjore për marrëdhëniet e punës brenda të njëjtit institucion AKZM dhe AdZM, ndërkohë që dispozitat ligjore përcaktojnë që marrëdhëniet epunës të jenë brenda shërbimit civil⁸⁸. për të dy strukturat, nuk krijon garanci të mjaftueshme për stafin rajnal marrëdhëniet e të cilit aktualisht rregullohen me Kodin e Punës.
37. Mungesa e videncave shkresore për përfshirjen e publikut dhe shoqërisë civile në vendimmarrje dhe politikë bërje, sa i përket vendimmarrjes dhe menaxhimit brenda territorit të zonës së mbrojtur⁸⁹ krijon premisa për veprime të pakonsultuara dhe jo transparente me qytetarët apo grupet e interesit.

Rekomandime:

31. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masa për hartimin e një marrëveshje të përbashkët për kryerjen e veprimeve në rang qendror dhe vendor duke qartësuar kompetencat e secilës strukturë dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit mes tyre në funksion të ruajtjes dhe mirëadministrimit të lagunave.

Brenda muajit Mars 2023

32. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa që në koordinim me Pushtetin Vendor, Policinë e Shtetit, IKMT-në, dhe Inspektoratin e Peshkimit, të hartojë një akt-marrëveshje në nivel qendror dhe rajonal në funksion të ruajtjes dhe administrimit të lagunave nëpërmjet përcaktimeve për kontrolle të përbashkëta, për të mënjeluar dhe minimizuar problematikat, që mund të lindin në zonat e mbrojtura me aktivitet akuakulture në laguna.

Brenda muajit Mars 2023

33. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masa për përditësimin e kuadrit rregullator të duke qartësuar kompetencat institucionale të AdZM-ve dhe inspektorateve përkatëse për mbajtjen dhe ndjekjen e procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve që konstatohen në laguna, në kundërshtim me planet e menaxhimit apo pa lejen e administratës së zonës.

Brenda muajit Mars 2023

⁸⁸ Urdhri i Kryeministrit nr.26, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKZM dhe AdZM"

⁸⁹ VKM nr.102, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe funksionimin e AKZM dhe AdZM, Kreu IV, pika b

34. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa për hartimin e një rregullore që qartëson procedurat konkrete për zbatimin e planit të menaxhimit, legjislacionin të zonës së mbrojtur, legjislacionit të peshkimit, lundrimit etj.

Brenda muajit Mars 2023

35. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa për rregullimin dhe unifikimin e marrëdhënieve të punës, për punonjësit e AdZM-ve dhe punonjësve të AKZM-së sipas statusit të nëpunësit civil⁹⁰ duke kryer propozimet e nevojshme ligjore dhe rregullative në këtë drejtim.

Brenda muajit Janar 2023

36. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të përcaktojë një metodologji në bazë të të cilës të hartohen kriteret mbi sipërfaqet e në Ha (hektarë) parkut natyror që duhet të mbulojë një roje mjedisore në AdZM.

Brenda vitit 2022

37. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa për të përfshirë publikun dhe shoqërinë civile në vendimmarrje dhe politikbërje, me qëllim tërheqjen e mendimit të publikut në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura.

Në vijimësi

1.2.2 A ka patur mirëmenaxhim të lagunave nga institucionet përgjegjëse ?

Institucionet subjekt i këtij auditimi përkatësisht MTM, AKZM dhe MBZHR, janë institucionet kryesore të cilat janë të ngarkuara sipas fushave të tyre të përgjegjësisë për ruajtjen dhe mbrojtjen e lagunave si qendra të ekosistemeve për biodiversitetin. Për shkak të brishtësisë natyrore që ato kanë, lidhur me parametrat ujorë, nevojën për komunikime të hapura me detin, burimeve të ujit të ëmbël, gjuetisë së paligjshme dhe asaj pa kriter, masivizimit të turizmit, investimeve të ndryshme dhe ndikimin e tyre në mjedis, ndotjes nga përdorimet e pesticideve në bujqësi, por jo vetëm, kërkojnë një mbikëqyrje dhe monitorim të vazhdueshëm nga ana e hallkave përgjegjëse për administrimin e tyre. Institucionet përgjegjëse nuk dispononin një bazë solide të dhënash për lagunat. Referuar të dhënave të MBZHR, sipërfaqja e lagunave zë 10,140 Ha ndërkohë që shumica e tyre janë mjaft të cekëta me një thellësi kryesisht rreth 0.7 m. Më poshtë paraqesim të grupuara të dhënat sipas lagunave.

Tabela 8: Tregues mbi lagunat kryesore në vend

Nr.	Lagunat kryesore në vend	Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
1	Viluni	280	3,500	2,000	5	0,8
2	Vaini	850	4,400	2,950	4,5	0,7
3	Kune	250	5,800	950	5	1
4	Patoku	260	3,500	200	1,5	0,7
5	Karavastaja	4,100	10,600	43,800	1,3	0,7
6	Narta	2,670	N/a	N/a	0,9	0,7
7	Orikumi	130	N/a	N/a	3,5	2,5
8	Butrinti	1,600	5,400	1,400	21,4	11
Total		10,140	N/a	N/a	N/a	N/a

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi i auditimit

⁹⁰ Urdhrit të Kryeministrit nr.26, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKZM dhe AdZM”

Veç sa më sipër janë dhe një numër lagunash/ligatinash të përhershme apo të krijuara rishtaz nga vetë natyra, kryesisht të cekëta, por të cilat sipas vëzhgimit në terren ishin vend pushime të frekuentuara nga një mori shpendësh të ndryshëm. Ato e ndryshojnë vazhdimisht sipërfaqen e tyre për shkak të aktivitetit natyror.

Administrimi i lagunave si pjesë e Zonave të Mbrojtura si rregull duhet të bazohen në përcaktimet ligjore, planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur të cilat miratohen nga Ministri dhe kanë afat vlefshmërie deri në 10 vite. Në to duhet të përcaktohen qartë dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara, ato që mund të ushtrohen si dhe ato veprimtari që duan miratim nga administrata e zonës së mbrojtur. Plani i menaxhimit është dokumenti bazë për ruajtjen dhe zhvillimin e zonës dhe ai zbatohet nga administrata e kësaj zone. Sipas të dhënave të paraqitura nga AKZM, nga Zonat e Mbrojtura të cilat përfshijnë laguna në brendësi të tyre, vetëm Parku Kombëtar Karavasta dhe ai i Butrintit disponojnë plane menaxhimi të vlefshëm, ndërsa për zonat e tjera të mbrojtura që përmbajnë laguna këto plane menaxhimi mungojnë ose e kanë humbur vlefshmërinë e tyre ligjore, çka ndikon drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe mirë administrimin e tyre.

Për periudhën objekt auditimi, AKZM nuk rezultoi të ketë kryer regjistrimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, ku përfshihen edhe lagunat, pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme si dhe skedarin kombëtar të zonave të mbrojtura. Detyrimi për regjistrimin e tyre përcaktohet qartë në nenin 55 të ligjit nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

Menaxhimi i zonave të mbrojtura financohet nga Buxheti i Shtetit si dhe burime të tjera të ligjshme. AKZM është institucioni përgjegjës për administrimin e të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e një zone të mbrojtur mjedisore referuar nenit 57 të ligjit nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”. Në zbatim të ligjit Ministri ka miratuar Udhëzimin nr. 1 datë 10.02.2021 “Mbi rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to” i cili parqet aspekte procedurale ku theksi vendoset mbi aktivitetet e lejuara nga legjislacioni dhe planet të menaxhimit, të cilat si theksuam më sipër mungojnë thuajse në të gjitha lagunat. Ndërkohë të ardhurat nga tarifat duhet të përdoren nga AKZM për investime në zonat e mbrojtura, hartimin e planeve të menaxhimit, rehabilitime habitatesh, ndërgjegjësimë publike, përmirësimin e kushteve të punës në AKZM dhe terren, etj.

Me VKM nr. 1156 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kriterëve të përdorimit të tyre”, i cili i ka shtrirë efektet nga data 1 shtator 2021, është vendosur aplikimi i tarifave të shërbimit, të ardhurat e të cilave do të përdoren nga AKZM si të ardhura jashtë limitit. Po në këtë vendim përcaktohet se të ardhurat e akumuluar nga tarifat nga momenti i krijimit të AKZM do të transferohen dhe administrohen nga kjo e fundit njëllë si në rastin e të ardhurave të veta. Sipas të dhënave të AKZM të ardhurat e papërdorura deri në vitin 2021 kapin vlerën e 53,953,920 lekë, e cila përbën një vlerë të konsiderueshme referuar buxhetit të këtij institucioni që mund të ishte adresuar në kohë dhe me efektivitet në zonat e mbrojtura në funksion të tyre. Më poshtë paraqiten vlerat sipas viteve për të ardhurat nga biletat të cilat nuk janë përdorur.

Tabela 9: Të ardhurat e papërdorura nga AKZM

Në lekë

Vitet	Totali të ardhurave	Nga biletat	
		Syri Kaltër	Laguna Kune- Vain
2019	18,200,000	8,782,850	98,000
2020	18,203,200	2,984,900	103,000
2021	17,550,720	4,895,900	454,000
Shuma	53,953,920	16,663,650	655,000

Burimi: AKZM

Theksojmë se, të ardhurat e gjeneruara nga AKZM mbi lagunat i referohen vetëm tarifave të hyrjes në lagunën e Kune-Vainit ndërkohë që mbi sipërfaqet ujore të lagunave të kontraktuara nuk aplikohen tarifa por ato taksohen vetëm për Taksën Vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në vlera simbolike 10,000 – 12,000 lekë/vit për 1 peshkatar pa marrë në konsideratë sipërfaqen që ato shfrytëzojnë, vlerë e cila kalon në llogari të Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, organ në varësi të MBZHR i përcaktuar si agjent i mbledhjes së tyre. Të ardhurat totale vjetore të mbledhura nga kjo Taksë në rang kombëtar shkojnë nga 2 deri në 2.5 milion lekë në vit.

Investimet e kryera në laguna janë të pakta dhe thuajse inekzistente përgjatë territorit të vendit. Vlen të veçojmë investimet nga Programin Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP) “Ndërtimi i elasticitetit të lagunës “Kune-Vain” përmes përshtatjes së bazuar në ekosistemin (EbA)” me periudhë implementimi vitet 2013-2022 për të cilin janë realizuar 170,018 mijë lekë, nga të cilat 122,038 mijë lekë janë disbursuar nga projekti ndërsa pjesa tjetër nga fondet e buxhetit të shtetit. Në këtë lagunë ka patur edhe përmirësime në infrastrukturën e brendshme të realizuara nga MTM për vitet 2019 dhe 2020 në vlerën 143,693 mijë lekë por nuk konstatohen aktivitete për përmirësimin e situatës biologjike dhe biodiversitetit. Investimi i fundit nga AKZM regjistrohet po në lagunën e Kune-Vain me vendosjen e postbllokut në vitin 2020 ndërsa më herët investimet datojnë në vitin 2015 kur dhe AKZM është krijuar.

Tabela 10: Logjistika e disponueshme për lëvizjet për secilën nga AdZM

Nr.	Mjete ne Perdorim	Numer Automjetesh në përdorim	Motorra	Motorbarka	Limiti mujor i Kaburantit në Litra
1	AKZM	4			750
2	AdZM - FIERI	3	9	2	650
3	AdZM - VLORA	3	3	2	750
4	AdZM - SHKODER	3	4	2	750
5	AdZM - LEZHE	2	6	1	400

Burimi: AKZM përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të AKZM por dhe të dhënave të AdZM-ve respektive logjistika e disponuar nuk gjendet e mjaftueshme për të kryer një monitorim efektiv në të gjithë territorin e zonës. Evidentohet mungesa e mjeteve por edhe e disa pajisjeve bazike ku përmendim aparatet për matjen e cilësisë së ujit të lagunave, por jo vetëm, çka paraqet nevojën për vlerësim nga hallkat drejtuese të këtij institucioni.

Ndërkohë, menaxhimi i lagunave për shkak të peshkimit kryhet *de facto* nga MBZHR e cila lidh kontrata me subjektet e interesuar të shpallur fitues nëpërmjet konkurimit publik referuar VKM nr. 712, datë 31.7.2013, i ndryshuar, “Për përcaktimin e procedurave të konkurimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore” si dhe Udhëzimit të Ministrit të MBZHR nr. 4, datë 14.5.2019, i ndryshuar, “Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, për procedurën e konkurimit publik” Modeli i kontratës është i standardizuar dhe ato miratohen me urdhër të Ministrit përgjegjës për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Aktualisht gjendet në fuqi Urdhri nr. 263 datë 22.06.2021.

Një formë tjetër menaxhimi e lagunave janë edhe kontratat e lidhura me Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) të cilat janë persona juridikë privatë që krijohen me nismën e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Referuar kuadrit ligjor aktual OMP hartojnë dhe zbatojnë plan menaxhimi

për burimet dhe kategoritë ujore sipas specifikave lokale, si rregull edhe me ndihmën edhe të kërkimit shkencor, duke marrë parasysh interesat e kategorive të tjera apo grupeve të interesit. Ato kryejnë mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me standardet e vetërregullimit dhe kanë si qëllim ruajtjen e resurseve, rritjen e performancës ekonomike, zvogëlimin e ndikimit mjedisor të peshkimit etj. Modeli i kontratës është i standardizuar dhe miratohet me urdhër të Ministrit. Aktualisht gjendet në fuqi Urdhri nr. 390, datë 18.9.2018.

Për monitorimin e kontratave të peshkimit në laguna referuar kushteve dhe detyrimeve që palët kanë marrë përsipër, nga ana e MBZHR evidentohet në tërësi një angazhim minimal. Nga të dhënat e paraqitura është nxjerrë Urdhri i Ministrit të MBZHR nr. 433 datë 20.10.2020, ndryshuar me Urdhrin nr. 138 datë 24.03.2021, në të cilin është ngritur një grup pune *ad hoc* brenda ministrisë. Grupi i punës kishte hartuar planin e monitorimit i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR i cili ishte i pjesshëm dhe përfshinte vetëm disa kontrata lagunash. Deri në përfundim të auditimit në terren u paraqitën rezultate monitorimi vetëm për një kontratë, atë të lidhur me shoqërinë L.... SHPK me NIPT J..... për lagunën Vain, në Ishull Lezhë. Edhe në këtë rast pavarësisht problematikave të rëndësishme të konstatuara nga grupi i punës dhe vënien në dijeni të hallkave përgjegjëse për vendimmarrjen nëpërmjet raportit të monitorimit të datës 16.12.2020, kjo shoqëri vijon aktivitetin normalisht, ndërkohë nuk evidentohen hapa të tjerë vendimmarrëse.

Evidentohet se, kontrata tip e miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural për peshkimin në laguna, nuk përmban objektin e investimeve, vlerat e parashikuara të investimit, prodhimit dhe punësimit që subjektet kontraktuese i kanë të detyrueshme t'i paraqesin në planet e tyre të biznesit gjatë procesit të konkurrimit, çka në vlerësimin tonë krijon risk të lartë për mospërmbushjen e tyre. Po kështu në to nuk gjendet i përcaktuar detyrimi për mirëmbajtjen e lidhjeve të lagunës me detin apo me kanalet e ujërave të ëmbla që furnizojnë lagunën çka mund të ndikonte pozitivisht në mirëmbajtjen dhe thellimin e tyre në vazhdimësi.

Mungesa e monitorimeve, mosndarja e saktë e kompetencave, mos-administrimi përshtatshëm i burimeve ka sjell jo pak problematika të rëndësishme në laguna. Një prej tyre përmendur edhe më sipër janë kanalet e lidhjes me detin, të cilat jo vetëm kufizojnë shkëmbimin e ujërave por bllokimi i tyre krijon në mënyrë të pashmangshme rritje të larta të temperaturës së ujit, rritje të kripshmërisë, etj, të cilat kanë ndikime kritike në ekosistemin që lagunat mbartin. Problematika e lidhjeve me detin gjendej të shtrira thuajse në pjesën dërmuese të tyre. Më poshtë ilustrohen disa foto të kryera nga grupi i auditimit gjatë vëzhgimit në terren për kanalet lidhëse të lagunave/ligatinave me detin.

Foto nr. 10 Njëra nga lidhjet me detin në Lagunën e Karavastasë, Divjakë (jo funksionale)



Burimi: Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Foto nr. 11 Lidhja me detin, Laguna Kallengë, Vlorë (pjesërisht funksionale)



Burimi: Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Foto nr.12 Njëra nga lidhjet me detin Laguna e Patokut (jo funksionale)



Burimi: Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Foto nr.13 Njëra nga lidhjet me detin Laguna Vain (jo funksionale)



Burimi: Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Foto nr. 14 Lidhjet me detin Laguna Vain (jo funksionale)



Burimi: Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Problematika e lidhjeve të lagunave me detin sa i përket ruajtjes së parametrave të pranueshme ujore për speciet rezulton të mos ketë gjetur zgjidhje, jo vetëm për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme por edhe sa i përket mungesës së bashkëpunimit mes strukturave të cilat veprojnë mbi lagunat. Kjo vihet re pasi, AKZM prej muajit Qershorit 2021 disponon një mjet të specializuar (Dragë për thellim) i cili ka kushtuar 74,900 USD, pjesë e përfitimit nga një projekt për ndërtimin dhe rikuperimin e lagunave të Kune-Vain-it. Ky mjet mund të ishte përdorur nga AKZM për hapjen ose thellimin e kanaleve lidhëse të lagunave me detin, pavarësisht mundësive të tjera alternative të pashfrytëzuara. Mungesa e bashkëpunimit por dhe administrimi në nivel të pamjaftueshëm ka bërë që ky mjet mjaft i volitshëm të gjendet i ankoruar në një kënd të lagunës në pritje të veprimeve dhe vendimmarrjeve nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Foto nr. 15 Draga Thelluese e AKZM



Burimi: Grupi i auditimit nga vëzhgimi në terren

Gjetje:

42. Për periudhën objekt auditimi Janar 2019 - Janar 2022 rezultoi se, AKZM nuk ka kryer ende regjistrimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, ku përfshihen edhe lagunat, pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme si dhe skedarin kombëtar të zonave të mbrojtura, sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
43. Lagunat në vend, pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura, nuk disponojnë plane menaxhimi të vlefshme ndonëse çdo veprimtari që ushtrohet në to duhet të jetë në përputhje me këto plane referuar nenit 42 dhe 43 të ligjit nr. nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
44. Megjithëse lagunat janë qendra të biodiversitetit, me interes kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe ndodhen brenda territorit të zonave të mbrojtura në to ushtrohet veprimtari peshkimi e cila krijon të ardhura minimaliste në nivel kombëtar, rreth 2 deri në 2.5 milionë lekë në vit. Ndërkohë që lagunat nuk janë objekt i tarifave të miratuara së fundi për shfrytëzimin e zonave të mbrojtura referuar VKM nr. 1156 datë 24.12.2020, duke i trajtuar ndryshe nga llojet e tjera të sipërfaqeve të mbrojtura.
45. Të ardhurat e krijuara nga zonat e mbrojtura prej krijimit të AKZM-së deri në vitin 2021 të cilat nuk janë shpenzuar por janë mbartur në vijim arrijnë vlerën 53,953,920 lekë. Këto vlera financiare sipas VKM nr. 1156 datë 24.12.2020, janë transferuar në llogarinë buxhetore të AKZM por kanë mbetur të papërdorura, ndonëse situata në laguna paraqitet problematike.
46. Megjithëse në ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” neni 59 i tij, përcaktohet krijimi i një Fondi të Veçantë me të ardhurat e AKZM por dhe donatorëve të ndryshëm i cili do të shërbente në përballimin e emergjencave të mundshme në zonat e mbrojtura, ende ky fond nuk është bërë efektiv. Kjo për mungesë të akteve nënligjore të nevojshme për burimet e krijimit dhe përdorimit të tij të cilat duhet të ishin efektive prej vitit 2019.
47. Investimet në laguna në të gjithë vendin referuar periudhës nën auditim janë thuajse inekzistente. Investimet me financim të huaj pavarësisht se kanë krijuar përmirësim të infrastrukturës nuk kanë arritur të implementohen fillimisht drejt lagunës e cila është dhe qendra e ekosistemit për të cilat këto zona mbartin vlera unike.
48. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka arritur të mbulojë me monitorim kontratat e lidhura me subjektet private sa i përket nivelit të investimit, prodhimit të realizuar, fuqisë punëtore të angazhuar referuar planit të biznesit me të cilin subjektet private kanë paraqitur për përzgjedhjen dhe lidhjen e kontratës apo kushteve të përcaktuara në planet e bashkëmenaxhimit të miratuara, në rastin e OMP-ve.
49. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural nuk dispononte një strukturë të posaçme për monitorimin e peshkimit në laguna por ato kryheshin me përbërje *ad hoc* midis drejtorive, mbi bazën e urdhrave të posaçëm të nxjerrë nga Ministri. Ndërkohë nuk kishte një strukturë përgjegjëse e cila të plotësonte dhe azhurnonte dosjet e kontratave me aktet administrative të ndërmarra brenda MBZHR apo dhe të instancave të tjera shtetërore mbi konstatime apo shkelje të mundshme. Kjo mënyrë veprimi nuk garanton mbikëqyrjen e plotë të veprimtarisë konform detyrimeve kontraktuale dhe ligjore.
50. Kontrata tip e miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural për peshkimin në laguna, nuk përmban objektin e investimeve të parashikuara, vlerat e parashikuara të investimit, prodhimit dhe punësimit që subjektet kontraktuese i kanë të detyrueshme t'i paraqesin në planet e tyre të biznesit gjatë procesit të konkurrimit.

Konkluzione:

38. Mosregjistrimi i zonave të mbrojtura pranë skedarit kombëtar të zonave të mbrojtura si dhe pranë ZVRPP, referuar përcaktimeve ligjore, krijon risk të lartë për tjetërsimin apo dëmtimin e tyre.

39. Mungesa e planeve të vlefshme të menaxhimit për zonat e mbrojtura të cilat përfshijnë dhe lagunat ndikon negativisht në ruajtjen dhe administrimin e tyre.
40. Mungesa e tarifave për këto sipërfaqe ujore zonash të mbrojtura mund të ketë ndikuar në shfrytëzimin jo të përshtatshëm të tyre, nuk janë krijuar të ardhura financiare të cilat mund të përdoren përsëri në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.
41. Mospërdorimi në kohë dhe me efektivitet i parasë publike në funksion të ruajtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura sjell risk për dëmtimin e këtyre ekosistemeve, të cilat janë asete kombëtare.
42. Vonesat e vënies në funksion të Fondit të Veçantë krijojnë risk për mospërballim në kohë të emergjencave me efekte negative të mundshme.
43. Mungesa e investimeve dhe përqëndrimi tek infrastruktura përreth pa u kujdesur më parë për lagunat si qendrat të ekosistemeve, tregon për një qasje jo të përshtatshme institucionale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ekuilibruar të këtyre aseteve kombëtare.
44. Mungesa e një strukture të dedikuar për monitorimin e kontratave ka lënë jashtë vëmendjes institucionale përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e subjekteve private, çka mund të ketë dëmtuar rezervën peshkore dhe biodiversitetin në laguna.
45. Mungesa e monitorimeve të kontratave ka efekte të rëndësishme si në aspektin e mbrojtjes së lagunës ashtu edhe në përmbushjen e detyrimeve kontraktore për të cilat subjektet private kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit për peshkim.
46. Mospërfshirja e elementëve të objektit të investimit, vlerës së tij si dhe normat e prodhimit dhe punësimit si elementë thelbësorë për përfitimin e të drejtës për peshkim si dhe detyrimit për mirëmbajtjen e hapur të komunikimit me detin apo ujërat e ëmbla, lë shteg për abuzivizëm dhe mospërmbushjen e tyre.

Rekomandime:

38. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, ku përfshihen edhe lagunat, në regjistrin e pasurive të paluajtshme të shtetit dhe skedarin kombëtar të zonave të mbrojtura.

Brenda muajit Mars 2023

39. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masat e nevojshme për hartimin e planeve të menaxhimit për secilën zonë të mbrojtur në të cilat përfshihen dhe lagunat, duke kryer paraprakisht konsultimet e nevojshme me palët e interesit me qëllim hartimin e një dokumenti sa më të plotë dhe gjithpërfshirës, i cili t'i shërbejë ruajtjes dhe administrimit sa më efektiv të tyre.

Brenda muajit Mars 2023

40. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të kërkojnë amendimin e VKM nr. 1156 datë 24.12.2020, duke përfshirë në të dhe një tarifë të posaçme për /m2 sipërfaqe ujore të lagunave të dhëna në shfrytëzim nëpërmjet kontratave nga shteti shqiptar, pjesë të zonave të mbrojtura, kjo për trajtim të unifikuar të zonës së mbrojtur por dhe rritjen e performancës së të ardhurave nga këto pasuri kombëtare.

Brenda muajit Mars 2023

41. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në vlerësim të situatës dhe problematikave që lagunat dhe ligatinat paraqesin, të marrë masat e nevojshme për të drejtuar në mënyrë të drejtë dhe objektive fondet, për të garantuar ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

42. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për të rakorduar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe të bëjë propozimet e nevojshme pranë Këshillit të Ministrave për të vendosur në funksionim Fondin e Veçantë për Zonat e Mbrojtura dhe miratimin e rregullave të përdorimit të tij.

Brenda muajit Mars 2023

43. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në rolin e institucioneve përgjegjëse, të ndërmarrin hapat e nevojshëm administrative e ligjore për të koordinuar veprimtaritë e tyre institucionale për ruajtjen dhe administrimin e efektshëm të lagunave duke vlerësuar si aspekt parësor mbrojtjen e këtyre ekosistemeve.

Në vijimësi

44. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masat e nevojshme dhe të kryejë monitorimin e të gjitha kontratave të lidhura për lagunat në vend, referuar detyrimeve kontraktuale përkatëse duke verifikuar veç të tjerash, investimet e kryera, fuqinë punëtore të angazhuar, masat e marra për ruajtjen dhe mbrojtjen e ekosistemit lagunor, respektimin e pagesës së detyrimeve shtetërore por jo vetëm. Në përfundim, referuar problematikave të konstatuara të ndërmarren veprimet konkrete referuar kontratës dypalëshe, deri në zgjidhjen e saj.

Menjëherë

45. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masat e nevojshme për kryerjen e monitorimit të kontratave të peshkimit nëpërmjet një strukture specifike e cila të ketë si pjesë të detyrave funksionale ndjekjen e vazhdueshme të tyre, duke bërë gjithashtu ndryshimet përkatëse në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm në MBZHR” e cila mban nr.4276 prot, datë 02.06.2021.

Brenda muajit Mars 2023

46. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të kryejë ndryshimet në kontratën tip të peshkimit duke përfshirë në të, objektet dhe vlerat e investimit, masën minimale të punësimit dhe prodhimit, si dhe detyrimin për mirëmbajtjen e lidhjeve natyrore me detin apo me kanalet e ujërave të ëmbla që furnizojnë lagunën sipas kushteve me të cilat është fituar konkurimi.

Brenda muajit Mars 2023

5. PËRMBLEDHJE

Objekti i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i politikave të ndërmarra nga subjektet nën auditim për ruajtjen dhe administrimin e lagunave në vend dhe efektiviteti i tyre për periudhën objekt auditimi Janar 2019- Janar 2022. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij kishte një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e funksionalitetit që institucionet e ngarkuara për ruajtjen dhe administrimin kishin në lidhje me hartimin, zërbërthimin e politikave dhe implementimin e tyre. Gjatë këtij auditimi ne u fokusuam në tre institucione, konkretisht Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, çka na shërbeu për të patur një panoramë më të plotë lidhur me politikat e ndërmarra, implementimin e tyre, koordinimin ndërmjet strukturave dhe krahasimin e qasjes që ato kanë në varësi të përgjegjësisë dhe specifikave që mbulojnë. Auditimi u fokusua veçanërisht në disa kolona bazë si, plotësia dhe përshtatshmëria e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, masat e marra për mbrojtjen e biodiversitetit në laguna, vlerësimi i strukturave të ngritura dhe koordinimi i tyre, fondet e alokuara dhe përdorimi, transparenca si dhe përfshirja e komunitetit në politikat e hartuara apo vendimmarrjet e kryera. Në vlerësimin tonë si auditues të jashtëm, të pavarur, masat e marra nga institucionet përgjegjëse nuk kanë qenë efektive. Lagunat në vend ndodhen në situatë kritike, kjo kryesisht për mungesë të

vëmendjes së duhur nga strukturat shtetërore të ngarkuara për ruajtjen dhe administrimin e tyre. Pavarësisht faktit që gjenden thuajse totalisht brenda zonave të mbrojtura ato nuk i kanë shpëtuar problematikave të ndërtimeve të padisplinuara, tjetërsimit, ndotjes, apo shfrytëzimit pa kriter të tyre. Politikat e prodhuara nga ana e institucioneve përgjegjëse kanë qenë të pamjaftueshme, të pambështetura në studime dhe realitetin e këtyre ekosistemeve. Mangësitë në bazën ligjore ekzistuese, mbivendosjet e strukturave dhe kompetencave të tyre, bashkëveprimet e munguara ndërinstitucionale, mosadministrimi i duhur financiar dhe logjistik, kanë sjellë një situatë aspak pozitive. Gjithashtu, përfshirja e publikut dhe e aktorëve të tjerë në proceset e hartimit të politikave nuk paraqitej në nivelin e dëshiruar. Në përfundim të auditimit janë gjeneruar gjetje të cilat theksojnë mangësi dhe mos arritje të objektivave të subjekteve nën auditim për të cilat janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

6. SHTOJCAT

Shtojca 6.1 Trajtimi i komenteve nga subjektet e audituara

Trajtimi i observacioneve të AKZM

Pas marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nëpërmjet shkresës nr. 540/1 prot, datë 18.08.2022, administruar në KLSH me nr. 406/7 prot, datë 19.07.2022 ka paraqitur komente mbi gjetjet dhe rekomandimet e përcjella.

Përgjithësisht komentet e paraqitura nga AKZM në shkresë janë të natyrës vlerësuese për materialin e auditimit ku në përfundim të saj citohet; *“MTM dhe AKZM i konsideron si shumë të rëndësishme dhe të vlefshme për punën e saj rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit, prandaj ejemi duke përgatitur planin e veprimit për zbatimin e tyre”*.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur paraqiten disa komente të AKZM mbi gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura për nevojitet shqyrtim si dhe trajtimi përkatës nga grupi i auditimit.

Gjetja 15

Komenti i subjektit të audituar:

- a) Në Shqipëri nuk ekziston një strukturë e posaçme për ruajtjen e lagunave/ligatinave por janë truktura që brenda detyrave të tyre funksionale administrojnë pjesë ose elemente të ndryshme të lagunave.
- b) Institucioni përgjegjës për administrimin e lagunave që kanë status të mbrojtur është AKZM
- c) Koordinatat e zonave të mbrojtura lagunore janë dhënë në sistemin KRRGJSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit

- a) Përgjegjësia e orjentuar në gjetje i përket tre institucioneve MBZHR, MTM dhe specifikisht AKZM, me format e tyre të administrimit, sipas institucioneve të vartësisë, ndaj kjo nuk ndryshon gjetjen.
- b) Kjo pranohet nga subjekti AKZM.
- c) Sistemi i matjes së lagunave është sipas UMT Zone 34N, por ndryshimi i qëndrimit të grupit auditues dhe AKZM është si sistemi i matjes por edhe ku nis laguna, që sipas ligjit për burimet ujore, laguna ka si territor kufizues bregun e saj, me probabilitet përsëritje një herë në 25 vjet. Matja e ofruar nga AKZM nuk është as si sipërfaqe dhe as si njësi e shprehur korrekte. Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 16

Komenti i subjektit të audituar:

- a) Pasaporta e zonave të mbrojtura nuk janë të miratuara nga ministri i MTM.
- b) Për aq kohë sa nuk janë firmosur nga MTM nuk mund të vihen në dispozicion të KLSH si dokument zyrtar.
- c) Studimi është transparent dhe mund të aksesohet online në faqen e AKZM.

Qëndrimi i grupit të auditimit

- a) Pasaportat e zonave të mbrojtura nga momenti që merret në dorëzim nga AKZM prej kompanisë që ka drejtuar studimin janë pronë studimore e RSH, përtej faktit nëse janë miratuar, ato janë prova shkresore
 - b) Mosvënja e pasaportave të zonave të mbrojtura në dispozicion të KLSH, dhe përgjigja në pyetësor se nuk disponohen as nga KZM dhe as nga MTM, është cënim i ligjit nr. 154/2014, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15/e “në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t’u kërkojë subjekteve të audituara që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij;”
 - c) Studimi i cili pretendohet se është në web, të AKZM, por që nuk disponohet gjatë auditimit nga ky Web, përbën sipas nenit 26/2, të ligjit 154/2014 pengim të punës së KLSH.
- Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 17

Komenti i subjektit të audituar:

- a) AKZM prej vitit 2015 që është krijuar nuk ka lejuar asnjë ndërtim.
- b) Ndërtimet e paligjshme janë referuar në organet kompetente.

Qëndrimi i grupit të auditimit

- a) Kjo nuk qëndron si observim, pasi pamjet satelitore tregojnë qartë se nga viti 2017 deri në stadin aktual ka pasur ndryshime në strukturën e objektit ndërtimor në këto vite.
 - b) Nuk ka prova mbështetëse për rastin konkret.
- Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 18 & 19

Komenti i subjektit të audituar:

- a) Nuk janë lejuar të peshkohet në monument natyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit

- a) Observacioni nuk qëndron sepse kurthet Dajlan dhe Starnik në monument natyre konfirmohen si nga pamjet foto dhe nga licencat e peshkimit që ka lëshuar MBZHR.
- Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 21 & 22

Komenti i subjektit të audituar:

- a) Nënzonimi është i qartë në VKM nr. 59 dhe VKM nr. 60, së bashku të datës 26.01.2022.
- b) Të dhënat janë të publikuar anë portalin ASIG

Qëndrimi i grupit të auditimit

a) Nënzonimi nuk është pjesë e evidentueshme në VKM-të sipërcituar dhe tabelat që i referohet AKZM janë pa legjendë, që të sqarojnë nëse i përkasin zonës së mbrojtur qendrore apo bashkëshoqëruese.

Harta e VKM-së duhet të miratohej në KKT, përpara se të hynte në fuqi VKM-ja, dhe refererua AKPT, në faqen e saj gjenden të publikuara vetëm monumentet e natyrës, jo nënzonimi.

b) Portali ASIG është i paaksesueshëm, ndërsa gjatë gjithë kohës vetë AKZM në periudhën audituese i referohej AKPT-së.

Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 23

Komenti i subjektit të audituar:

a) Kufijtë e zonave të mbrojtura jo domosdoshmërisht përkojnë me kufijtë e zonave RAMSAR.

Qëndrimi i grupit të auditimit

a) AKZM ndodhet në pozita përsëritëse të fshehjes së të dhënave ndaj KLSH.

Kufijtë e zonave të mbrojtura, të reduktuar me VKM me 634.34Ha, kur ato kanë status të dyfishtë mbrojtje si kombëtare dhe ndërkombëtare RAMSAR, nuk mund tju hiqet një status mbrojtje kombëtar dhe të mbetet në fuqi ai RAMSAR, sepse është nonsens logjik.

Mbrojtja do të thotë me aktivitet minimal të njeriut, kurse duke zhvilluar resorte turistike çenohet mbrojtja.

Grupi i auditimit në pjesën narrative i ka kujtuar se RAMSAR ka protestuar për asfaltimin e disa rrugëve automobilistike, kurse tjetërsimi i peisazhit natyrisht cenon konventën RAMSAR.

Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 24

Komenti i subjektit të audituar:

a) Gjetja nuk qendron. Ligji për zonat e mbrojtura neni 17/3, cakton deri në 200 metra zonën buferike.

Qëndrimi i grupit të auditimit

a) Observacioni nuk qëndron sepse laguna e Petritit është një formacion lagunor i formuar njëjtë si **godulla e re në Parkun e Karavastasë, Monument natyre**, pa lidhje drekte me detin. Pra, grupi evidentoi se përtej mospërfshirjes së një lagune në zonën e mbrojtur, MTM ka përgjegjësinë e moslejimit të gjuetisë që ndodhte në zonën pranë lagunës së Petritit.

MTM nuk ka observuar që tregon se pranon përgjegjësinë e vet institucionale, kurse AKZM është evidentuar në Rekomandim, ku i kërkohet të evidentoj Lagunën e Petritit, dhe ti jepet statusi që i takon për shka të ujit të ëmbël në të sikurse edhe **laguna e Kallengës Nartë**, si edhe të bëhet kufizimi përkatës me zonë buferike.

Lagune e Petritit vjen nga emri i shpendit “*Falco peregrinus*” apo Petrit, që rritet afër vendburimeve me ujë të ëmbël gjë që tregon se kjo lagunë nuk është vlrësuar drejt në statusin e saj të mbrojtjes.

Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit

Gjetja 26

Komenti i subjektit të audituar:

a) AKZM kryen analiza për problemet bazë të zonave të mbrojtura, por jo analiza të ujit, të cilat kryhen nga AKM.

Qëndrimi i grupit të auditimit

a) Gjetja qëndron sepse AKZM ka pajisje kanteriale që mat kripshmërinë, oksigjezin në ujë, etj. Të cilat duhet ti përdori, kurse MTM me subjektin nën varësi AKM ka detyrimin e monitorimit më intensiv, kur zonat me matje kanteriale dalin të ndotura, jo vetëm një herë në vit. Monitorimi dhe analizat kaq të largëta në kohë nuk japin rezultaat shkencor të drejtë. Ato janë statistika, por jo metodologji matje shkencore. Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 33

Komenti i subjektit të audituar:

Për gjetjen nr. 33, AKZM trajton se planet vjetore të punës të kërkuara janë vetëm të një sektori dhe nuk përfshijnë të gjithë planin e punës të Agjencisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa trajtohet në koment sqarojmë se, grupi i auditimit ka kërkuar plane pune gjithëpërfshirëse madje të cituara qartë në pyetësorët periodikë që i ka drejtuar AKZM-së dhe AdZM-ve rajonale gjatë auditimit dhe në bazë të përgjigjeve zyrtare nga këto subjekte, ka arritur në konkluzione dhe rekomandime.

Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 37

Komenti i subjektit të audituar:

Për gjetjen nr. 37, trajtohet se deri në vjeljen e vlerës së demit apo gjobës në ZM, AKZM duhet ti referohet ligjit Për Inspektimin. Administrata e ZM nuk është pjesë e Inspektoratit Qendror dhe nuk mund të veprojnë referuar VKM nr. 696 datë 16.08.2013. Punonjësit e emërtohen Roje Mjedisore dhe jo Inspektorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa trajtohet në koment sqarojmë se, AKZM dhe AdZM rajonale në përgjigjet zyrtare dhe në intervistat verbale nuk e kanë të qartë rolin e tyre në veprimtarinë funksionale përderisa nuk kanë kompetenca për të marrë masa referuar VKM nr.382, datë 25.06.2016 i cili përcakton se rojet mjedisore kanë për detyrë të parandalojnë dëmtimet në zonën e mbrojtur, të zbulojnë veprimtaritë kriminale dhe të mbikqyrin zonat e mbrojtura. Mospërputhjet dhe paqartësitë ligjore referuar VKM-së së mësipërme, duhet të shërbejnë si shkas për të marrë masa për të unifikuar legjislacionin që përcakton rolin e rojes mjedisore si koncept dhe profil në mënyrë që të mos bjerë ndesh me kompetencat e strukturave të tjera ligj zbatuese.

Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetja 45

Komenti i subjektit të audituar:

Për gjetjen nr. 45, trajtohet se, VKM nr. 1156 datë 24.12.2020 për efekt të tarifave i përfshin dhe lagunat si pjesë përbërëse e territorit të zonave të mbrojtura.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa trajtohet në koment sqarojmë se, trajtimi në materialin e auditimit i referohet tarifave për përdorimin e sipërfaqeve ujore për peshkim dhe jo atyre por për aktivitetet e listuara në VKM-në e mësipërme. Sa më sipër komentet nuk merren në konsideratë për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Trajtimi i observacioneve të MBZHR

Me shkresën nr. 2130/4 prot, datë 27.10.2022, administruar në KLSH me nr. 106/8 prot, datë 31.10.2022 MBZHR ka paraqitur komente mbi rekomandimet e përcjella. Nga komentet e paraqitura për një pjesë të tyre MBZHR ka shprehur dakordësi ndërkohë për disa të tjera nuk ka rënë dakort, pavarësisht diskutimeve të vazhdueshme të problematikave nga ana e grupit të auditimit me hallkat përgjegjëse por dhe diskutimeve në takimin përmbyllës të cilat kanë qenë pozitive. Më poshtë në mënyrë të përmbledhur paraqiten komentet mbi rekomandimet për të cilat ky institucion nuk shprehet dakord si dhe trajtimi përkatës nga grupi i auditimit.

Rekomandimi 12

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin nr. 12 MBZHR sqarojmë se, Strategjia është miratuar me VKM nr. 460 datë 29.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet paraqitura sqarojmë se periudha e auditimit ka qenë Janar 2019-Janar 2022. Pavarësisht kësaj gjatë fazës së terrenit, kjo strategji nuk gjendej e miratuar dhe nuk ka qenë objekt i vlerësimit tonë. Sa i përket dokumentit të parashtruar nga MBZHR për strategjinë 2021-2027, vlen të theksojmë se, pavarësisht se kjo strategji është miratuar në Qershor 2022 ajo i shtrin efektet në prapaveprim rreth një vit e gjysmë më parë duke vendosur objektiva edhe për një periudhë të shkuar. Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 14

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin nr. 14 MBZHR nuk shprehet dakord pasi bazuar në ligjin 64/2012 si dhe VKM 712/2013, përcakton afatin *deri në 10 vjet* për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e paraqitura sqarojmë se, lagunat në vend kanë venndodhje, shtrirje dhe tipare ekologjike të ndryshme dhe si të tilla vlerësimi i afatit të kontraktuar për to nuk duhet të kryhet apriori 10 vite por mbi bazën e një metodologjie të qartë për përcaktimin e afatit kontraktor i cili sipas VKM së sipërcituar është (0-10 vite). Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 15

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin 15 MBZHR nuk shprehet dakord me komentet si më poshtë: Lagunat janë ekosisteme dinamike të cilat e ndryshojnë sipërfaqen e tyre në vazhdimësi lidhur kjo me disponueshmërinë e ujit në këto mjedise. MBZHR është ministria që mbulon aktivitetin e peshkimit. Sido që të ndryshojë sipërfaqja ujore, ku ka aktivitetet peshkimi është kompetencë e MBZHR.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në rekomandimin nr. 15 grupi i auditimit i referohet domosdoshmërisë për të patur informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të saktë se ku janë kufijtë e lagunave, shkallën e mbrojtjes së tyre, për të mundësuar zhvillimin e turizmit ekologjik por edhe mbrojtjes nga dëmtimi të këtyre ekosistemeve.

Pikërisht duke konsideruar edhe dinamikat e ndryshimit të sipërfaqeve apo thellësisë janë të nevojshme përditësimet e vazhdueshme periodike. Lidhur me përgjegjësinë institucionale për lagunat, nga ana jonë, kjo nuk shihet si një kompetencë individuale e një institucioni, por brenda fushës së përgjegjësisë së tij çdo institucion përmbush detyrimet e tij ligjore më vete dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera bashkëvepruese në to. Sa më sipër ne i qëndrojmë rekomandimeve të dhëna dhe për këtë nuk do të kryhen ndryshime në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 18 dhe 19

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin 18 dhe 19 MBZHR nuk shprehet dakord me komentet si më poshtë: MBZHR thekson rolin e rëndësishëm nga pikëpamja shërbimit ekologjik/mjedisor të kryerja nga aktiviteti i peshkimit në laguna ku peshkatarët ndalojnë procesin e mbajtjes së mëtejshme të lagunave. Në këtë prizëm duhet të shikohen, konsiderohen dhe menaxhohen lagunat edhe nga autoritetet vendimmarrëse. Jo nga lartë poshtë por të gjithë së bashku. Si i tillë peshkatarët nuk janë problemi por çelësi i zgjidhjes së problemit...

Në lidhje me dajlanët, ato janë mjet tradicional dhe i ligjshëm peshkimi, kryesisht në Mesdhe...Për sa i përket kontratave, nga regjistrat e kontratave të disponuara nga MBZHR dhe nga kontrollet në terren nga Inspektorati i Peshkimit, nuk rezulton se zhvillohet aktiviteti i peshkimit me stavnik në laguna.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në rekomandimin nr. 18 grupi i auditimit i referohet nevojës për të kryer studim të ekosistemit dhe analizim të kosto-përfitimit për të mos krijuar aktivitete tregëtare joeficiente të cilat mund të dëmtojnë ekosistemin dhe duke orientuar sipas rëndësisë këto raste drejt kërkimit shkencor dhe mbrojtjes. Kjo pasi në një numër të lartë lagunash aktiviteti i peshkimit ishte thuajse inekzistent.

Sa i përket rekomandimit nr. 19, lidhur me përditësimin e kontratave të peshkimit me kurthe sipas analizës së rezervës peshkore, vlerësojmë që është objekt i punës tuaj dhe është koherent me problematikat të konstatuara në laguna.

Sa më sipër ne i qëndrojmë rekomandimeve të dhëna dhe për këtë nuk do të kryhen ndryshime në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 20

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin 20 MBZHR nuk shprehet dakord pasi është ngarkuar një strukturë e posaçme, (Sktori i Monitorimit dhe Analizës së të Dhënave...) për monitorimin e kontratave të lidhura nga MBZHR për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, përfshirë dhe lagunat. Mbajtja hapur e grykave të komunikimit të lagunës me detin është detyrim i OMP, për zonat bashkëmenaxhuese dhe monitorohen nga MBZHR dhe institucionet e saj të varësisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për vetë rëndësinë që lagunat kanë dhe diversitetin e komponentëve përbërës të këtyre ekosistemeve, duke vërejtur mangësitë individuale por edhe paqartësive në procesin e kompetencave dhe koordinimit të institucioneve, nga ana jonë është rekomanduar krijimi i një strukture të përhershme ndër-institucionale e cila të koordinojë burimet dhe veprimet midis institucioneve. Nga ana jonë për përmirësimin e gjendjes janë dhënë edhe rekomandime specifike për institucione pjesë e këtij procesi. Sa më sipër ne i qëndrojmë rekomandimit të dhënë dhe për këtë nuk do të kryhen ndryshime në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 26

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin 26 MBZHR nuk shprehet dakord pasi çështjet që lidhen me analizat e parametrave mjedisore si dhe problematikat të tjera të lidhura me fushën e mjedisit nuk janë në kompetencat e MBZHR por AKZM.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në rekomandimin nr. 26 kërkohet angazhimi i strukturave përgjegjëse nën varësitë respektive për analizimin e problematikave dhe jo analizimin vetëm të parametrave mjedisorë. Këtu mund të përmendim rastin e impiantit të midhjeve në Liqenin e Butrintit në të cilën kryhen, analizat e produktit por edhe të parametrave ujorë të liqenit. Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 28

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin 28 MBZHR nuk shprehet dakord. MBZHR nuk e ka kufizuar zënien e kësaj specie, përkundarzi ka nxitur subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në lagunë për rritjen e zënieve të gaforres blu. Gaforja blu është një problem për të gjitha lagunat e Mesdheut të cilat po vuajnë të njëjtat pasoja si dhe lagunat shqiptare....

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa trajtohet në koment sqarojmë se, trajtimi i problematikës së Gaforres blu të paraqitura nga grupi i auditimit është i bazuar në vëzhgimet e kryera në terren në të gjitha lagunat kryesore të vendit, shqetësimet e shprehura nga peshkatarët gjatë këtyre vëzhgimeve, komunikimet e vazhdueshme me punonjësit e AdZM-ve Rajonale por edhe një sërë kronikash televizive të cilat trajtojnë gjithashtu këtë çështje. Sa i përket argumentave të parashtruara vetë MBZHR pranon se gjendet ende në proces kërkimor dhe hulumtues dhe nuk evidenton hapa dhe mekanizma konkretë në drejtim të përmirësimit të situatës. Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 29

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimin 29 theksojmë se MBZHR nuk shprehet dakord, pasi nuk trajton çështje të lidhura me ndikimin negativ në mjedis të subjekteve që ushtrojnë aktivitet jashtë fushës së kompetencës së saj. Pavarësisht çka u përcaktua më sipër, MBZHR me anë të shkresës nr. 2495/1 prot, viti 2022 ka adresuar këtë shqetësim Ministrisë kompetente për mjedisin...

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa trajtohet në koment sqarojmë se, trajtimi i lagunës si pjesë e kompetencës vetëm të MTM është i gabuar pasi, një nga elementët të cilët dëmtohen në këtë ekosistem është dhe pjesa e peshkimit e cila është fushë në kompetencën e MBZHR. Shtuar këtu dhe prodhimi i kripës si një produkt ushqimor i rëndësishëm dhe është brenda fushës së përgjegjësisë së MBZHR. Në trajtimin e rekomandimit nr. 15 ju shpreheni se “....Sido që të ndryshoj sipërfaqja ujore, ku ka aktivitet peshkimi është kompetencë e MBZHR”, ndërkohë në rastin e kripores trajtoni moskompetencën tuaj, duke reflektuar dy qëndrime të ndryshme brenda të njëjtit material. Në vlerësimin tonë, tërheqja e ujit jo vetëm dëmton ekosistemin por ajo dëmton së tepërmi dhe rezervën peshkore të kësaj lagune, si dhe paraqet nevojën për vlerësim të efekteve të saj edhe në produktin e nxjerrë në kripore. Rregullimi i situatës paraqet nevojën për veprime të përbashkëta institucionale për të adresuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë problematikën. Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Komenti i subjektit të audituar:

Në lidhje me rekomandimet 44 dhe 45 nuk shprehem dakord pasi në zbatim të ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në MBZHR është ngarkuar Sektori i Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave, për monitorimin e kontratave të lidhura për zonat lagunore me OMP-të në rastet kur janë shpallur zona bashkëmenaxhimi apo me subjekte private, ndërkohë që monitorimi/inspektimi i vazhdueshëm në terren i të gjithë aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, duke përfshirë këtu dhe zonat lagunore kryhet nga Sektori i Kontrollit dhe Inspektimit në DSHPA.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa trajtohet në koment sqarojmë se, rekomandimi vjen në vijim të trajtimit të situatës, gjetjeve të konstatuara dhe konkluzioneve përkatëse.

Për rekomandimin nr.44 nuk jepni spjegime apo komente mbi rekomandimin. Nëse i referohemi Urdhrit të Ministrit nr. 11 datë 10.09.2020 “Për Procedurat e monitorimit të Zbatimit të Kontratave për Ushtrimin e Aktivitetit të Peshkimit në Ujrat e Brendshme dhe Akuakulturës Tokësore dhe Ujore” në të përcaktohet qartë detyrimi i strukturave të ministrisë për monitorimin e kontratave si dhe detyrat e Inspektorateve. Detyrimet e strukturave në ministri përcaktohen edhe në “Kontratën Tip” të miratuar, Urdhrit të Ministrit nr. 433 datë 20.10.2020 “Për monitorimin e kontratave”, i ndryshuar, por edhe Planin e Monitorimit “Për zbatimin e kontratave” i cili mban nr. 9492 prot, datë 23.10.2020. Aktet e sipërcituara por jo vetëm, tregojnë qartë detyrimin e strukturave të Ministrisë për monitorimin e kontratave të lidhura dhe marrjen e masave. Për periudhën nën auditim u paraqitën të dhëna monitorimi vetëm për një kontratë por edhe ky rast nuk gjendej i pa konkluduar me masat përkatëse, ndërkohë që numri i tyre është i konsiderueshëm. Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për rekomandimin nr.45 trajtohet detyrimi i DSHPA për monitorim/inspektim. Ndërkohë që Urdhri i Ministrit nr. 11 datë 10.09.2020, përcakton qartë se, janë strukturat përkatëse në ministri dhe ato në DSHPA të cilat kryejnë monitorime për kontratat e lidhura, ndërsa vlerësimin e përmbushjes së gjithë detyrimeve dhe raporti pas çdo monitorimi hartohet nga struktura përgjegjëse në Ministri dhe i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm për miratim së bashku me shkeljet dhe rekomandimet. Rekomandimi ynë, për vetë tipologjinë e lagunave, ka të bëjë me ngritjen e një njësie/strukture të dedikuar brenda Ministrisë e cila të kryej monitorimin e plotë dhe të vazhdueshëm të kontratave të lidhura, duke qenë se për periudhën objekt auditimi procesi në tërësi në këtë drejtim ka qenë i pamjaftueshëm dhe i paorientuar drejt. Sa më sipër komenti juaj, gjendet i pambështetur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT